



**SHKODRA
NË SHEKUJ**

The Path and Efforts for the Emancipation of Shkodran Women (up to 1990)

It has evolved through: 1. Education, as the most effective path to emancipation. This journey has been marked by a long struggle against conservatism and fanaticism. This section outlines the long path of women's education in Shkodra, starting with the establishment of Catholic religious schools, followed by the first public school for women, Kushe Mica's school, and later state-run public schools. The continuation of emancipation includes: 2. The feminist movement, which began with the organisation of Shkodran women into associations. On August 3, 1920, Shaqe (Marie) Çoba founded the "Albanian Women's Committee" and published the magazine Gruaja Shqiptare, which addressed issues such as the education of girls and women, as well as other topics related to family education, child-rearing, and more. 3. The participation of women in cultural and literary activities up to 1944 began with the efforts of the girls from the "Motrave Stigmatine" school and expanded to public engagements in newly formed Shkodran societies. A significant boost to the feminist movement came from: 4. The political activities of women and girls during the National Anti-Fascist Liberation War. During the war years, the organisation "Union of Albanian Anti-Fascist Women" (BGASH) was founded based on decisions from the first conference of the Albanian Communist Party (PKSH). In April 1943, an initiating committee was formed in Tirana, which also published the magazine Gruaja Shqiptare. 5. A key step in the emancipation of Shkodran women was achieved between 1944-1990, with efforts to combat illiteracy, patriarchal and conservative customs, the struggle for the removal of the veil, the establishment of a series of schools, and the development of the cultural and sporting movement, making women's participation visible and impactful across various fields. However, class struggles excluded many intelligent Shkodran girls and women from higher education.

SEMINARI "SHKODRA NË SHEKUJ"

12-13 Dhjetor 2024

Libri i abstrakteve



**BASHKIA
SHKODËR**



**UNIVERSITETI I SHKODRËS
"LUIGJ GURAKUQI"**

Zenepe Dibra

Rruqa dhe përpjekjet për emancipimin e femrës shkodrane (deri më 1990)

Ka kaluar përmes: 1. Arsimimit, si rruga më e efektshme drejt emancipimit. Kjo rrugë ka ecur përmes një lufte të gjatë konservatorizmi dhe fanatizmi. Në këtë paragraf jepet rruga e gjatë e arsimimit të femrës shkodrane që nga hapja e shkollave fetare katolike dhe më vonë shkolla e parë publike për femra e Kushe Micës, për të vazhduar me shkolla publike shtetërore. Vazhdim i emancipimit do jetë: 2. Lëvizja feministe që fillon me organizmin e gruas shkodrane në shoqata. Kështu Shaqe (Marie) Çoba me 3 gusht 1920 krijon “Komitetin Gruaja Shqiptare”, duke botuar dhe revisten “Gruaja Shqiptare” ku shtrohen probleme të arsimimit të vajzave dhe grave, si dhe çështje të tjera që kishin të bënin me edukatën familjare, edukimin e fëmijëve, etj. 3. Pjesëmarrja e gruas në aktivitetet kulturore dhe veprimtari letrare deri më 1944, do të fillojë me aktivitete të vajzave nga nxënëset e shkollës “Motrave Stigmatine”, për të vazhduar me dalje publike në aktivitete e shoqërive shkodrane të sapoformuara. Një hov do i japë lëvizjes feministe: 4. Aktivitetet politike të vajzave dhe grave gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në vitet e luftës ANÇ krijohet organizata “Bashkimi i Grave Antifashiate Shqiptare”, “BGASH” në bazë të vendimeve të Konferencës së parë të vendit të PKSH. Në prill të 1943 u krijua në Tiranë një komision nismëtar që nxori edhe revistën “Gruaja Shqiptare”. 5. Hapi cilësor në emancipimin e femrës shkodrane do të arrihet në vitet 1944-1990 Lufta kundër analfabetizmit, zakoneve patriarkale dhe konservatore, lufta për heqjen e perçes, ngritja e një sërë shkollash, si dhe zhvillimi i lëvizjes kulturore-sportive, bën që pjesëmarrja e femrës është e evidente me rezultate në të gjitha fushat. Por lufta e klasave do linte jashtë arsimit të lartë shumë vajza dhe gra shkodrane, mjaft inteligjente.

Potential and Challenges in the Development of Agro-Tourism in the Shkodra Region

Agro-tourism, a unique initiative that significantly contributes to the transformation of rural communities, has become a key focus in sustainable development in recent years. It combines agricultural activities with tourism, integrating the delivery of agricultural products and services into the tourist experience. The Shkodra region holds substantial potential for agro-tourist development; its strategic geographical position, acting as a link for both national and international tourism; its diverse landscapes, including the Adriatic coast, the Buna River, and Lake of Shkodra; its natural areas, such as fields, hills, and mountains; its varied climate; a long-standing tradition in agriculture, livestock, and beekeeping; and its rich hospitality and culinary heritage, all offer exceptional opportunities for growth.

Agro-tourism plays a crucial role in the sustainable development of rural areas, fostering employment and improving the quality of life by promoting agricultural and livestock products, as well as providing accommodation and services. This has been supported by government policies and certification criteria, such as Council of Ministers Decision No. 22, dated January 12, 2018. In Shkodra, agro-tourism ventures like "Shega," "Marku," "Harapi," "Hysaj," "Gardenland," and others have begun operations, some through private investments and others with small grants from non-governmental organisations. These farms, while improving the well-being of rural communities, also offer recreational opportunities for both domestic and international tourists.

This study aims to evaluate the region's potential, highlight its increasing historical and cultural assets, and assess its tourism offerings, while also addressing the challenges agro-tourism development faces in Shkodra. Strengthening existing agro-tourist initiatives and supporting the establishment of new businesses will be key to the sustainable development of rural areas.

BORDI SHKENCOR

Prof. Dr. Tonin Gjuraj
 Prof. dr. Blerta Dragusha
 Prof.dr. Matteo Mandala
 Prof.dr. Ardian Ndreca
 Prof.dr. Valentina Ndou
 Monica Genesin
 Prof.dr. Artan Haxhi
 Prof.dr. Mimoza Priku
 Prof.dr.Ledri Kurti
 Prof.dr. Nertila Ljarja
 Prof. dr. Fatmir Vadohej
 Prof. dr. Ermira Kalaj
 Prof. dr. Arjeta Troshani
 Prof.as.dr. Arben Prendi
 Prof.as.dr.Orjeta Baja
 Prof.as.dr. Zamira Shkreli
 Prof.as.dr. Bresena Koplaku
 Prof.as.dr. Valbona Karakaçi
 Prof.as.dr. Rrezarta Draçini
 Prof.as.dr.Elindë Ramadani
 Prof.as.dr. Gëzim Puka
 Prof.as.dr. Medion Hyseni
 Prof.as.dr. Vinçens Marku
 Prof.as.dr. Simon Lufi
 Prof.as.dr. Paulina Guli
 Prof. as.dr. Irma Baraku
 Prof. as.dr. Entela Baci (Hoxhaj)
 Prof. as. dr. Eranda Halluni
 Prof. as. dr. Edlira Bushati

Prof. as. dr. Drita Brahimi
 Prof. as. dr. Alma Hafizi
 Prof. as. dr. Eliana Lacey
 Prof. dr. Fatbardha Molla
 Prof. as. dr. Elidiana Bashi
 Prof. as. dr. Mirjam Dibra
 Prof. as. dr. Brilanda Bushati
 Prof. as. dr. Albana Boriçi
 Prof. as.dr. Ardita Boriçi
 Prof. as. dr. Nevila Mehmetaj
 Prof. as. dr. Rrok Smajlaj
 Dr. Bendis Kraja
 Dr. Flora Gjoni
 Dr. Erzen Koperaj
 Dr. Ermira Alija
 Dr. Isida Hoxha
 Dr. Lindita Kazazi

BORDI ORGANIZATIV

Blendi Bushati
 Prof.as.dr. Valbona Karakaçi
 Prof.as.dr. Bresena Koplaku
 Prof.as.dr. Zamira Shkreli
 Dr. Erzen Koperaj
 Dr. Ermira Alija
 Dr. Isida Hoxha
 Dr. Karmen Lazri
 Msc. Rozafa Shpuza
 Senad Xhexhovi

Ylber Dyli, Dritan Rustja

Potencialet dhe sfidat e zhvillimit të agroturizmit në arealin e Shkodrës

Agroturizmi, si një sipërmarrje e veçantë që ndikon ndjeshëm në transformimin e komuniteteve rurale, vitet e fundit ka marrë një prioritet në zhvillimin e qëndrueshëm. Ai bashkon elementët e bujqësisë me turizmin, duke ndërthurur ofrimin e produkteve dhe shërbimet bujqësore me eksperiencën turistike. Areali i Shkodrës ka potenciale mjaft të mëdha në zhvillimin e agroturizmit. Pozita gjeografike, si një lidhëse me lëvizjet turistike kombëtare dhe ndërkombëtare; peizazhet ujore, si bregdeti i Adriatikut, lumi Buna, liqeni i Shkodrës; hapësirat natyrore, si fushat, kodrat, malet; kushtet klimatike të larmishme; tradita e zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë, apikulturës; mikpritja dhe kulinaria e pasur e ndërthurur edhe me trashëgiminë historike dhe kulturore, përbëjnë potenciale te jashtëzakonshme të zhvillimit të tij.

Roli i agroturizmit në zhvillimin e qëndrueshëm të hapësirave rurale dhe në funksion të punësimit dhe rritjes së mirëqenies në fshat duke nxitur prodhimet bujqësore dhe blegtorale si dhe të njësive akomoduese dhe të shërbimit, ndikoi edhe në hartimin e politikave qeveritare dhe kritereve për çertifikimin e tyre me VKM-në nr 22, datë 12.1.2018. Në arealin e Shkodrës nisën veprimtarinë e tyre, diku me investime private e diku me grante të vogla nga organizatat joqeveritare, fermat agroturistike si "Shega", "Marku", "Harapi", "Hysaj", "Gardenland" etj, të cilat krahas rritjes së mirëqenies në komunitetet rurale, kanë krijuar edhe mundësi për pushime dhe argëtim për turistët vendas dhe të huaj.

Nëpërmjet këtij studimi, krahas vlerësimit të mundësive dhe evidentimit të objekteve historiko-kulturore në rritje dhe ofertës turistike, synojmë të trajtohen edhe sfidat me të cilat përballet zhvillimi i agroturizmit në arealin e Shkodrës. Përmirësimi i subjekteve "pioniere" agroturistike ekzistuese dhe mbështetja ndaj krijimit të njësive të reja, do të mundësonte një zhvillim të qëndrueshëm të hapësirave rurale.

and exploration. As long as human beings create, this creation will always be new, present, and contemporary. But will it be of quality? What does Albanian theater need to achieve the quality and standards of theater as it is performed around the world today? Investment and attention? Certainly. Strong and long-term collaborations with theaters, individuals, and foreign experts in every technical and artistic profile. It requires open-mindedness and an honest scan of each individual's and institution's situation to understand problems and deficiencies, along with the tendency and desire to improve and break free from a “modern” schematism that has taken over our theater.

I believe that for an artist, simply doing their duty is not enough. On the contrary, an artist should not see their work as a duty but as a mission. An artist comes as a missionary who spreads art among people as a form of salvation and escape from the daily reality that surrounds them. Theater, even though we all know it is “make-believe,” concretizes our human existence.

Abdurrahim Maxhuni

Ndihmesa e Institutit Albanologjik në fushën e leksikut dialektor

Gjatë veprimtarisë së tij shkencore, Instituti Albanologjik, i themeluar më 1953, rëndësi të veçantë i ka kushtuar leksikut dialektor, studimit të të folmeve veriore, të Kosovës në veçanti, botimit të monografive për të folme të ndryshme të Kosovës, botimit të fjalorëve dialektorë, studimeve të veçanta, siç janë përmbledhjet Studime gjuhësore (Dialektologjia I-II), botimit të veprave të Anton Çetës, organizmit të konferencave e tryezave shkencore me temë bosht për të folmet dialektore etj. Leksiku dialektor, kryesisht i Veriut, ka zënë vend të veçantë dhe vazhdon të ketë në revistat e Institutit Albanologjik, në revistën “Gjurmime albanologjike” dhe në revistën “Gjuha shqipe”. Në këtë kumtesë, do të trajtoj ndihmesën e Institutit Albanologjik në fushën e leksikut dialektor, ndihmesë e cila ka shërbyer dhe për Fjalorin e Madh të Gjuhës Shqipe, i cili është në fazën e fundit të hartimit, përmes kartotekës së leksikut dialektor.

The Contribution of the Albanological Institute to the Dialect Lexicon

Since its establishment in 1953, the Albanological Institute has placed a significant emphasis on the study of dialect lexicon, particularly focusing on the northern dialects. The Institute has published monographs on various dialects of Kosovo and has produced dialectological works and specialised studies, such as the collection *Linguistic Studies* (Dialectology II). Additionally, it has published the works of Anton Cetta, organised conferences, and held scientific roundtables dedicated to dialectal forms.

The northern dialect lexicon holds an important place in the Institute's publications and continues to be prominently featured in its journals, namely *Gjuha Shqipe* (Albanian Language) and the *Albanological Research Journal*. This report highlights the contributions of the Albanological Institute to the field of dialect lexicon, with a particular focus on its role in the creation of the *Great Dictionary of the Albanian Language*, which is currently in its final stages of compilation, with an emphasis on processing the dialectal lexicon.

Ubi eras et quo vadis: Our Theater

The development of theater and other forms of performing arts is a journey that reflects the transformations of a society, city, and state. Every era has left its mark on the history of theater worldwide, contributing to a rich tradition that continues to evolve and influence contemporary forms of entertainment, information, reflection, education, and development. The role of theater in the world has always been significant, serving as a living bridge between those performing on stage and those watching. Albanian theater has undergone numerous and often strange transitions, especially after the 1990s, when liberalism began to permeate the performing arts. However, some natural questions arise: Did Albanian theater truly become liberal? For the sake of freedom of thought and creativity, has a new form and tradition emerged in our theater that competes with and meets the demands of contemporary theater?

The artist's struggle is always intense and continuous—with themselves, with time, with the audience, and with survival. And this struggle is not only the struggle of a single artist but also of an artistic community that seeks a space to express thought, emotion, rebellion, love—in short, existence on this Earth.

In my 16-year experience on the professional stage, I have observed the efforts of artists to approach the levels of European theater. However, in my opinion, there have only been sparks of achievement from individuals (sporadically), theater groups, or events (specific performances) that have managed to showcase themselves without establishing a definitive theatrical status in the eyes of today's theatrical culture. The reasons for this lack of achievement, I believe, are many, ranging from personal to collective, from societal to policy-driven, from proper education to the personal investment of each artist. The performing arts are a phenomenon in constant development

I duhet teatrit shqipëtar që të arrijë cilësinë dhe standartet e teatrit që bëhet sot nëpër Botë? Investime dhe vëmendje? Sigurisht që po. Bashkëpunime të forta dhe afatgjatë me teatro, individ dhe ekspertë të huaj në çdo profil, teknik dhe artistik. I duhet mendjehapje dhe një skanim i ndershëm i situatës së secilit, individ e institucional, për të kuptuar problemet dhe mangësitë, e tendenca dhe dëshira për tu përmirsuar e dalë nga një skematizëm “modern” që e ka pushtuar teatrin tonë. Mendoj që për një artist, vetëm të bëjë detyrën nuk mjafton, përkundrazi artisti nuk duhet të bëjë një detyrë, duhet të bëjë një mission. Artisti vjen si një misionar që shperndan artin në njerëz si një formë shpëtimi dhe ikje nga një realitet i përditshëm që e rrethon. Teatri edhe pse të gjithë e dimë që është diçka përдемек na konkretizon të qënurit njerëz.

Aida Uruçi

Semantika e disa leksemave në krijimtarinë e Camajt

Martin Camaj është një emër i veçantë në letrat shqipe, ku bashkohen në një figura e shkrimtarit dhe e gjuhëtarit. Vepra letrare e tij përfshin një pasuri të madhe leksikore, ku ai risolli fjalë të autorëve të vjetër e të arbërishtes, leksema të harruara ndër mote, gërshetoi fjalë të dialektit të gegërishtes me ato të standardit, të cilat gjuhëtari e shkrimtari i nxjerr me ngjyrimë stili në kontekstet e përdorura. Duam të vëmë në dukje në këtë punim përpjekjet e Camajt për ndërtimin e leksemave të reja, të cilat dëshmojnë jo vetëm pasurinë e thesarit gjuhësor të të folmes së tij e më gjerë, por kryesisht për vlerat që përmban vepra e tij, sa i takon mbarë gjuhës kombëtare.

Vlen të theksojmë se mjaft leksema të ndërtuara me mjeshtri nga Camaj, mund të jenë pjesë e fjalorit të shqipes. Pikërisht një gjë të tillë do përpiqemi të pasqyrojmë në këtë punim, pasi te shkrimtari Camaj mund të gjejmë rastin e vetëm ku bashkohen në një emër gjuhëtari krijues dhe stilisti, i cili, përveçse ngriti një përmendore letrare, njëkohësisht pranë saj duhet të zbulohet edhe përmendorja gjuhësore.

The Semantics of Certain Lexemes in Camaj's Work

Martin Camaj is a unique figure in Albanian literature, where the roles of writer and linguist come together in one person. His literary works encompass a vast lexicon, in which he revived words from ancient authors and the Arbërisht dialect, as well as lexemes long forgotten over time. He blended words from the Gheg dialect with those of the standard language, enriching them with stylistic nuances in the contexts in which they were used. This paper aims to highlight Camaj's efforts in creating new lexemes, which not only reflect the richness of his linguistic heritage and beyond, but also underscore the values embedded in his work with regard to the national language as a whole.

It is important to note that many lexemes skilfully crafted by Camaj can easily become part of the Albanian lexicon. This is precisely what we seek to demonstrate in this paper, as Camaj represents a rare case where the creative linguist and stylist merge into a single figure. In addition to establishing a literary monument, his work simultaneously unveils a linguistic one.

Jozef Shiroka

Ubi eras et quo vadis Teatri ynë

Zhvillimi i teatrit dhe i formave të tjera të artit skenik është një rrugëtim që pasqyron transformimet e një shoqërie, qyteti e shteti. Çdo epokë ka lënë gjurmë në historinë e teatrit në Botë, duke kontribuar në një traditë të pasur që vazhdon të zhvillohet dhe të ndikojë në format bashkëkohore të argëtimit, informimit, reflektimit, edukimit e zhvillimit. Roli i teatrit në botë ka qënë gjithmonë shumë i fortë, si një urë lidhëse e gjallë midis atij që luan në skenë dhe atij ose atyre që e shohin. Teatri shqiptar ka kaluar në tranzicione të shumta dhe shpesh herë të çuditshme, sidomos pas viteve '90, ku fryma liberale u fut edhe në artin e skenës. Por lindin natyrshëm disa pyetje: A u bë liberal teatri shqiptar? Për hir të lirisë së mendimit dhe krijimit, a u krijua një formë dhe një traditë e re në teatrin tonë e cila konkuron dhe përballlet me kërkesat e teatrit bashkëkohor? Lufta e artistit është gjithmonë e fortë dhe e vazhdueshme me veten, kohën, audiencën dhe mbijetesën. E kjo luftë nuk është vetem e një artisti por edhe e një shoqërie artistike e cila kërkon një terren ku të shprehë mendimin, emocionin, revoltën, dashurinë, pra egzistencën mbi këtë Tokë. Në eksperiencën time tashmë 16 vjeçare në skenën profesioniste, kam vërenjtur përpjekje të artistëve për tu afruar me nivelet e teatrit evropian, por sipas meje ka patur vetëm disa shkëndija të kësaj arritje nga individ (në mënyrë sporadike), trupa teatrore ose evenimente (shfaqje të caktuara) të cilat ja kanë dalë të tregojnë veten, por pa arritur të krijojmë një status të mirfilltë teatral në sytë e kulturës teatrore që egziston sot. Arsyet e kësaj mosarritje unë mendoj që janë të shumta, duke filluar nga personalja tek kolektivja, nga shoqëria tek politikën e ndjekura, nga shkollimi i duhur tek investimi personal i secilit artist.

Arti i skenës është një dukuri e cila është çdo ditë në zhvillim e hulumtim. Për sa kohë qënia njerzore do krijojë, ky krijim do jetë gjithmonë i ri, I tanishëm, bashkëkohor. Por a do jetë cilësor? Çfarë

and national identity. The paper is based on archival documents of the time to provide a detailed overview of the challenges and efforts of Albanians for education in the Vilayet of Shkodra.

Alba Golemi & Greis Golemi

Imazhi i qytetit të Shkodrës

Ky kërkim hulumton përshtypjen e Shkodrës duke përdorur një metodologji të ngjashme me librin Lynch, K. (1960). Imazhi i qytetit. Sipas Lynch, komponentët kryesorë urbanë si rrugët, kufijtë, lagjet, nyjet dhe pikat referuese kontribuojnë në “imazhin mendor” të njerëzve për qytetin në të cilin ata jetojnë. Në rastin e Shkodrës, këto elemente ekzistojnë në mënyra të veçanta duke përfaqësuar historinë dhe kulturën e veçantë të qytetit. Bazuar në idenë e Lynch, ky studim shqyrton strukturën fizike të qytetit si dhe aspektet që kontribuojnë në karakterin e tij urban.

Shkodra, duke qenë një nga qytetet më të vjetra dhe më të rëndësishme historike të Shqipërisë, ka një grup të veçantë ndikimesh arkitekturore që formojnë imazhin e saj. Rrugët e vogla të qytetit të vjetër, objektet kulturore si kalaja e Rozafës dhe pamjet si liqeni i Shkodrës i japin vendasve dhe vizitorëve një ndjenjë të fortë për vendin. Barrierat natyrore, si liqenet dhe malet, ofrojnë një dallim të fortë vizual, duke e bërë më të thjeshtë orientimin dhe ndërgjegjësimin hapësinor. Rrethinat e Shkodrës ofrojnë gjithashtu një ndryshim të rëndësishëm në thelbin e qytetit, duke ndikuar në pamjen e qytetit.

Sipas teorisë së Lynch-it, ky studim shqyrton sesi aspektet vizuale dhe hapësinore ndikojnë në perceptimet e qytetit të Shkodrës, duke rezultuar në një identitet të veçantë urban që përfaqëson personalitetin e tij unik.

The Image of the City of Shkodra

This study examines the perception of Shkodra through a methodology inspired by Kevin Lynch's *The Image of the City* (1960). According to Lynch, key urban elements such as streets, boundaries, neighbourhoods, nodes, and landmarks shape the "mental image" people form of the cities they inhabit. In Shkodra, these elements exist in distinct ways, reflecting the city's rich history and culture. Drawing on Lynch's framework, this research explores both the physical structure of Shkodra and the factors that contribute to its unique urban identity.

As one of Albania's oldest and most historically significant cities, Shkodra boasts a particular set of architectural influences that shape its image. The narrow streets of the old town, landmarks such as Rozafa Castle, and the striking landscape of Lake Shkodra provide both locals and visitors with a strong sense of place. Natural features, such as lakes and mountains, create clear visual boundaries that aid in orientation and enhance spatial awareness. Additionally, the surrounding areas of Shkodra contribute to the overall perception of the city, influencing its visual character.

Following Lynch's theory, this study investigates how visual and spatial characteristics shape the perception of Shkodra, resulting in a distinctive urban identity that embodies the city's unique character.

Keywords: city image, Shkodra, Kevin Lynch, urban components, cultural identity, spatial perception, urban structure, natural boundaries.

EDUCATIONAL REFORMS IN THE OTTOMAN EMPIRE DURING THE 19TH CENTURY. EDUCATION IN THE VILAYET OF SHKODRA

For the Ottoman administration, education played a key role in controlling the territories, and for this reason, any attempt to include the Albanian language and create an Albanian national identity was subject to strict repression by the Ottoman authorities. The pre-university education system of the Empire, which included primary schools (*ruzhdiye*), secondary schools (*iptida*) and lyceums (*idadiye*), was built to strengthen Ottoman structures and promote Ottoman culture and language throughout its territories. However, in the Albanian context, this system remained out of reach for a large part of the population, which aimed to preserve its identity and culture.

During the Tanzimat period, the Empire began to see the need to create a central institution for education that would address the specific interests and demands of the non-Muslim population of the Empire, including Albanians. In this context, in 1864, educational councils were established in each vilayet, which aimed to build and supervise schools at the local level. In 1883, the directorate of education was established in the Vilayet of Shkodra, which would be headed by the prominent intellectual and educator, Daut Boriçi, for about 13 years. During this time, 101 primary schools and 5 secondary schools were opened in the vilayets, which marked an important step towards the development of public education.

This article aims to shed light on the continuous efforts of Albanians to preserve their language, culture and national identity in an education system that aimed at assimilation. The gradual nationalization of education and the efforts to develop the Albanian language represent a form of resistance to Ottoman policies, testifying to the determined stance of Albanians to preserve and develop an independent cultural

kësaj kohe, në vilajet u hapën 101 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme, të cilat shënuan një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të arsimit publik.

Ky artikull synon të hedhë dritë mbi përpjekjet e vazhdueshme të shqiptarëve për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit të tyre kombëtar në një sistem arsimor që synonte asimilimin. Nacionalizimi gradual i arsimit dhe përpjekjet për zhvillimin e gjuhës shqipe paraqesin një formë rezistence ndaj politikave osmane, duke dëshmuar qëndrimin e vendosur të shqiptarëve për të ruajtur dhe zhvilluar një identitet të pavarur kulturor dhe kombëtar. Punimi bazohet në dokumente arkivore të kohës për të sjellë një pasqyrë të detajuar të sfidave dhe përpjekjeve të shqiptarëve për arsimin në Vilajetin e Shkodrës.

Alkida Boshnjaku, Elida Boshnjaku

Pikturat e Kolë Idromenos, një rrëfim për traditën dhe identitetin kulturor

Ky punim synon të evidentojë dhe analizojë pikturat e artistit të njohur shkodran Kolë Idromeno. Studimi do të fokusohet në rëndësinë e dhënë nga ana e artistit kostumografisë shqiptare. Kolë Idromeno një ndër piktorët e shquar shqiptarë, portretizoi jetën dhe zakonet e përditshme të shqiptarëve në artin e tij, ku shpalosi tematika të larmishme si dasmat, festat tradicionale dhe zakonet shqiptare, si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Për qëllimin e këtij studimi, do të zhvillohet analizim:

- i fondit të pikturave të Idromenos ku është paraqitur kostumografia. Përmes analizës do të evidentohet rëndësia e kostumografisë si një element i rëndësishëm i trashëgimisë, zakoneve dhe simbolikës shqiptare.

- për mënyrën sesi pikturat e Kolë Idromenos përçojnë imazhin e kulturës shqiptare përmes veshjeve tradicionale dhe si ndikojnë në përciptimin publik.

Metodologjia e kërkimit do të mbështetet në literaturën ekzistuese si dhe në vzhgimin njerwzor të punimeve origjinale të artistit për të eksploruar dhe interpretuar nga afër detajet ngjyrat, stilin e kostumografisë, si dhe rolin e saj në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Kolë Idromeno's paintings: A narrative of tradition and cultural identity

This paper seeks to examine the paintings of the renowned Shkodra artist Kolë Idromeno, with a focus on his portrayal of costume design. Idromeno is celebrated as one of Albania's distinguished painters, capturing the lives and customs of Albanians in his artwork, which often features themes of weddings, festivals, and traditional practices. His work is an integral part of Albania's cultural heritage.

The study will explore the following aspects:

- The depiction of costume design in Idromeno's body of work. Through this analysis, the significance of costume design as a vital element of Albanian heritage, customs, and symbolism will be underscored.
- The way Kolë Idromeno's paintings convey the image of Albanian culture through traditional clothing and how this influences public perception.

The research methodology will draw on existing literature and firsthand observation of the artist's original works to explore how they were interpreted during his era. It will examine his style, costume design, and the role these elements play in preserving and promoting cultural heritage.

Hirjana Kaceli

Reformat arsimore në perandorinë osmane gjatë shekullit XIX: arsimi në Vilajetin e Shkodrës

Shekulli XIX përfaqëson një periudhë transformuese për Perandorinë Osmane, e cila, në përballje me kriza të shumta të brendshme dhe sfida të jashtme, ndërmori reforma të thella për të konsoliduar fuqinë e saj dhe për të riorganizuar strukturat e shoqërisë. Një nga fushat që njohu ndryshime të rëndësishme ishte arsimi, ku përmes Dekretit të Gylhanesë dhe më pas politikave të Tanzimatit, u synua krijimi i një sistemi arsimor të unifikuar që do të reflektonte identitetin dhe interesat e Perandorisë. Mirëpo, për trojet shqiptare këto reforma mbetën kryesisht teorike, pasi arsimi vazhonte të zhvillohej përmes shkollave të huaja dhe fetare, duke lënë jashtë edukimit kombëtar pjesën më të madhe të popullsisë shqiptare.

Për administratën osmane, arsimi luante një rol kyç në kontrollin e territoreve, dhe për këtë arsye, çdo përpjekje për përfshirjen e gjuhës shqipe dhe krijimin e një identiteti kombëtar shqiptar ishte subjekt i shtypjes së rreptë nga autoritetet osmane. Sistemi arsimor parauniversitar i Perandorisë, që përfshinte shkollat fillore (ruzhdiqe), shkollat e mesme (iptida) dhe liceumet (idadiqe), ishte ndërtuar për të forcuar strukturat osmane dhe për të promovuar kulturën dhe gjuhën osmane në të gjitha trevat e saj. Megjithatë, në kontekstin shqiptar, ky sistem mbeti jashtë mundësisë për një pjesë të madhe të popullsisë, e cila synonte ruajtjen e identitetit dhe kulturës së saj.

Në periudhën e Tanzimatit, Perandoria filloi të shohë si të domosdoshëm krijimin e një institucioni qendror për arsimin që do të adresonte interesat dhe kërkesat specifike të popullsisë jomyslimane të Perandorisë, përfshirë shqiptarët. Në këtë kuadër, në vitin 1864 u krijuan këshillat arsimore në çdo vilajet, të cilat synonin ndërtimin dhe mbikëqyrjen e shkollave në nivel lokal. Në vitin 1883, në Vilajetin e Shkodrës u themelua drejtorja e arsimit, që do të drejtohej nga intelektualit dhe arsimtari i shquar, Daut Boriçi, për rreth 13 vite. Gjatë

The Poetry of Mjedës and the Typology of Its Interpretations

Since the publication of his first poetry collection, *Juvenilia* (Vienna, 1917), Mjedja’s poetry has sparked a continuous debate among scholars regarding the identification of his style, the value of his poetic works, the literary school he represents, and the place of his oeuvre within our literary tradition.

The relationships established with the poetry and the author himself—Mjedja (his education, family background, etc.)—have led to different perspectives on his method: pre-1945 criticism, focused on technical principles, characterised Mjedja as a poet with classicist and neoclassicist tendencies. In contrast, post-1945 official criticism, driven by ideological and thematic considerations, viewed him as a Romantic poet with realist inclinations. Post-1990 criticism, on the other hand, offers a more text-oriented approach. This paper will primarily examine the reception of Mjedja’s poetry over time, as well as explore the typology of interpretations of his work.

Alma Hafizi, Melisa Paci (Ballata)

Ndikimi i artit pamor italian në Shkodër. Një udhëtim kulturor

Shkodra ka pasur ndër shekuj një marrëdhënie të veçantë e të shumanshme me Italinë. Studimi ynë do të përqëndrohet tek roli i arteve pamore në këte marrëdhënie.

Shekulli XIX shënon transformimin thelbësor të kulturës vizive dhe marrëdhënies me imazhin (pikturën, fotografinë, arkitekturën apo skenografinë) falë ardhjes së italianit Pietro Marubbi në Shkodër e figurës poliedrike të Kole Idromenos. Një vend të veçantë në konsolidimin e kësaj marrëdhënie zë hapja në Shkodër e shkollës italiane “Arte e Mestieri” në vitin 1901, e ngjashme me simotrat e saj në Itali dhe me gjerë, për të cilën deri tani nuk është hulumtuar si duhet. Jo rastësisht kjo shkollë u frekuentua nga një piktor si Simon Rrota që bashkë me Zef Kolombin, Vladimir Janin apo Kel Kodhelin vazhduan studimet në akademitë italiane të kohës duke pasuruar prurjet e ndikimeve të shkollës italiane në artet pamore dhe duke i ndërthurur me ndjeshmerinë dhe atmosferën shqiptare.

Vitet e regjimit e ndërprejnë këtë komunikim, por piktori shkodran, Lin Delija, zhvillonte në Itali personalitetin e tij artistik duke mos u ndarë asnjherë nga motivet e vendlindjes. Mbas viteve ‘90 raportet riaktivizohen me studentë të tjerë shkodranë që shkollohen në akademitë e ndryshme italiane. Në nivel institucionesh këtë traditë e mbajnë gjallë dhe e çojnë më tej me anë të ekspozitave, rezidencave, apo punëtorive dy realitete shumë aktive në jetën kulturore të qytetit, Muzeu Kombëtar i fotografisë Marubi dhe Fondacioni Art House, një iniciativë private me vokacion të spikatur publik.

Studimi ynë do të mbështetet në materiale arkivore italiane dhe shqiptare, publikime të ndryshme të gjetura në bibliotekat e dy vendeve, kujtime e përshkrime të personave që kanë jetuar këto ngjarje, materialet vizive të Muzeut Marubi dhe të Fondacionit Art House.

The Influence of Italian Visual Art in Shkodra: A Cultural Journey

Shkodra has maintained a unique and multifaceted relationship with Italy over the centuries. This study will focus on the role of the visual arts in this relationship.

The 19th century marks a significant transformation in visual culture and its connection to imagery (painting, photography, architecture, and scenography), largely due to the arrival of the Italian Pietro Marubbi in Shkodra and the multifaceted figure of Kole Idromeno. A pivotal moment in consolidating this relationship was the establishment of the "Arte e Mestieri" Italian school in Shkodra in 1901. This school, similar to its counterparts in Italy and beyond, has not been sufficiently researched until now. It is no coincidence that this school was attended by painters such as Simon Rrota, who, alongside Zef Kolombi, Vladimir Jani, and Kel Kodheli, continued their studies at Italian art academies, enriching the influence of the Italian school on visual arts and intertwining it with Albanian sensibilities and atmosphere.

The regime years interrupted this exchange, but the Shkodran painter, Lin Delija, developed his artistic identity in Italy, consistently drawing inspiration from the motifs of his homeland. After the 1990s, these connections were revived by other Shkodran students who studied at various Italian academies. On an institutional level, this tradition has been preserved and advanced through exhibitions, residencies, and workshops organised by two highly active entities in the city's cultural life: the "Marubi" National Museum of Photography and the "Art House" Foundation, a private initiative with a strong public vocation.

This study will be based on Italian and Albanian archival materials, various publications from the libraries of both countries, memories and descriptions from those who experienced these events, and visual materials from the "Marubi" Museum and the "Art House" Foundation.

Keywords: visual arts, Italian school, influence, Shkodran painters, tradition.

Vjollca Osja

Poezia e Mjedës dhe tipologjia e interpretimeve mbi të

Që nga botimi i përmbledhjes së parë poetike "Juvenilia" (Vjenë, 1917), poezia e Mjedjes ka nxitur në vijimësi një varg reagimesh mes studiuesve në lidhje me përcaktimin e stilit dhe vlerave të tekstit të tij poetik, shkollës që përfaqëson dhe pozicionit të veprës së tij në sistemin tonë letrar.

Nga raportet që u vendosen me poezinë apo edhe me vetë autorin Mjedjen (shkollimi i tij, background-i familjar etj.) do të përvijoheshin qëndrime relativisht të ndryshme në lidhje me metodën e përdorur: mendimet e kritikës së para '45-s, nisur nga parime teknike do të shihnin te Mjedja poetin me prirje klasiciste e neoklasiciste, ndërkohë që kritika zyrtare e pas '45 -s, nisur nga parime ideo- temore, shikonte te poeti romantikun me prirje realiste, ndërkohë që kritika e pas '90-s ofrohet me qasje më tekstocentrike.

Në këtë kumtesë do të fokusohemi kryesisht në çështje të receptimit të poezisë së Mjedjes në kohë të ndryshme, si dhe në evidentimin e tipologjisë së interpretimeve mbi të.

Technology in the Service of Tourism in Shkoder: Literature Review

This article explores the impact of technology on the development of tourism in Shkodra during the 21st century, focusing on contributions made by researchers in this field. Since the fall of communism, Shkodra has experienced a revival of cultural and economic life, with technology playing a significant role in the tourism sector. Innovations such as travel applications, automated hotel check-in systems, and augmented reality (AR) and virtual reality (VR) applications have been integrated into the tourism experience, all while preserving the city's rich traditions.

Methodology: We reviewed sources from SpringerLink, Google Scholar, and ResearchGate using search terms like "integration of technology in tourism," "innovative technology in tourism services," and "tourism in Shkodra during the 21st century." A search focused on Northern Albania yielded 9,800 articles. Narrowing the search with specific key phrases resulted in 198 articles, of which 20 were selected for in-depth analysis.

Results: The findings were categorised into three groups based on the regions where technology intersects with tourism, enabling an examination of differences, impacts, and opportunities for improvement in sustainable tourism. These groups include Shkodra, the Northern region of Albania, and other designated areas in the country.

Conclusions: The integration of technology into tourism creates significant opportunities for the development of a sustainable tourism sector. Technology facilitates Ecotourism by promoting environmentally responsible practices among tourists. It also enables the identification of tourist preferences, facilitating the development of tailored services. Key areas, where technology enhances the experience for both tourists and locals, include online promotion, reservations, e-commerce, and infrastructure development.

Amila Gjyrezi

Mullinjtë e ujit në Veriun e Shqipërisë

Në Shqipërinë Veriore, veçanërisht në terrenin e thyer malor, mullinjtë e ujit kanë pasur një rëndësi të madhe historike, kulturore dhe ekonomike, të ruajtur përmes brezave si pjesë e trashëgimisë popullore. Ndaj dhe vendosëm që përmes kësaj trajtese të sjellim në vëmendje një element të rëndësishëm siç janë mullinjtë e ujit dhe rëndësia e tyre për kohën. Edhe qyteti i Shkodrës kishte mullinj të shumtë, disa prej të cilëve përmenden që në dokumentet veneciane të vitit 1416. Një dëshmi e hershme në lidhje me mullinjtë e qytetit vjen nga Marin Barleti në shekullin XV, i cili përmendte mullinjtë si pjesë të rëndësishme të jetës së Shkodrës gjatë "Rrethimit të Shkodrës." Këto mullinj siguronin miellin për gjithë popullsinë dhe ishin një burim për tregti dhe punë për mjeshtrit lokalë. Në shumë fshatra, mullinjtë janë ndërtuar pranë rrjedhave të lumenjve dhe përdorshin nga të gjithë banorët e zonës. Për shembull, në fshatin Millë, deri vonë, kishte afërsisht 50 mullinj, ndërsa lugina e Cemit kishte mbi 15 mullinj. Çdo fshat shpesh kishte disa mullinj që përdorshin nga të gjithë banorët e zonës, duke i dhënë një rol qendror mullisit në komunitet. Këto mullinj siguronin miellin për gjithë popullsinë dhe ishin një burim për tregti dhe punë për mjeshtrit lokalë.

Water Mills in Northern Albania

In Northern Albania, particularly within its mountainous regions, water mills have served as essential historical, cultural, and economic structures, preserved across generations as part of the local heritage. This study aims to highlight the significance of water mills and their role in the past. The city of Shkodra housed many of these mills, some of which appear in Venetian records dating back to 1416. In the 15th century, Marin Barleti referenced these mills as crucial elements of Shkodra's daily life during the "Siege of Shkodra." These mills not only supplied flour to the entire population but also supported trade and provided employment for local craftsmen.

Throughout many villages, mills were constructed along riverbanks and served entire communities. For example, the village of Mille contained nearly 50 mills until recent times, and the Cem Valley had more than 15. Each village frequently maintained several mills shared by residents, establishing the miller as a central figure within the community. These mills provided flour for local consumption and were integral to local trade and craftsmanship.

Verjona Peqini, Ardita Boriçi

Teknologjia në shërbim të turizmit në Shkodër

Kontributi ynë në këtë artikull është të zbulojmë ndikimin që studiues të tjerë kanë dhënë në zbatimin e teknologjisë për nxitjen e zhvillimit të turizmit në Shkodër gjatë shekullit XXI. Pas rënies së komunizmit, Shkodra ka përjetuar një rinovim të jetës kulturore e ekonomike, përfshirë implementimin e teknologjisë në turizëm me aplikacionet e udhëtimit, automatizimin e procesit të regjistrimit nëpër hotele, aplikacionet e realitetit të zgjeruar AR dhe atij virtual VR, duke mbajtur traditat e saj të pasura ndër shekuj.

Metodologjia: Përdorëm: SpringerLink, Google Scholar, Research Gate me ndihmën e frazave: "integrimi i turizmit me teknologjinë", "teknologjia inovative në shërbim të turizmit", "turizmi në Shkodër gjatë shekullit XXI". Përcaktimi i zonës së veriut gjeneroi 9,800 artikuj. Rritja e përdorimit të fjalëve kyçe kufizoi kërkimin në 198 artikuj nga të cilët 20 u zgjodhën.

Rezultatet: U bë ndarja në tre grupe sipas zonës ku teknologjia ndërthurej me turizmin, për të parë ndryshimet, efektet dhe mundësitë për përmirësim në turizmin e qëndrueshëm. Grupet përfshinin Shkodrën, zonën e veriut dhe zonat e tjera të mbetura të etiketuara të zhvilluara në Shqipëri.

Konkluzionet: Integrimi i teknologjisë me turizmin jep mundësi për zhvillimin e një sektori turistik të qëndrueshëm. Teknologjia ndihmon promovimin e aktiviteteve të eko-turizmit duke inkurajuar turistët të angazhohen në mënyra që respektojnë mjedisin. Përdorimi eficient i saj ndihmon në identifikimin e preferencave të turistëve, duke lejuar zhvillimin e ofertave të përshtatshme. Promovimi online, rezervimi, e-commerce, zhvillimi i infrastrukturës mbeten pika kyçe ku teknologjia jep përvojë më të mirë për turistët dhe vendasit.

Phonetics in the 20th Century Albanian Grammars: Focus on Shkodra Authors

The initial study of the Albanian language is tied to the early development of Albanian-language education in both northern and southern Albania. In the 17th century, the need to study and formalise Albanian arose alongside efforts to establish economic and political independence from foreign rulers and to promote national education in Albanian, allowing the native language to gain prominence in trade, politics, and social life.

The earliest grammatical records appeared in the 17th century, beginning with F. Bardhi's Latin-Albanian Dictionary (1635), and were further developed in the 18th century with M. Da Lecce's Grammatical Notes (1716). Until the late 19th century, most Albanian grammars were published in foreign languages, even when the authors were Albanian. The sole exception was S. Frashëri's grammar, published in Albanian in 1886. With Albania's independence in the 20th century, there was an increased demand for educational materials in Albanian, which spurred a rise in grammar publications in the native language.

Anisa Kosteri

Qasje gjuhësore antropologjike ndaj ligjeve dhe zakoneve të vjetra në veriun e Shqipërisë, përmes romanit “Lule” të Atë Fabian Barcatës

Gjuhësia antropologjike studion zakonet e njerëzve, gjuhën e tyre dhe përditshmërinë. Ajo mbështetet në vëzhgimin e bisedave, mbledhjen e historive gojore, tregimeve jetësore, njohuri mbi kulturën dhe historinë e vendit, mbi zakonet, mitet, besëtytnitë . Përmes kësaj kumtese, synohet të nxirret në pah koloriti i botës shqiptare të maleve të Veriut. Romani paraqet realitetin e jetës shqiptare të këtyre maleve, përmes karaktereve njerëzore, ndjesitë emocionale të tyre që shpalosen shumë bukur nëpërmjet gjuhës së përdorur dhe leksemave shprehëse e kuptimplote të gegërishtes. Autori, duke njohur nga afër personazhet, duket i mrekulluar nga ai mjedis, me shpirtin e gjerë të malësorëve, me cilësitë e lavdërueshme në përjetimin e emocioneve që të vë përpara vetë jeta. Një karakteristikë e autorit, është se ai i ka bërë një analizë të hollësishme hulumtimit të dokeve e zakoneve, ligjeve e besëtytnive. Kjo e bën më interesante veprën dhe analizën gjuhësore përmes këtyre qasjeve antropologjike.

An Anthropological, Linguistic Approach to the Laws and Old Customs of Northern Albania Through the Novel Lule by Father Fabian Barcata

Anthropological linguistics studies the customs, language, and everyday life of people. It is based on observing conversations, collecting oral histories, life stories, and knowledge of a place's culture and history, as well as its customs, myths, and superstitions. Through this approach, the aim is to highlight the richness of the Albanian world in the northern mountains.

The novel portrays the reality of life in these mountains, through human characters and their emotional experiences. They are beautifully conveyed through the language used and the expressive, meaningful lexemes of the Gheg dialect. The author, having closely observed the characters, seems captivated by this environment, appreciating the broad spirit of the mountain people and their admirable qualities in experiencing emotions that life itself presents.

A distinctive feature of the author is his thorough analysis of the native customs, laws, and superstitions. This adds depth to the work and permeates its linguistic analysis.

Valbona Sinanaj

Trajtimi i fonetikës në gramatikat shqipe të shek.XX, rasti i autorëve shkodranë

Përpjekjet e para për studimin e gjuhës shqipe lidhen me fillimet e arsimit shqip në Shqipëri, në Veri dhe në Jug. Studimi i gjuhës shqipe, në shekullin e XVII erdhi si një domosdoshmëri e zhvillimin paralel të pavarësisë ekonomike-politike nga pushtuesit dhe zhvillimin e arsimit kombëtar me gjuhë mësimi shqipen, që çonte në përdorimin e gjuhës amtare në marrëdhëniet tregtare, politike e shoqërore.

Shënimet e para gramatikore nisën të dalin që nga shek. XVII me "Fjalorin latinisht-shqip" i F. Bardhit (1635), për të vijuar me shek. XVIII, me "Shënime gramatikore" të M. Da Leçes (1716). Deri në fund të shek. XIX gramatikat e gjuhës shqipe janë botuar në gjuhë të huaj, edhe në ato raste kur autorët kanë qenë shqiptarë. E vetmja gramatikë e botuar në shqip në këtë periudhë ka qenë ajo e S. Frashërit e vitit 1886. Intesiteti i botimeve të gramatikave në gjuhën shqipe fillon të rritet në shek. XX, pasi Shqipëria ka fituar pavarësinë dhe shkolla jonë kishte nevojë për tekste në gjuhën amtare.

The Potential for Creating a Migjeni Theatre Museum in Shkodra:

The Role of Cultural Heritage in the Development of Performing Arts and Cultural Tourism

Museums have played a pivotal role in preserving cultural heritage since antiquity, evolving from temples and private collections of aristocrats into public institutions dedicated to safeguarding and educating the public about cultural treasures. In cities with rich heritage like Shkodra, institutions such as the Historical Museum, the National Museum of Photography "Marubi," the Rozafa Castle Museum, and the Museum of Memory, alongside experimental initiatives like "Art House," reflect not only the city's cultural and historical wealth but also its contribution to national history and global civilisation.

Since its founding on November 24, 1949, the Migjeni Theatre has been a cornerstone of dramatic arts and Albanian culture. This study explores the potential for establishing a museum dedicated to the Migjeni Theatre and Performing Arts, examining the key aspects of this project. The focus is on preserving historical elements and heritage, highlighting key figures of the theatre, its architecture, collections, and artefacts, as well as incorporating modern technologies to enhance visitor engagement.

The paper will propose recommendations for a collaborative project between the University and the Municipality of Shkodra, offering both scientific and practical arguments aimed at the city's economic development through the mobilisation of its cultural potential.

Keywords: museum, cultural heritage, cultural tourism, theatre history.

Arben PRENDI

Tradita etnokulturore e Shqipërisë së Veriut në prozat e Martin Camajt

Në këtë kumtesë bëhet një vështrim mbi gjurmët e traditës etnokulturore të malësive të Shqipërisë së Veriut në prozat e shkrimtarit Martin Camaj, në romanet e në disa tregime dhe novela.

Në këto proza Camaj paraqet artistikisht mbijetesën e kësaj tradite në përballje me një botë në ndryshim në disa raste për shkak të ideologjisë, në raste të tjera për shkak të ndryshimit të mënyrës së jetesës së popullatës, emigracionit, etj.

Në këtë traditë, ai gjen thelbin e identitetit të mbijetuar të shqiptarit në skaje të qytetërimeve të tjera, në përballje me natyrën e ashpër, pushtuesit, ideologjitë dhe kohën. Këto proza mund të shihen edhe si një përpjekje e autorit për të ndërtuar kujtesën kulturore të kësaj tradite, ndërkohë që ajo po zhdukej. Krijimi i kësaj kujtese është veç të tjerash edhe një formë kompensimi e mungesës së vendlindjes për autorin.

The Ethnocultural Tradition of Northern Albania in Martin Camaj's Prose

This paper examines the traces of the ethnocultural tradition of Northern Albania's mountainous regions in the prose works of writer Martin Camaj, focusing on his novels, short stories, and novellas. In these works, Camaj vividly portrays the survival of this tradition in the face of a changing world, at times due to ideological shifts, and at other times because of changes in the population's way of life, emigration, and more.

Within this tradition, he uncovers the core of Albanian identity that has endured on the margins of other civilisations, confronting harsh nature, invaders, ideologies, and the passage of time. These prose works can also be viewed as the author's effort to preserve the cultural memory of a vanishing tradition. The creation of this memory, moreover, serves as a means of compensating for the author's personal sense of loss related to his homeland.

Valbona Karakaçi, Astrit Fani

Potenciali për krijimin e një muzeu të teatrit "Migjeni" në Shkodër: Roli i trashëgimisë kulturore në zhvillimin e artit skenik dhe turizmit kulturor

Muzetë kanë luajtur një rol kyç në ruajtjen e trashëgimisë kulturore që nga lashtësia, duke kaluar nga tempujt dhe koleksionet private të aristokratëve në institucione publike që ruajnë dhe edukojnë për pasuritë kulturore. Në qytete me trashëgimi të pasur si Shkodra, institucione si Muzeu Historik, Muzeu Kombëtar i Fototekës "Marubi", Muzeu i Kalasë Rozafa, dhe Muzeu i Memories, si edhe nismat eksperimentale si "Art House", dëshmojnë rëndësinë e kulturës dhe historisë së qytetit në historinë kombëtare dhe më gjerë.

Teatri "Migjeni", që nga themelimi më 24 nëntor 1949, ka qenë një shtyllë e rëndësishme e artit dramatik dhe kulturës shqiptare. Ky studim shqyrton mundësinë e krijimit të një muzeu të dedikuar teatrit "Migjeni" dhe artit skenik, duke analizuar aspektet kyçe të këtij projekti. Fokus kryesor janë ruajtja e elementeve historike dhe trashëgimia, figurat kryesore të teatrit, arkitektura, koleksionet, artefaktet, dhe integrimi i teknologjive moderne për të përmirësuar ndërveprimin me vizitorët.

Punimi do të paraqesë rekomandime për një projekt të përbashkët mes Universitetit dhe Bashkisë së Shkodrës, duke ofruar argumente shkencore dhe praktike për zhvillimin ekonomik të qytetit përmes fuqizimit të potencialit të tij kulturor.

On the Social, Economic, Cultural, and Familial Aspects of Ulcinj Albanian Families’ Integration into the City of Shkodër from the Late 19th Century

This study explores the integration of Albanian families from Ulcinj into Shkodër over several historical periods: beginning in the late 19th century, continuing through the Russo-Turkish War, the annexation of Montenegro, and later, the Balkan Wars, World War I, and World War II. These events profoundly disrupted the social and economic life of Albanian families in Ulcinj. Shkodër’s community provided a welcoming environment that supported the natural integration of nearly 230 families, representing 170 family lineages, who settled and built new lives in the city. By 1993, 600 families, totalling around 2,500 people and constituting about 3% of Shkodër’s population, were recorded as Ulcinj Albanian descendants. Among these settlers were around 60 women from Ulcinj who married into Shkodran families between 1905 and 1944, further strengthening bonds between the two cities and solidifying a shared cultural and spiritual connection.

These families adapted easily to life in Shkodër, yet their arrival also contributed significantly to the city’s economic and social vibrancy. Ulcinj families brought renewed energy to Shkodër’s trade and economy with their fleet of ships— at first sail-powered, later motorised—that facilitated active commerce across the Adriatic and Mediterranean. These ships transported goods from cities throughout the Mediterranean and reached as far as France, England, the Middle East, and even India. Traders from various countries preferred Ulcinj ships for the reliability and safety they offered for transporting goods. The contributions of these families extended beyond economics, influencing Shkodër’s cultural, educational, and scientific landscape, as many became active contributors to the city’s development in these fields.

Arian Gjura, Brilanda Bushati, Lorna Bushati

Ritja e vlerës turistike përmes përvojave Ndërvepruese të artizanatit në Shkodër

Shkodra, një qytet me trashëgimi të pasur kulturore dhe tradita të forta artizanale, ka potencial unik për të zhvilluar turizmin përmes përvojave ndërvepruese në artizanat. Ky punim shqyrton mundësinë e përfshirjes së turistëve në punishtet artizanale lokale, ku ata mund të shohin dhe përjetojnë nga afër procesin e krijimit të produkteve tradicionale dhe të kontribuojnë në këtë proces nën udhëheqjen e mjeshtërve artizanë. Në këtë mënyrë, turistët jo vetëm që njohin traditat dhe kulturën lokale, por krijojnë një lidhje më të thellë dhe të qëndrueshme me destinacionin, duke e bërë vizitën e tyre një përvojë të paharrueshme dhe autentike.

Pjesëmarrja në këto përvoja artizanale ndikon drejtpërdrejt edhe në ekonominë lokale, duke krijuar të ardhura për artizanët përmes tarifave për vizitën dhe blerjen e produkteve të krijuara nga vetë turistët. Ky model jo vetëm që rrit vlerën e ofertës turistike të Shkodrës, por gjithashtu promovon zhvillimin e qëndrueshëm duke ofruar mundësi punësimi dhe mbështetje për artizanët lokalë. Për më tepër, ky koncept kontribuon në ruajtjen dhe promovimin e kulturës dhe traditave vendase në një treg gjithnjë e më të globalizuar.

Ky punim gjurmon sfidat dhe mundësitë e modelit të përvojave ndërvepruese në artizanat për Shkodrën, duke e vlerësuar atë si një mjet efektiv për ta kthyer qytetin në një destinacion të veçantë, ku turistët nuk janë vetëm vizitorë pasivë, por bashkëkrijues të përvojave të tyre.

Enancing Tourist Value through Interactive Craft Experiences in Shkodra

Shkodra, a city with a rich cultural heritage and strong artisanal traditions, holds unique potential to develop tourism through interactive craft experiences. This paper explores the opportunity to engage tourists in local workshops, where they can observe and participate firsthand in the creation of traditional products, guided by skilled artisans. In this way, tourists not only gain insight into local traditions and culture but also form a deeper and more lasting connection with the destination, making their visit an unforgettable and authentic experience.

Participation in these craft experiences has a direct impact on the local economy, generating income for artisans through fees for visits and the purchase of products created by the tourists themselves. This model not only enhances the value of Shkodra's tourism offerings but also promotes sustainable development by creating employment opportunities and supporting local artisans. Additionally, it contributes to the preservation and promotion of local culture and traditions in an increasingly globalised world.

This paper examines the challenges and opportunities of the interactive craft experience model for Shkodra, considering it an effective tool for transforming the city into a distinctive destination where tourists are not merely passive visitors but co-creators of their own experiences.

Valbona Kalaja

Mbi disa aspekte sociale, ekonomike, kulturore dhe familjare të vendosjes e integritit të familjeve shqiptare ulqinake në qytetin e Shkodrës qysh nga fundi i shekullit XIX

Në këtë trajtesë bëhet fjalë për vendosjen e familjeve shqiptare ulqinake në Shkodër, në disa periudha kohore (qysh në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XIX, në fund të Luftës ruso-turke e aneksimit të Malit të Zi, e më tej përgjatë Luftës Ballkanike, Luftës së Parë Botërore e Luftës së Dytë Botërore), periudha të cilat tronditën fort jetën social-ekonomike të familjeve shqiptare në Ulqin. Mjedisi në qytetin e Shkodrës u tregua mikpritës i këtyre ardhësve dhe mundësoi integrimin e natyrshëm të pothuaj 230 familjeve, të përfaqësuar nga 170 trungje familjare, të cilat vijuan jetën e tyre në këtë mjedis. Në vitin 1993, regjistroheshin 600 familje, me afërsisht 2500 banorë, që përbënin rreth 3% të popullsisë së qytetit të Shkodrës. Pjesë e këtyre ardhësve janë edhe rreth 60 vajza të ardhura nga Ulqini e të martuara në familje shkodrane në vitet 1905-1944. Ardhja e këtyre banorëve në Shkodër forcoi shumë më tepër lidhjet shpirtërore të banorëve të Ulqinit me qytetarët shkodranë, duke i lidhur më shumë këto dy qytete të vjetra shqiptare me njëri-tjetrin. Këto familje u ambientuan pa vështirësi me jetën e këtij qyteti me emer; por ardhja e tyre ndikoi, nga ana tjetër, në gjallërimin e veprimtarisë ekonomike e sociale të këtij qyteti. Kështu ulqinakët, me anijet e tyre, më parë me vela dhe më vonë me motora e vela, i sollën gjallëri tregtisë dhe ekonomisë së këtij qyteti. Ata sillnin mallra nga të gjitha qytetet e bregdetit të Adriatikut, të Mesdheut; madje shkuan deri në Francë dhe Angli, në vendet e Azisë së Vogël, ato arabe, duke arritur deri në Indi. Tregtarët e shteteve të tjera parapëlqenin transportin e mallrave me anijet ulqinake, mbasi ishin të sigurtë se malli i tyre do të shkonte në destinacione shumë të garantuar. Ndikimi i kontributit të këtyre familjeve në mjedisin e qytetit të Shkodrës ishte jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe atë kulturor, arsimor e shkencor, ku përfaqësues të këtyre familjeve iu bashkuan përpjekjeve të qytetarëve shkodranë për zhvillime të dukshme në këto fusha.

The Role, Status, and Rights of Women in Medieval Albanian Society: The Case of Shkodra and Drishti

Historical records related to political, economic, cultural, and other issues during the medieval period provide valuable insights into the role, status, and rights of women in Albanian society. This paper specifically examines the role of women in Shkodra and Drishti. Based on period documents, it is evident that during the Middle Ages, women in both cities had the right to draft wills, participate in inheritance, and bequeath parts of their wealth to others. Additionally, the statutes of these two cities offer significant information regarding the rights and roles of women in Shkodra and Drishti. This paper will explore women's contributions to political and economic affairs, their inheritance rights, and other relevant issues, while also analysing the inclusion of women in the statutes of Shkodra and Drishti.

Keywords: Shkodra, Drishti, Middle Ages, statutes, Albanian.

Artan Haxhi, Zamira Shkreli

Shtypshkronjat e Shkodrës dhe ndikimi Si tyre në kulturën shqiptare

Ky studim ka për qëllim të ndërtojë një analizë të thelluar mbi kontributin dhe ndikimin e shtypshkronjave të Shkodrës në formësimin e kulturës dhe identitetit kombëtar shqiptar, duke e vendosur këtë fenomen në një kornizë shkencore dhe historike. Shkodra, si një nga epiqendrat kulturore dhe intelektuale të Shqipërisë, përfaqëson një hapësirë të pasur për zhvillimin e shtypit shqiptar, ku shtypshkronjat kanë luajtur një rol themelor në përhapjen e gjuhës shqipe, kulturës kombëtare dhe emancipimit intelektual të shoqërisë shqiptare.

Duke u bazuar në studimet e Markus E. E. Peters, ky kërkim përqendrohet në shtypshkronjat e Shkodrës si "bastione të rezistencës kulturore dhe gjuhësore" gjatë periudhave kritike të historisë kombëtare, duke i vlerësuar ato jo vetëm si qendra të prodhimit letrar dhe publicistik, por edhe si katalizatorë të ndërgjegjes kombëtare dhe frymës së Rilindjes. Peters i përshkruan këto shtypshkronja si "fortesa të gjuhës dhe kulturës shqiptare," që kontribuuan në ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kombëtare përmes botimeve të guximshme, shpeshherë në kushte të vështira politike dhe sociale.

Përmes analizës së burimeve arkivore, dokumenteve historike dhe botimeve të epokës, studimi synon të shqyrtojë evoluimin teknologjik, sfidat ideologjike dhe përparësitë kulturore që kanë karakterizuar shtypshkronjat e Shkodrës ndër vite. Do të hetohen aspekte të ndryshme të aktivitetit të tyre, duke përfshirë rolin e tyre gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, gjatë shpalljes së Pavarësisë dhe nën regjimin komunist, për të identifikuar mekanizmat përmes të cilëve këto qendra kanë promovuar dhe mbrojtur identitetin kombëtar shqiptar.

Në përfundim, ky studim synon të kontribuojë në diskursin shkencor mbi rolin e shtypshkronjave si aktorë të fuqishëm në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe në avancimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Kjo qasje e thelluar, e mbështetur në teoritë dhe konstatimet e Peters, synon të nxjerrë në pah rëndësinë e pazëvendësueshme të këtyre institucioneve në pasurimin dhe mbrojtjen e identitetit kombëtar shqiptar.

The printing presses of Shkodër and their impact on albanian culture

This study aims to conduct an in-depth analysis of the contribution and impact of Shkodër's printing presses on shaping Albanian culture and national identity, placing this phenomenon within a scientific and historical framework. Shkodër, as one of the cultural and intellectual epicenters of Albania, represents a rich space for the development of Albanian press, where printing presses have played a fundamental role in spreading the Albanian language, national culture, and the intellectual emancipation of Albanian society.

Drawing upon the studies of Markus W. E. Peters, this research focuses on the printing presses of Shkodër as "bastions of cultural and linguistic resistance" during critical periods of national history, evaluating them not only as centers of literary and journalistic production but also as catalysts of national consciousness and the spirit of the Albanian Renaissance. Peters describes these presses as "fortresses of the Albanian language and culture," contributing to the preservation and development of national values through bold publications, often produced under challenging political and social conditions.

Through the analysis of archival sources, historical documents, and publications from the era, the study aims to explore the technological evolution, ideological challenges, and cultural priorities that have characterized Shkodër's printing presses over the years. It will investigate various aspects of their activities, including their role during the National Renaissance, the declaration of Independence, and under the communist regime, to identify the mechanisms through which these centers have promoted and defended Albanian national identity.

In conclusion, this study seeks to contribute to the scientific discourse on the role of printing presses as powerful actors in preserving cultural heritage and advancing the Albanian language and culture. This in-depth approach, supported by Peters' theories and findings, aims to highlight the irreplaceable significance of these institutions in enriching and safeguarding Albanian national identity.

Teuta Shala Peli

Roli, pozita, dhe të drejtat e gruas në shoqërinë rmesjetare arbërore, rasti i Shkodrës dhe Drishtit

Të dhënat dokumentare që iu referohen ngjarjeve dhe problemeve politike, ekonomike, kulturore e më gjerë gjatë Mesjetës, dëshmojnë për rolin, pozitën dhe të drejtat e gruas në hapësirat arbërore. Në këtë kumtesë ne do të fokusohemi tek roli i gruas në Shkodër dhe Drisht. Bazuar në dokumentet e kohës, gjatë Mesjetës gruaja në Shkodër dhe Drishtë gëzonte të drejtën edhe për hartimin e testamenteve, merrte pjesë në trashëgimi, si dhe kishte të drejtë t'iu linte të tjerëve pjesë nga pasuria e tyre. Të dhëna më rëndësi për rolin, pozitën dhe të drejtat e gruas në Shkodër dhe Drisht na ofrojnë edhe statutet e këtyre dy qyteteve.

Në kuadër të kësaj teme, ne do të fokusohemi te kontributi i gruas në çështjet politike dhe ekonomike, e drejta e saj në trashëgimi dhe çështje të tjera që i referohen këtij problemi, si dhe do të vëmë në dukje sa hapësirë iu është dhënë përfshirjes së gruas në statutet e Shkodrës dhe të Drishtit.

The Population of Shkodër Through the Lens of Geographical Researchers

Studies on Shkodër are numerous and varied. Among them, geographical research is particularly valuable due to its diversity, shaped by the specific focus of the geography discipline. Topics such as the general physical-geographical features, Shkodër's economic development over different periods, human activities, the dynamic transformations of socio-geographical spaces, and more, have been extensively explored by geography scholars.

In the context of the "Historical Geography of Shkodër," this paper seeks to provide an overview of the evolution of geographical studies on the population of Shkodër. Geographers have approached the subject from various angles, examining specific elements related to the development of Shkodër's population over time. This includes numerous scientific references, articles published both locally and internationally, monographs, books, and more, many of which focus on the population of Shkodër. Key topics include the evolution of the population, its geographical distribution, administrative divisions, neighbourhoods of Shkodër, associated issues, migration and its influencing factors, settlements in Shkodër, and more. These themes have been explored according to the type of scientific approach adopted by geographical researchers, a consideration that informs this paper.

Based on the scientific information we have gathered, we believe there is a significant opportunity to expand the "Historical Geography of Shkodër" by offering a comprehensive summary of the contributions of various authors and researchers who have examined the diverse aspects of Shkodër's population. Moreover, the material presented here opens the possibility for further studies on these themes, particularly regarding the evolution of the population and settlements in Shkodër.

Át Vitor Demaj, Karmen Lazri

Muzikologu i shquar Tonin Zadeja dhe arkivi i tij pranë Bibliotekës Françeskane

Ky studim hedh dritë mbi veprimtarinë e muzikologut të shquar Tonin Zadeja dhe mbi rëndësinë e arkivit të tij të çmuar, i cili ruhet pranë Bibliotekës Françeskane, duke u bërë një thesar i pasqor për kërkimet në fushën e muzikologjisë dhe kulturës shqiptare. Pas daljes në pension dhe me fillimin e një epoke të re të lirisë pas rënies së diktaturës, Zadeja thelloi kontributin e tij duke ribotuar e plotësuar punimet e mëparshme me elementë të rinj dhe reflektime të pjekura. Përmes një analize të mprehtë të veprave dhe figurave të mëdha të muzikës shqiptare, si Át Filip Mazrreku, Dom Mikel Koliqi, Frano Ndoja, Prenk Jakova, Tish Daija, Luka Kaçaj dhe Gjon Kujxhia, ai riktheu vlerën e trashëgimisë muzikore në kujtesën kombëtare dhe ndihmoi në ndërtimin e një identiteti kulturor të fortë.

Kontributi i Zadejes për Bibliotekën Françeskane merr një rëndësi të posaçme, pasi nëpërmjet këtij arkivi ai ndërtoi një bazament të rrallë të trashëgimisë muzikore shqiptare, duke dokumentuar dhe analizuar pendat më të shquara të muzikologjisë. Para vitit 1967, Zadeja kishte përgatitur në dorëshkrim një studim të rëndësishëm mbi figurën e njohur të muzikës shqiptare, Át Martin Gjoka, i cili, për shkak të klimës kulturore të asaj kohe, u detyrua të ruhej në fshehtësi deri në botimin e tij të plotë në vitin 1995 në revistën "Hylli i Dritës". Në vitin 2000, në bashkëpunim me muzikantin Tonin Daija, ai botoi veprën „250 Këngë qytetare Shkodrane,” një gur themeli në ruajtjen dhe përjetësimin e këngës qytetare shkodrane. Po ashtu, në vitin 2006, në kuadër të korpusit "Musica Albanica", botoi veprën «Jeta kulturore e Shkodrës,” e cila pasqyron historinë muzikore të kësaj treve nga mesi i shekullit XIX deri në mesin e shekullit XX, duke u përqendruar tek figurat që formësuan këtë traditë të pasur muzikore.

Arkivi i tij, përmbajtësor e i gjerë, i përbërë nga dokumente të vyera, studime, partitura muzikore dhe materiale të tjera, përfaqëson një testament të përkushtimit të Zadejes për të mbrojtur dhe promovuar

trashëgiminë muzikore kombëtare. Ky arkiv, i ruajtur me përkujdesje pranë Bibliotekës Françeskane, përbën një burim të paçmuar për studiuesit e së ardhmes dhe një dëshmi të përpjekjeve të tij të palodhura për të dokumentuar dhe përjetësuar pendat më të shquara të muzikës shqiptare.

Sokol Axhemi

Popullsia e Shkodrës në optikën e studiuesve gjeografë

Studimet shkencore mbi Shkodrën janë të shumta dhe të larmishme. Ndër to me shumë vlera janë edhe studimet shkencore gjeografike në diversitetin e tyre ndikuar nga fokusi i objektit shkencor të vetë gjeografisë. Tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike, zhvillimi ekonomik i Shkodrës në periudha të ndryshme, aktiviteti human, transformimet dinamike të hapësirës sociogjeografike, etj., janë tematika mjaft të evidentuara nga shumë studiues të gjeografisë.

Në kuadrin e gjeografisë historike të Shkodrës kemi tentuar të trajtojmë në materialin tonë shkencor disa konsiderata të përgjithshme mbi evolucionin e studimeve gjeografike mbi popullsinë e Shkodrës. Autorë dhe studiues gjeografë kanë realizuar studime në këndvështrime të ndryshme mbi elemente të veçantë të zhvillimeve që kanë shoqëruar ndër vite popullsinë e Shkodrës. Janë evidentuar ndër të tjera, referime shkencore të shumta, mjaft artikuj shkencorë, të publikuara brenda dhe jashtë vendit, botime, monografi, libra, etj., ku zënë vend trajtesat mbi popullsinë e Shkodrës. Ndër to vlen të përmenden fokuse studimore që u përkasin evolucionit të popullsisë, shpërndarjes gjeografike të saj, ndarjet administrative, lagjet e Shkodrës, problematikat bashkëshoqëruese të tyre, migrimin dhe faktorët ndikues, vendbanimet e Shkodrës, etj. Këto tematika janë trajtuar gjithmonë në varësi të llojit të punimit shkencor të aplikuar nga studiuesit gjeografë, gjë e cila është marrë në konsideratë nga ana e autorit të këtij punimi.

Nisur nga informacioni shkencor i hulumtuar nga ana jonë, kemi mendimin se evidentojmë një mundësi më të gjerë për të pasuruar gjeografinë historike të Shkodrës me një qasje interesante të pasqyrimin në mënyrë të përmbledhur të mjaft prej autorëve e studiuesve shkencorë që paraqesin të dhëna mbi elemente të veçantë të tematikave të larmishme popullsisë së Shkodrës. Në të njëjtën kohë materiali shkencor i paraqitur le të hapur mundësinë e studimeve të tjera në të ardhmen për mjaft nga çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me tematika të tilla, sidomos në këndvështrimin e evolucionit të popullsisë dhe vendbanimeve të Shkodrës.

THE ETHNOLOGICAL APPROACH AS A CULTURAL VALUATION OF A SOCIETY

The subjects of our theme are the different ethno-linguistic views which appear to us as the values and virtues of the human society. They seem to touch the full range of human productivity, displayed in different times and historical moments, inherited throughout generations.

Culture reflects the values and achievements of human society, created by man through thoughts, work and various artistic activities. It is the human value and virtue that identifies different peoples and societies, remaining and circulating among generations as a symbol of the personification of human creativity, born of man's hand and developed and cultivated by him.

The language reflects many ethno-cultural products which we encounter in different fields of oral creativity. Therefore the treatment of our topic has to do with the various ethno-linguistic approaches that we encounter in the speech-form of the city of Gjakova.

The purpose of this paper is to present different socio-cultural and artistic relations, views on life and the environment, ways of communication, greetings and honors, which are the “points” that derive from the culture of each people. Most widely in our topic we will explain how this country's ethno-linguistics reflects as part of the system of ethno-cultural values, in which areas of life it appears to us, as well as some of the oral creativity over the years.

The Renowned Musicologist Tonin Zadeja and His Archive at the Franciscan Library

This study highlights the work of the distinguished musicologist Tonin Zadeja and the significance of his invaluable archive, preserved at the Franciscan Library, which has become an unparalleled resource for research in the fields of musicology and Albanian culture. After retiring and with the onset of a new era of freedom following the fall of the dictatorship, Zadeja deepened his contribution by reprinting and expanding his previous works with new insights and mature reflections. Through a sharp analysis of the works and figures of great Albanian music, such as *At Filip Mazrreku*, *Dom Mikel Koliqi*, *Frano Ndoja*, *Prenk Jakova*, *Tish Daija*, *Luka Kaçaj*, and *Gjon Kujxhia*, he revitalised the value of musical heritage in the national consciousness and played a key role in building a strong cultural identity.

Zadeja's contribution to the Franciscan Library is especially significant, as it was through this archive that he established a rare foundation for Albanian musical heritage, documenting and analysing the most prominent figures in musicology. Before 1967, Zadeja had prepared an important manuscript on the renowned figure of Albanian music, *At Martin Gjoka*, which, due to the political climate of the time, had to remain secret until its full publication in 1995 in the journal *Hylli i Dritës*. In 2000, in collaboration with musician *Tonin Daija*, he published *250 Këngë qytetare Shkodrane (250 Urban Songs of Shkodra)*, a cornerstone in preserving and immortalising the urban songs of Shkodra. In 2006, as part of the *Musica Albanica* corpus, he published *Jeta kulturore e Shkodrës (Cultural Life of Shkodra)*, which traces the musical history of the region from the mid-19th century to the mid-20th century, focusing on the key figures who shaped this rich musical tradition.

His archive, comprehensive and extensive, consists of invaluable documents, studies, musical scores, and other materials, and stands

as a testament to Zadeja's commitment to protecting and promoting the national musical heritage. This archive, carefully preserved at the Franciscan Library, is an invaluable resource for future scholars and a testament to his tireless efforts to document and immortalise the most significant figures in Albanian music.

**Sindorela Doli-Kryeziu, Gentiana Muhaxhiri,
Elinda Rexha-Pruthi**

Çasjet etnolinguistike si vlera kulturore të një shoqërie

Objekt i temës sonë janë këndvështrimet e ndryshme etnolinguistike, të cilat na shfaqen si vlera dhe vrytyte të shoqërisë njerëzore. Ato ngërthejnë në vete fusha të gjëra të produktivitetit njerëzor, të shfaqura ndër kohëra dhe në momente të ndryshme historike e të trashëguara ndër gjenerata. Kultura reflekton vlerat dhe arritjet e shoqërisë njerëzore, të krijuara nga njeriu përmes të menduarit, punës dhe veprimtarive të ndryshme artistike. Ajo, është vlera dhe vrytyti njerëzor, që identifikon popuj dhe shoqëri të ndryshme, duke mbetur dhe qarkulluar ndër gjenerata si simbol i personifikimit të krijimtarisë njerëzore, që lindi nga njeriu dhe zhvillohet e kultivohet po nga ai. Gjuhësorja na pasqyron produkte të shumta të etnokulturës, të cilat i ndeshim në lëmenj të ndryshëm të krijimtarisë gojore. Prandaj, trajtimi i temës sonë, ka të bëjë mbi çasjet e ndryshme etnolinguistike, që i ndeshim në të folurën e qytetit të Gjakovës. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë raportet e ndryshme sociokulturore e artistike, pikëpamjet mbi jetën dhe rrethin, mënyrat e komunikimit, përshëndetjet e nderimet, të cilat janë "pikëza", që burojnë nga gurra e kulturës së secilit popull. Më gjerësisht në temën tonë do të shpjegojmë se si reflekton etnolinguistika e këtij vendi si pjesë e sistemit të vlerave etnokulturore, në cilat fusha të jetës na shfaqet ajo, si dhe disa pjesë nga krijimtaria gojore e kësaj treve ndër vite.

The Situation in the Vilayet of Shkodra on the Eve of Independence

The early 20th century stands as one of the most critical periods in the pursuit of resolving the Albanian national question. The fate of the Albanian people during this time was intricately linked to a variety of factors, particularly the condition of the Ottoman Empire, the emerging Balkan states, and the diplomatic strategies of the Great Powers. This paper seeks to provide an overview and analysis of the situation in the Vilayet of Shkodra on the eve of independence, as it offers a clear representation of the internal developments, Balkan clashes, and diplomatic maneuvering of the period.

At the dawn of the new century, the Vilayet of Shkodra was grappling with some of the most pressing issues facing the empire—territorial disputes, population movements away from conflict zones, and economic decline due to the war, the loss of markets, and fluctuating fiscal policies. It was here that the 1911 uprising of the highlanders of Upper Shkodra took place, a key event in the broader context of resolving the Albanian national question during the Albanian National Renaissance.

This paper draws primarily on Ottoman-era documentation to shed light on the movements and uprisings that failed to spread to other Albanian regions. While Albanian patriots supported and sought to promote these efforts in European diplomatic circles, they were unable to organise a nationwide response or seize the moment. This was largely because the situation in Shkodra was more complex than in other areas, as it was at crossroads for the conflicting interests of the Ottoman and Austro-Hungarian Empires. Amid this pressure, Albanian territories were increasingly threatened by the new Slavic Balkan states—Montenegro and Serbia—who aimed for territorial expansion, often with the backing of the Great Powers. For this reason, Shkodra was forced to raise the Albanian flag and declare independence after a year marked by fierce fighting and resistance.

Bahtijar Kryeziu

Vepër e rëndësishme nga një areal i veçantë i shqipes

(Gjovalin Shkurtaç, Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe, Tiranë, 2021)

Dija albanologjike e sidomos leksikografia shqiptare, me daljen në dritë të veprës së akademik Gjovalin Shkurtaçit, “Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe” (2021), u pasurua edhe me një vepër madhore e të rëndësishme, me prurje shumë të vlefshme nga një e folme e veçantë, ajo e Malësisë së Madhe.

Akademik Shkurtaç, për botimin e kësaj vepre ka pasur si mbështetje hulumtimit dhe studimet paraprake të tij nga ajo anë, siç janë: monografia e parë për të folmen e Kastratit, një skicë për të folmen e malësorëve të Bregut të Matës, të Ishullit të Lezhës e të Ishullit të Shëngjinit, si dhe monografitë për Hotin, Kelmendin, Rranxat e Mbishkodrës etj. për të cilën trevë, i biri i asaj ane, ka dashuri e mall të pashuar edhe sot, duke e pasuruar fjalorin në fjalë me fjalë e shprehje të reja gjatë rrjedhës së moteve. Është kjo lëndë e eksploruar, me ngadalë, kujdes e sens prej një eksperti të rrallë të dialektologjisë shqiptare; një korpus prej mbi 12300 leksemash, nga ato të folme rurale, ku shqipja flitet bash shqip.

Lënda shumë e pasur leksikore, frazeologjike dhe etno-folklorike e sociolinguistike, e paraqitur në këtë fjalor, të cilin korpus fjalësh e kemi bërë objekt studimi e analize në këtë kumtesë, janë: emra = 7329 (59,53%); folje = 1774 (14,40%); mbiemra = 1639 (13,31%); ndajfolje = 896 (7,27%) etj., siç shihen në punimin tonë, si dhe onomatope, eufemizma, frazeologjizma, fjalëshpejta etj., fjalë me burim të shqipes, shumicën nga të cilat fjalorët e shqipes nuk i kanë, e që një numër syresh mund të futen, si prurje të reja, në Fjalorin e madh të shqipes, i cili ka nisur hapat e parë të tij, në botim të ASH të Shqipërisë.

A Significant Work from a Distinct Area of the Albanian Language

(Gjovalin Shkurtaç, Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe, Tiranë, 2021)

Albanian studies, particularly Albanian lexicography, have been enriched by the publication of academician Gjovalin Shkurtaç's work, “Lexical-Phraseological and Ethnolinguistic Dictionary of Malësia e Madhe” (2021). This substantial and significant contribution provides valuable insights into the unique dialect of Malësia e Madhe.

For this publication, Academician Shkurtaç drew upon his prior research and studies from the region, including the first monograph on the Kastrati dialect, a sketch of the dialects spoken by the highlanders of Bregu i Matës, Ishulli i Lezhës, and Ishulli i Shëngjinit, as well as detailed studies on the dialects of Hoti, Kelmendi, and Rranxat e Mbishkodrës. As a native of this area, he maintains an enduring affection and nostalgia for it, enriching this dictionary over the years with new words and expressions. The work represents carefully examined material, crafted with patience and expertise by a distinguished authority in Albanian dialectology, offering a corpus of over 12,300 lexemes from these rural dialects, where Albanian is spoken in its most authentic form.

The dictionary's extensive lexical, phraseological, ethno-folkloric, and sociolinguistic content—which we have analysed in this study—includes nouns = 7,329 (59.53%); verbs = 1,774 (14.40%); adjectives = 1,639 (13.31%); adverbs = 896 (7.27%), along with onomatopoeic expressions, euphemisms, idioms, and tongue-twisters. Most of these Albanian-origin words are absent from existing Albanian dictionaries; many could serve as new additions to the Comprehensive Dictionary of Albanian, which has recently begun publication by the Academy of Sciences of Albania.

Sereta Koperaj

Situata në Vilajetin e Shkodrës në prag të shpalljes së Pavarësisë

Fillimi i shekullit XX përbën një prej periudhave më vendimtare në shkrimin për zgjidhje të çështjes tonë kombëtare. Kemi një periudhë ku fati i shqiptarëve ishte e ndërlidhur me një sërë rrethanash, kryesisht me gjendjen e Perandorisë Osmane, por edhe me politikën e shteteve ballkanike që po merrnin formë, e sidomos me diplomacinë e Fuqive të Mëdha. Kumtesa synon t'i bëjë një pasqyrë dhe të analizojë situatën e Vilajetit të Shkodrës në prag të shpalljes së pavarësisë, pasi mendojmë se ai paraqet në mënyrën më të qartë zhvillimet e brendshme, përplasjet ballkanike, por edhe lojën diplomatike të kësaj periudhe. Fillimi i shekullit të ri do ta gjente këtë vilajet me problemet që trazonin më së shumti perandorinë. Lufta për kufinj, dyndjet e popullsisë që llogohej nga zonat e konfliktit si dhe dobësia ekonomike si për shkak të luftës, e humbjes së tregjeve por edhe politikave fiskale që ndryshonin herë pas here. Këtu do të zinte fill kryengritja e vitit 1911 e malësorëve të Mbishkodrës, e cila përbën një nga aktet me kulmore për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare të të gjithë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kumtesa mbështet më së shumti në dokumntacionin osman të kësaj periudhe, për të hedhur dritë mbi lëvizjet dhe kryengritjet, që nuk arriti të përhapej në rajonet e tjera shqiptare. Patriotët shqiptarë megjithëse e përkrahën dhe punuan për përçimin e saj në rrethet diplomatike evropiane, nuk arritën të jenë organizatorë mbarëkombëtarë dhe të shfrytëzonin momentin. Kjo edhe për arsyan se situata në Shkodër paraqitej shumë më komplekse. Ajo ishte pika ku kryqëzoheshin së pari interesat e dy perandorive, asaj osmane dhe asaj austro-hungareze. Dhe në mes të këtij presioni, territoret shqiptare kërcënoheshin nga shtetet e reja sllave ballkanike, Mali i zi dhe Serbia, që synonin zgjerimin maksimal territorial, shpesh herë edhe me përkrahjen e Fuqive të Mëdha. Pikërisht për këtë arsye Shkodrës do t'i duhej të ngrinte flamurin shqiptar dhe të festonte pavarësinë, pas një viti të përgjakshëm lufte e qëndrese.

THE MODALITY OF ACCURACY AND TEMPORAL MEANING OF THE FORMS “DO TË JEM/DO TË KEM” IN THE ALBANIAN LANGUAGE

The treatment of the modality of probability as one of the grammatical meanings of the future tense in the scientific grammars of the Albanian language, based on the explanation of the use of the future tense with the value of the present tense, has been the object of examination due to the fact that this process of shift in the Albanian language has not been evidenced through accurate linguistic data, thus remaining within the boundaries of hypothesis.

In this study, our focus is on the synchronic approach to temporal and modal meanings. The aim of this examination is to analyze the non-modal construction of probability where the element “do” maintains semantic independence, unlike the fully grammaticalized “do” of the future tense. Furthermore, in some cases, the temporal meaning of usage is not that of the present but achronia. These facts provide arguments for a new perspective on the forms of probability as independent modal constructions and classify them outside the forms with “do” in the Albanian language.

Keywords: Albanian language, modality, probability, temporal meaning, grammatical meaning, verb future tense.

Begzad Baliu, Astrit Jashari

Studimet etimologjike të profesor dr. David Lukës

David Luka është njëri prej studiuesve më të shquar të gjuhësisë shqiptare të shekullit XX. Përkushtimi i tij përfshinë dijet e mëdha të albanologjisë: historinë e gjuhës, etimologjinë, leksikografinë, fonetikën e morfologjinë historike, si dhe onomastikën. Vetëm studimet etimologjike të tij kapin një vëllim prej rreth 3300 njësisish leksikore shpesh të krahasuara edhe me onomastikën. Vepra e tij studimore në fushë të etimologjisë është përgatitur gjatë viteve ’70-’80 të shekullit XX, atëherë kur po e përmbyllte kryeveprën e tij madhore Profesor Eqrem Çabej, Studimeve etimologjike në fushë të shqipes, si dhe para Fjalorit etimologjik të shqipes, të Kolec Topallit botuar në fund të dekadës së dytë të shekullit XXI, prandaj njohja dhe studimi i këtij korpusi paraqet interes të veçantë në studimet albanologjike.

Etymological Studies by Professor David Luka

David Luka is one of the most prominent scholars of 20th-century Albanian linguistics. His work spans across various fields of Albanology, including the history of language, etymology, lexicography, historical phonetics and morphology, and onomastics. His etymological studies alone encompass around 3,300 lexical items, frequently analysed alongside onomastics. His research in etymology was conducted during the 1970s and 1980s, a period when Professor Eqrem Çabej was completing his seminal work *Etymological Studies in the Albanian Language*, as well as before the publication of the *Etymological Dictionary of Albanian* by Koleç Topalli at the end of the second decade of the 21st century. As a result, the study and recognition of this body of work is of particular interest in Albanological studies.

Prof.ass. dr. Sejdi Gashi

Modaliteti i saktësisë dhe kuptimi kohor i formave të tipit *fo të jem/do të kem* në gjuhën shqipe

Trajtimi i modalitetit të probabilitetit si një ndër kuptimet gramatikore të kohës së ardhme në gramatikat shkencore të gjuhës shqipe, bazuar në shpjegimin e përdorimit të së ardhmes me vlerën e së tashmes, është bërë objekt shqyrtimi për faktin se ky proces zhvendosjeje në gjuhën shqipe nuk është dëshmuar përmes të dhënash të sakta gjuhësore, duke mbetur kështu në kufijtë e hipotezës. Në këtë trajtesë, objekt i vështrimit tonë është përqasja e kuptimeve kohore dhe modale në aspektin sinkronik. Synim i këtij shqyrtimi është mosndërtimi modal i probabilitetit ku elementi do ruan pavarësi semantike ndryshe nga do-ja e gramatikalizuar plotësisht, e të ardhmes. Gjithashtu, kuptimi kohor në një pjesë të rasteve të përdorimit nuk është ai i së tashmes, por akronia. Këto fakte janë argumente për një këndvështrim të ri të formave të probabilitetit si ndërtime të pavarura modale dhe të klasifikueshme jashtë formave me do në gjuhën shqipe.

Fjalët çelësa: gjuha shqipe, modalitet, probabilitet, kuptim kohor, kuptim gramatikor, koha e ardhme e foljes.

Religious and Historical Developments in our Country during the 17th-18th Century

In our country, during the 17th and 18th centuries, under Ottoman rule, we encounter a wide variety of religious, political, and economic conditions in different regions. These situations depended on several factors, such as the region's location within the Ottoman Empire, its relations with surrounding religious centres, and its connections with the Western world, including Hungary, Austria, and Venice, among others.

Under Ottoman rule, the activity of the Orthodox Church in Albanian territories was conducted under more favourable conditions than that of the Catholic Church. The roots of these relationships can be traced back to the period following the conquest of Constantinople, when Sultan Mehmed II declared himself the protector of the Orthodox Church. From the outset, the Ottoman Empire established its ruling policies by favouring the Eastern Christian Byzantine faith—more specifically, Orthodox Christianity—over Western Christianity, i.e., Catholicism. This strategy would persist in the following centuries.

In this paper, we will examine, in an exemplary manner, the interaction of these influential factors at a specific moment in time, enabling the rapid rise of several favoured areas in the southeast of Albania, as well as the equally rapid decline of that prosperity. Although this paper does not directly address the northern regions of the country, it still clearly demonstrates the direct dependence of a region's economy and culture on its connections with the Ottoman Empire.

Behar Hoxhaj

Ndre Mjeda në veprën e Mentor Qukut, gjuhëtar e filolog i përmasave evropiane

Ndre Mjeda në veprën e studiuesit Mentor Qukut paraqitet si një personalitet dijeplotë, i cili bashkoi me rrënjët e gjuhës ashtin e kombit. Mentor Quku thotë se në kohën e vet, Mjeda njihej si filolog dhe albanolog në zë, por më vonë ky element i qenësishëm i personalitetit të tij u la në harresë nga shqiptarët, për shkaqe nga më të ndryshmet. Quku argumenton se studimet e Mjedës rreth gjuhës shqipe kanë marrë pjesën më të madhe të kohës dhe të energjive krijuese, duke theksuar se Ndre Mjeda ishte gjuhëtar shkencëtar në kuptimin e plotë të fjalës. Në veprën studimore të Qukut vlerësohet së tepërmi puna e Mjedës si albanolog, duke e krahasuar me albanologët e huaj dhe më të shquarit e kohës. Mjeda mbetet i pari albanolog shqiptar që përfaqësoi vendin tonë në një kongres ndërkombëtar. Me Meyer-in, Pedersen-in, Jokl-in e albanologë të tjerë, Mjeda përcaktoi vendin e shqipes në familjen gjuhësore indoevropiane. Mjeda ishte njohës i mirë i të gjitha nëndialekteve të gegërishtes, si dhe i vetmi gegë që zotëronte mirë dialektin toskë. Ishte etimolog, dialektolog, leksikolog, u mor me studime fonetike, morfologjike, sintaksore, me gjurmimin, mbledhjen e studimin e materialeve folklorike, etnografike, të lidhura ngushtë me gjuhën, me kulturën shpirtërore e materiale të shqiptarëve.

Ndre Mjeda in the work of Mentor Quku, a Linguist and Philologist of European Stature

In the work of the scholar Mentor Quku, Ndre Mjeda is portrayed as a profoundly knowledgeable figure who fused the roots of the language with the essence of the nation. Quku observes that, in his time, Mjeda was known as a prominent philologist and Albanologist, but later, this vital aspect of his legacy was largely forgotten by Albanians for various reasons. Quku argues that Mjeda's studies on the Albanian language occupied most of his time and creative energy, underscoring that Ndre Mjeda was a true linguist and scholar in every sense.

In Quku's study, Mjeda's contributions as an Albanologist are highly esteemed, placing him on par with foreign Albanologists and other leading scholars of his time. Mjeda remains the first Albanian Albanologist to represent Albania at an international congress. Alongside Meyer, Pedersen, Jokl, and other prominent Albanologists, Mjeda helped to establish the place of Albanian within the Indo-European language family. He had a thorough knowledge of all sub-dialects of Gheg and was the only Gheg speaker fluent in the Tosk dialect. Mjeda was an etymologist, dialectologist, and lexicologist, conducting extensive studies in phonetics, morphology, and syntax, and dedicating himself to the collection and analysis of folklore and ethnographic materials, closely tied to the language and the cultural heritage of the Albanian people.

Rozela Dhimgjini

Zhvillime fetare dhe historike në vëndin tonë në shek. 17 - 18

Në vëndin tonë, në shek. 17 dhe 18, gjatë periudhës së sundimit osman, në treva të ndryshme hasim situata shumë diverse fetare, politike dhe ekonomike. Këto situata vareshin nga disa faktorë, si: vendi që zinte truallin në Perandorinë Osmane, marrëdhëniet që kishte zona me qendrat fetare përreth, lidhjet që gëzonin këto treva me botën perëndimore, si me Hungarinë, Austrinë, Venedikun etj.

Nën sundimin osman, veprimtaria e Kishës Ortodokse në viset shqiptare zhvillohej në kushte më të favorshme se veprimtaria e Kishës Katolike. Premisat e këtyre relatave gjenden menjëherë pas pushtimit të Konstandinopojës, kur sulltan Mehmeti II e shpalli veten protektor të Kishës Ortodokse. Pra që në fillimet e saj Perandoria Osmane vendos linjat e politikave sunduese, duke favorizuar besimin kristian lindor bizantin, më saktë atë ortodoks, përkundrajt besimit kristian perëndimor, atij katolik. Kjo marrëdhënie do të vazhdojë me po të njëjtën strategji dhe në shekujt e mëtejshëm.

Në mënyrë ekzemplare në këtë punim do të mundohemi të ndjekim një bashkëveprim të këtyre faktorëve ndikues në një moment të përbashkët, duke bërë të mundur shkëlqimin e shpejtë të disa zonave të favorizuara në juglindje të Shqipërisë por dhe rënien po aq të shpejtë të ketij shkëlqimi. Megjithëse ky punim nuk lidhet direkt me zonat veriore të vëndit tonë, përsëri, në mënyrë ekzemplare qartëson varësinë direkte të ekonomisë dhe kulturës së një treve nga lidhjet që gëzonte ajo me Perandorinë Osmane.

The Shkodra Song as a Spiritual Heritage in Ernest Koliqi's Stories

The city of Shkodra, with its ancient tradition of culture and civilization, is recognized as the capital of Albanian culture. It has inspired not only the people of Shkodra specifically but also Albanians as a whole. This city has also served as a source of inspiration for the writer Ernest Koliqi.

Koliqi reflected parts of the traditions and culture of this city in his literary works, focusing on an element of both the past and the present—namely, the Shkodra song, which, in Ernest Koliqi's stories, emerges as a part of our spiritual heritage.

In his stories, Ernest Koliqi regarded the song as an inseparable part of Shkodra's art, through which emotions and individual experiences are expressed. Koliqi was a master at delving into the psyche of his characters, which he sculpted so beautifully, incorporating the song as a spiritual treasure eternally connected to Shkodra and its people.

Bendis Kraja

Binomi fotograf-patriot, në figurën e Kel Marubit

Arti i fotografisë zuri fill në Shkodër në vitin 1858, pothuajse menjëherë pas zbulimit të tij (1839), e kjo nuk qe një rastësi. Të etur për të renë, të zgjuar nga natyra, shkodranët qenë të parët që iu gëzuan këtij arti. Më pas fotografia u perhap në të gjithë Shqipërinë duke krijuar një plejadë të tërë fotografësh të apasionuar, por padyshim “profesorët” e këtij arti në Shqipëri mbetën Marubët. Dinastia e Marubëve, nga Pietro, Mati, Kel e Gegë, shkroi përmes dritës historinë e qytetit me rrethina e jo vetëm, ato pasqyruan në celluloid, me teknika të reja bashkekohore, aspekte të shumta të jetës sociale, kulturore, politike dhe ekonomike. Në vargun e emrave të këtyre personazheve që shënjuan artin e fotografisë, mendojmë të shkëpusim për një trajtim dykrahësh Kel Kodheli Marubin, një personalitet në Shkodrën e 1912-1920, emër tek i cili rri bindshëm binomi: fotografi –patriot, binom ky që e shoqëroi figurën e Kelit e të familjes së tij gjatë gjithë aktivitetit.

Arti fotografik arriti një stad të ri zhvillimi gjatë kohës kur në drejtimin e “dugajës” ishte Keli. Me rëndësi të veçantë dhe arritje e rëndësishme në këtë lëmë ishtë mbajtja e një regjistri të rregullt negativësh (1919), sipas rendit alfabetik, me datën, gjeneralitetet, përmasat e numrin e kopjeve, si dhe çmimin. Figura e Kel Marubit është e paplotë dhe e reduktuar nëse paraqitet thjesht si pionieri fotograf. Pikërisht në vitet 1912-1920 ai ka zhvilluar një aktivitet të gjërë patriotik. Emrin e tij e gjejmë në anëtarët e Klubit “Gjuha Shqipe”, në kryesinë e shoqërisë “Vaso Pasha”, si kryetarë të shoqërisë “Një tube djelmni shkodrane”, në bandën muzikore, në këshillin shkollorë të Bashkisë, firmëtar memorandumesh dhe protestash dërguar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Konferencën e Paqes në Paris, firmëtarë i protestës drejtuar fuqive aleate në Shkodër kundër ngritjes së flamurit serb në Bashki, etj, “Dugaja” e tij jo vetëm fiksoi përmes shkrepeve profesioniste e mjeshtërore, por edhe u kthye në

një vëndtakim për veprimtari kombëtare e patriotike. Një sërë letrash të korespondecës së patriotëve të shquar me Kel Marubin, të konsultuara në Arkivin Qëndror Shtetëror hedhin dritë e përforcojnë profilin e këtij personazhi shumëplanësh, të shquar të qytetit tonë që e kemi grupuar në dy krahë ngushtësisht të lidhura fotograf-patriot.

Rovena Vata Mikeli

Kënga shkodrane si trashëgimi shpirtërore në tregimet e Ernest Koliqit

Qyteti i Shkodrës, me një traditë kulture dhe qytetërimi të lashtë, e njohur si kryeqendra e kulturës shqiptare, e cila ka frymëzuar jo vetëm shkodranët në veçanti, por mbarë shqiptarët në përgjithësi, ku një burim frymëzimi ky qytet ka qenë edhe për shkrimtarin Ernest Koliqi.

Ky i fundit ka pasqyruar në veprën e tij letrare pjesë nga traditat, kultura e këtij qyteti, duke u ndalur në një element të djeshëm dhe të sotshëm, pikërisht te kënga shkodrane, e cila në tregimet e Ernest Koliqit na del si pjesë e trashëgimisë sonë shpirtërore.

Ernest Koliqi në tregimet e tij e cilësonte këngën si pjesë të pandashme të artit shkodran, ku përmes saj shprehen emocionet dhe përjetimet e secilit prej nesh. Koliqi ishte mjeshër në depërtimin e psikës së personazheve të tij, të cilat i ka skalitur aq bukur, duke përfshirë këngën si pasuri shpirtërore e lidhur përjetësisht me Shkodrën dhe shkodranët.

Dino Mustafiç and Altin Basha, the Shkodër Theatre continues to thrive as a dynamic centre of stage art, making a lasting contribution to the cultural landscape of Albania.

The Photographer-Patriot Duality in Kel Marubi’s Legacy

Photography as an art form began in Shkodër in 1858, almost immediately after its invention in 1839. This was no mere coincidence. Driven by a thirst for the new and inspired by nature, the people of Shkodër were among the first to embrace this emerging medium. Photography soon spread throughout Albania, giving rise to an entire generation of passionate photographers, but it was the Marubi family who remained the undisputed “masters” of the art in the country. The Marubi dynasty, spanning from Pietro and Mati to Kel and Gegë, documented the history of the city and its surroundings, capturing social, cultural, political, and economic life with light, using innovative contemporary techniques. Among the prominent figures in the history of Albanian photography, we focus on Kel Kadheli Marubi, a key figure in Shkodër from 1912 to 1920, where the dual identity of “photographer-patriot” is deeply intertwined with both his personal legacy and that of his family.

The art of photography reached new heights under Kel Marubi’s management of the “dugaj” (studio). One of his significant achievements was the systematic cataloging of negatives (1919), organised alphabetically and noting the date, general information, dimensions, number of copies, and price. However, Kel Marubi’s legacy cannot be fully understood if he is only regarded as a photographic pioneer. Between 1912 and 1920, he was also deeply involved in patriotic activities. His name appears among the members of the “Gjuha Shqipe” (Albanian Language) Club, on the board of the “Vaso Pasha” society, as president of the “Një tubë djelmni shkodran” (A Group of Shkodran Youth), in the brass band, and in the municipal school council. He was a signatory of memorandums and protests sent to the representatives of the Great Powers at the Paris Peace Conference, and he also signed a protest against the raising of the Serbian flag in Shkodër’s Municipality,

addressed to the Allied powers. His "dugaja" not only captured national events through professional and expert photography but also became a hub for national and patriotic activism. A number of letters from patriots who corresponded with Kel Marubi, preserved in the State Central Archive, further illuminate and solidify the multi-dimensional profile of this distinguished figure of our city, whom we identify as both a photographer and a patriot, closely linked through these dual roles.

Keywords: Photographer, Light-writer, Kel Marubi, Patriotic activity, Cultural societies, etc.

The History of the "Migjeni" Theatre of Shkodër

The Shkodër Theatre holds a prominent place in Albanian stage art, having preserved and carried forward a rich theatrical tradition since its establishment in 1880. Known as one of the most influential centres of culture and national identity, Shkodër has fostered a profound passion for theatre, supported by early amateur theatre groups such as the Fretnore School (1861), Saverian College (1905), and many others. These enthusiastic troupes performed in every available space in the city, staging works that awakened national consciousness and inspired the creative spirit of Shkodër's citizens.

In 1949, the Shkodër Theatre was granted professional status by a decision of the Council of Ministers, cementing its role as one of the principal cultural institutions of Albania. The formation of the first professional troupe, under the direction of Andrea Skanjeti and featuring talented actors such as Adem Kastrati, Antoneta Fishta, and others, marked a new era for Albanian theatre. The Migjeni Theatre stage saw iconic works like Molière's *The Miser* and *Tartuffe*, both of which were met with enthusiastic acclaim from audiences and critics alike.

In the following years, under the guidance of stage masters like Serafin Fanko and Elez Kadria, the Shkodër Theatre gave life to both Albanian and international dramas, transforming them into profound reflections of reality and the human condition. After the 1990s, the theatre underwent a period of renewal through collaborations with foreign directors and artistic experimentation, presenting works crafted with skill and performed with elegance.

In recent decades, the Migjeni Theatre has graced national and international stages, participating in prestigious festivals and earning numerous awards for performance and direction. Today, supported by a dedicated ensemble and collaborations with renowned directors such as

Sot, i mbështetur nga një trupë e përkushtuar dhe nga bashkëpunime me regjisorë të shquar si Dino Mustafiç dhe Altin Basha, Teatri i Shkodrës vijon të mbetet një tempull i gjallë i artit skenik, duke dhënë kontributin e tij të çmuar në pasurimin e kulturës shqiptare.

Berton SULEJMANI

Punimet shkencore të akademik Kolec Topallit të botuara në revistën shkencore “Albanologjia” të Universitetit të Tetovës

Akademik Kolec Topalli është një personalitet i shquar i shkencave albanologjike të kohës sonë. Rezultatet e punës që na ka lënë shtrihen në fusha të ndryshme hulumtimi të historisë së gjuhës shqipe. Kolec Topalli e përmbylli veprimtarinë e tij shkencore me një sintezë të gjerë për historinë fonetike, për historinë gramatikore, për historinë e leksikut, siç është Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe i cili nga shtypi doli në nëntor të vitit 2017.

Në këtë kumtesë do të paraqesim kontributin e Profesor Topallit për revistën shkencore “Albanologjia”. Në këtë revistë ai ka botuar këto punime shkencore: “Parimet themelore të hartimit të alfabetit të shqipes” dhe “Vendi i Selman Rizës për shkencat albanologjike”. Gjatë punimeve të Seminarit XII Ndërkombëtar të Albanologjisë të organizuar nga Universiteti i Tetovës u bë edhe paraqitja e veprës së akad. Kolec Topallit me titull “Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe” që e ka botuar QSA-IGJL, Tiranë më 2017. Ndërsa për Kolec Topallin në revistën shkencore “Albanologjia” kanë botuar: Valter Memisha, Anila Omari, Tefë Topalli, Begzad Baliu, Berton Sulejmani, Hana Radoniqi, Edona Jahiu.

Scientific Works of Academic Kolec Topalli Published in the Scientific Journal Albanology of the University of Tetova

Academic Kolec Topalli is a prominent scholar in the field of Albanian studies. His work encompasses a wide range of research in the history of the Albanian language. He concluded his academic career with a thorough synthesis on phonetic history, grammatical history, and lexical history, including the Etymological Dictionary of the Albanian Language, which was published in November 2017. This paper highlights Professor Topalli's contributions to the journal Albanology. In this journal, he published the following scientific works: "Fundamental Principles for the Creation of the Albanian Alphabet" and "The Role of Selman Riza in Albanian Studies." During the XII International Albanology Seminar organised by the University of Tetova, Acad. Kolec Topalli's work Etymological Dictionary of the Albanian Language, published by QSA-IGJL, Tirana in 2017, was also presented. Additionally, the following scholars have published works about Kolec Topalli in Albanology: Valter Memisha, Anila Omari, Tefë Topalli, Begzad Baliu, Berton Sulejmani, Hana Radoniqi, and Edona Jahiu.

Rita Gjeka

Historiku i Teatrit "Migjeni" të Shkodrës

Teatri i Shkodrës përbën një nga kurorat më të ndritura të artit skenik shqiptar, duke ruajtur dhe përcjellë një traditë të pasur teatrore që nga zanafilla e tij e hershme, në vitin 1880. Qyteti i Shkodrës, i njohur si një nga vatrat më të fuqishme të kulturës dhe identitetit kombëtar, ka kultivuar për dekada një pasion të thellë për teatrin, të cilin e përforcuan grupet teatrore amatore të asaj kohe, si "Shkolla Fretnore" (1861), "Kolegji Saverian" (1905), e shumë të tjera. Nëpërmjet këtyre trupave të zellshme, në çdo skenë modeste të qytetit u ngjiten vepra që ngjallën ndërgjegjen kombëtare dhe ushqyen shpirtin krijues të qytetarëve shkodranë.

Në vitin 1949, Teatri i Shkodrës fitoi statusin e teatrit profesionist, me vendim të Këshillit të Ministrave, duke e çimentuar kështu pozicionin e tij si një nga institucionet kryesore të kulturës shqiptare. Krijimi i trupës së parë profesionale nën drejtimin e Andrea Skanjetit dhe me aktorët e talentuar si Adem Kastrati, Antoneta Fishta e të tjerë, shënoi një epokë të re për teatrin shqiptar. Në skenën e teatrit "Migjeni" u vendosën vepra të njohura si "Kopraci" i Molierit dhe "Tartufi", të cilat u pritën me brohoritje dhe vlerësime të larta nga spektatorët dhe kritikët e kohës.

Gjatë viteve të mëvonshme, nën drejtimin e mjeshtërve të skenës si Serafin Fanko dhe Elez Kadria, teatri i Shkodrës i dha zë dramave shqiptare dhe klasikeve ndërkombëtare, duke i kthyer ato në pasqyrime të fuqishme të realitetit dhe shpirtit njerëzor. Pas viteve '90, teatri përjetoi një rilindje të re përmes bashkëpunimeve të frytshme me regjisorë të huaj dhe eksperimentime artistike, duke i sjellë publikut shqiptar vepra të realizuara me mjeshtëri dhe delikatesë skenike.

Në dekadat e fundit, Teatri "Migjeni" ka ndriçuar skenat kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u bërë pjesë e shumë festivaleve prestigjioze ku ka rrëmbyer çmime të shumta për interpretim dhe regji.

Shkodra Teachers in Kosovo: Advocates for the Dissemination of the Albanian Language

This study aims to highlight the contribution of teachers from Shkodra in promoting the Albanian language in Kosovo between 1941 and 1944, during a period when the region was under Italian and later German occupation. Under the direction of the Ministry of Education, a significant number of teachers from Shkodra and other Albanian cities were sent to Kosovo to develop the education system in Albanian, navigating the social and political challenges of the time.

The role of these teachers in establishing Albanian-language schools, implementing curricula, and strengthening the national identity of Albanian students in the Kosovo region is the focus of this research. Drawing on various publications and studies, this paper seeks to contribute to the understanding of the significance of Shkodra teachers as promoters of Albanian knowledge and culture, as well as their role in fostering educational and cultural ties between Kosovo and Albania.

Keywords: education, Albanian language, Kosovo, teachers, Shkodra.

Bresena Kopliku, Nertila Dilaveri

Migrimi transnacional, nga strategji jetese në Magjent zhvillimi

Perspektivë nga Shqipëria si vend origjine

Qasja transnacionale në studimin e migrimit është relativisht e re në debatin publik dhe kërkimin akademik në Shqipëri, duke u përqendruar kryesisht në studimin e familjeve transnacionale dhe kujdesit transnacional. Për më tepër, mbetet ende e paeksploruar marrëdhënia midis migrimit, transnacionalizmit dhe zhvillimit, edhe pse Shqipëria konsiderohet si "laboratori për studimin e migrimit dhe zhvillimit". Gjatë dekadës së fundit, veçanërisht pas liberalizimit të vizave, lehtësimit të politikave të migrimit dhe transportit më të shpejtë dhe më të lirë, fushat transnacionale midis Shqipërisë si vend dërgues dhe vendeve pritëse janë intensifikuar. Lidhjet transnacionale të migrantëve janë ndërthurur gjithnjë e më shumë me remitancat e ndryshme, migrimin e kthyer dhe diasporën. Remitancat financiare dhe sociale kanë vazhduar të jenë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për familjet shqiptare gjatë dekadës së fundit; në shumë raste "miti i kthimit" është transformuar në forma të ndryshme të transnacionalizmit, ndërkohë që është rritur edhe angazhimi i diasporës. Ky punim bazohet në një qasje cilësore, me 20 intervista të thelluara të realizuara me migrantë transnacionalë që jetojnë midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera. Pyetjet e intervistave të thelluara adresuan çështje të tilla sikurse kapitalin social dhe financiar, motivimet, stilin e jetesës, shtëpinë dhe përkatësinë, sipërmarrjen, kujdesin, investimet dhe organizatat me qëllimin për të eksploruar më tej se si migrantët përfitojnë nga praktikatat transnacionale dhe nëse migrantët transnacionalë mund të veprojnë si agentë të zhvillimit. Duke përshtatur perspektivën transnacionale, ky punim argumenton se migrimi transnacional është tani një strategji jetese për shumë familje shqiptare dhe, nëse trajtohet me politikë të duhura, mund të ndihmojë në zhvillimin e Shqipërisë gjithashtu.

Transnational Migration: From a Lifestyle Strategy to Development Agents:

A Perspective from Albania as a Country of Origin

The transnational approach to migration studies is a relatively recent development in both public debate and academic research in Albania, with a focus primarily on transnational families and care practices. Additionally, the relationship between migration, transnationalism, and development remains insufficiently explored, despite Albania being regarded as a “laboratory for the study of migration and development.” In the past decade, particularly after visa liberalisation, the easing of migration policies, and faster and more affordable transportation, transnational networks between Albania as a sending country and its host countries have become more pronounced. Migrants’ transnational connections have increasingly merged with remittances, return migration, and the diaspora. Financial and social remittances have remained a key source of income for Albanian families in recent years; in many instances, the “myth of return” has shifted into various forms of transnationalism, while engagement from the diaspora has expanded. This paper employs a qualitative approach, based on 20 in-depth interviews with transnational migrants who live between Albania and other countries. The interviews addressed topics such as social and financial capital, motivations, lifestyle, notions of home and belonging, entrepreneurship, care, investments, and organisational involvement, with the goal of exploring how migrants benefit from transnational practices and whether they can act as agents of development. By adopting a transnational lens, this paper argues that transnational migration is now a viable lifestyle strategy for many Albanian families and, with the right policies in place, could also contribute to Albania’s development.

Rina Muka, Irida Hoti

Mësuesit shkodranë në Kosovë – promotorë të përhapjes së gjuhës shqipe

Ky studim synon të nxjerrë në pah kontributin e mësuesve shkodranë në përhapjen e gjuhës shqipe në Kosovë gjatë periudhës 1941-1944, në një kohë kur rajoni ishte nën pushtimin italian e më pas atë gjerman. Të drejtuar nga Ministria e Arsimit, një numër i konsiderueshëm mësuesish nga Shkodra e qytete të tjera të Shqipërisë u dërguan në Kosovë për të zhvilluar sistemin arsimor në gjuhën shqipe, duke përballuar sfida sociale e politike të kohës. Roli i këtyre mësuesve në krijimin e shkollave shqipe, implementimi i kurrikulave, forcimi i identitetit kombëtar tek nxënësit shqiptarë të krahinës së Kosovës është objekti i këtij hulumtimi. Bazuar në botime dhe studime të ndryshme, ky punim synon të kontribuojë në evidentimin e rëndësisë që patën mësuesit shkodranë si promotorë të dijes dhe kulturës shqiptare dhe forcues të lidhjeve arsimore e kulturore mes Kosovës e Shqipërisë.

A Linguistic Perspective on In the Shadow of Rozafa

Sami Repishti is a multifaceted figure in Albanian culture, literature, science, and in both patriotic and political activism. In 2004, he published his autobiographical book, *In the Shadow of Rozafa*, which serves not merely as a personal narrative but as an in-depth analysis of Albanian political and social life over a span of twenty-five years, from the 1930s to the end of 1959.

This study aims to analyse Repishti’s autobiography by examining the linguistic techniques he uses to construct personal identity, convey emotion, and structure his experiences. The approach to this analysis includes:

1. Lexical Analysis – Key words that express emotions, experiences, or characteristics that the author seeks to convey; the tone, whether formal or informal; and specific terms the author uses to describe particular experiences, as a reflection of his distinctive style.
2. Grammatical Structure Analysis – Verb tenses, as autobiographies often switch between past and present tense to create immediacy or emphasise vivid experiences; the use of pronouns and how the author builds rapport with the reader through these grammatical choices.
3. Syntactic Analysis – Sentence structure and its impact on the reader; phrase structures the author uses to emphasise significant moments or experiences.

This analysis will contribute to a deeper understanding of Repishti’s identity and experiences and allow us to appreciate how his autobiography reveals rich life experiences through linguistic structure.

Keywords – Sami Repishti, autobiography, lexical analysis, grammatical structure analysis, syntactic analysis.

Brikene Dionizi, Erjola Barbullushi

Zhvillimi ekonomik dhe strategjitë reformuese në shtetin e ri shqiptar, në fokus rajoni i veriut (viti 1912-1937)

Viti 1912 përbën një vit të rëndësishëm për popullin shqiptar. Me krijimin e shtetit shqiptar, dalin shumë sfida që kanë të bëjnë me organizimin e shtetit dhe zhvillimin e tij. E izoluar me shekuj, Shqipëria nuk mori pjesë në përparimet e mëdha që ndodhën gjatë asaj kohe në botën perëndimore. Ekonomia relativisht e pazhvilluar duhej të merrte hov. Bazuar në botime të kohës, do sjellim në vëmendje përpjekjet e shtetit shqiptar për zhvillimin ekonomik e reformat e ndërmarra gjatë 25 viteve të para të shtetit shqiptar (periudha 1912-1937). Do ndalemi në elemente të vecanta që i përkasin rajonit të veriut. Prefektura e Shkodrës (në përbërje të saj nenprefektura e Shkodrës, Malësisë së Madhe, Lezhës, Mirditës, Pukës e Dukagjinit) ka karakteristikat e veta lidhur me llojin e mjeshtërive dhe zhvillimet e industrisë.

Një element interesant në botimet e kohës është investimet që ndërmerr shteti për rregullimin e komunikacionit, i cili përbën një faktor të rëndësishëm për lëvizjen e njerëzve e mallrave. Përpjekja e shtetit për kualifikimin intelektual nëpërmjet mbështetjes financiare të studentëve të mirë për kualifikim Brenda e jashtë vendit, tregon një vëmendje të shtetit ndaj mendimit intelektual. I gjithë diskutimi në këtë punim do realizohet në kuadër të të gjithë vendit, me vëmendjen në Shqipërinë e veriut për periudhën 1912-1937.

Economic Development and Reform Strategies in the Early Albanian State:

A Focus on the Northern Region (1912-1937)

The year 1912 marks a pivotal point for Albania, as it emerged as an independent state facing numerous challenges in establishing and organising its governance structures. Isolated from the broader advancements of the Western world for centuries, Albania's economy remained largely underdeveloped and in need of significant transformation. Drawing on historical publications, this paper explores the state-led efforts in economic development and the reforms initiated in the first 25 years of Albanian statehood (1912-1937). The focus is placed on the unique conditions and developments within the northern region, particularly the Prefecture of Shkodra, which includes the sub-prefectures of Shkodra, Malesia e Madhe, Lezha, Mirdita, Puka, and Dukagjin. This region stands out for its distinct forms of craftsmanship and industrial activities.

A noteworthy aspect highlighted in contemporary records is the state's investment in improving transportation infrastructure, which played a vital role in facilitating the movement of people and goods. Additionally, the state's support for intellectual development, including financial assistance for talented students pursuing education both domestically and abroad, underscores a commitment to fostering intellectual growth. This study provides an overview of these initiatives at a national level, with particular attention to developments in Northern Albania during the period from 1912 to 1937.

Keywords: economic development, reform, education, infrastructure

Rezearta Murati

Sprovë për një këndkundrim gjuhësor "Nën hijen e Rozafës"

Sami Repishti është një figurë shumëdimensionale e kulturës, e letërsisë, e shkencës dhe e veprimtarisë atdhetare e politike shqiptare. Në vitin 2004, botoi librin e tij autobiografik: "Nën hijen e Rozafës" që nuk është thjesht një libër që tregon jetën e një individi, por është një analizë e thellë e jetës politike dhe shoqërore shqiptare në harkun kohor njëzet e pesë vjeçar, midis viteve tridhjetë deri në mbarim të vitit 1959 të shekullit të kaluar.

Punimi synon të bëjë një analizë të këtij teksti autobiografik që përfshin shqyrtimin e veçorive gjuhësore që autori përdor për të ndërtuar identitetin personal, për të përcjellë emocionet dhe për të strukturuar përvojat e veta. Hapat ku ravijëzohet kjo analizë janë:

1. Analiza e nivelit leksikor - Fjalët kyçe që përshkruajnë ndjenjat, përvojat ose cilësitë që autori dëshiron të shprehë; Stili i gjuhës, nëse gjuha është formale apo joformale; Termat specifike që autori përdor për të përshkruar përvoja të veçanta, si një shenjë e stilit të tij unik.

2. Analiza e strukturës gramatikore - Koha foljore se shpesh në autobiografi, autorët mund të kalojnë mes kohës së shkuar dhe të tashme për të krijuar një ndjenjë afërsie ose për të theksuar një përvojë të gjallë; Përdorimi i përemrave dhe se si autori ndërton marrëdhënien me lexuesin përmes kësaj strukture.

3. Analiza e nivelit sintaksor - Ndërtimi i fjalisë dhe çfarë efekti kanë ato tek lexuesi; Struktura e frazave që autori përdor për të theksuar momente ose përvoja të rëndësishme.

Një analizë e tillë do na të ndihmojë në kuptimin e thellë të identitetit dhe përvojës së autorit dhe në vlerësimin e mënyrës se si ky tekst autobiografik shfaq përvoja të pasura jetësore përmes strukturës gjuhësore.

Planning and Promoting Tourist Itineraries in the Shëngjin-Velipojë Area

The Shëngjin-Velipojë region is a remarkable tourist destination, growing in popularity for its coastal tourism, cultural experiences, culinary offerings, and high-quality hotel services. While the beaches are the primary draw for visitors, it has become evident that tourists are also looking for other forms of entertainment during their stay. However, there is a relatively low engagement with other tourism options in the area, which can be attributed to a lack of alternative recreational opportunities, as well as insufficient information provided by travel agencies and tourist information offices to guide visitors toward other potential itineraries and services available beyond the beaches.

This paper aims to create and promote tourist itineraries in the Shëngjin-Velipojë area, particularly around the beaches, as a strategy to support the sustainable development of the region. Achieving this goal will require field research and the collection of geographic and cultural data on the natural and historical assets that will form the basis of the itineraries. The research will also employ advanced methodologies, including Geographic Information Systems (GIS), to design these tourist routes and make them more accessible to visitors. The findings of this study will benefit tourism professionals, travel agencies offering tour packages, as well as local and regional authorities involved in tourism development planning for the area.

David Marku

Satira fishtjane si mjet stilistik

Gjergj Fishta padyshim që ka dëshmuar se është babai i satirës në letërsinë shqipe, ku me një klas të lartë të intelektualit dhe artistit, ai na jep: një format të ri të krijimeve, një botë të re të perceptimeve të fenomeneve dhe gjetjes së zgjidhjeve, një mendësi të re të pranimit të vlerave universale dhe kanalizimin e tyre në çdo pore të jetës.

Përmes saj, ai ka shpjeguar botën shqiptare, fatin e shqiptarit, historinë dhe mendësinë, por mbi të gjitha edhe letargjinë shqiptare që nuk po zhdukej njëherë e mirë. Kritika shqiptare, sidomos ajo e kohës së regjimit komunist, e ka anatemuar krijimtarinë e tij për arsye thelbësore se nuk kanë dashur që të shoqërojnë asgjë me realitetin që vret, kundrejt një bote, që ironikisht po ai regjim, e quante "botë e re".

Mjeti stilistik në satirën e Fishtës ishte thumbimi, përqeshja dhe emërtimi i personazheve fiktive e konkrete, i dukurive fiktive e konkrete me terma përqeshëse buzë sarkazmës. Prandaj edhe shpeshherë është keqkuptuar dhe janë transofnuar vargjet e tij duke e lënë në pluhurin e harresës për mbi pesëdhjetë vjet.

Satire in Gjergj Fishta's Work as a Stylistic Device

Gjergj Fishta is undeniably recognised as the father of satire in Albanian literature. With a profound intellectual and artistic stature, he offers us: a new form of creative expression, a fresh way of perceiving phenomena and finding solutions, and a new mindset for embracing universal values and integrating them into all aspects of life.

Through his satire, he examined the Albanian world, the fate of Albanians, history, and mentality, but most importantly, he critiqued the persistent lethargy that seemed impossible to overcome. Albanian critics, particularly during the communist era, condemned his work for the simple fact that it did not align with the reality they wished to promote, in contrast to a world that the same regime ironically called the "new world."

Fishta's stylistic approach in satire relied on sharp criticism, ridicule, and the use of both real and fictional characters, as well as actual and imagined phenomena, all expressed through sarcastic and mocking language. This often led to misinterpretations and distortions of his verses, leaving his work forgotten for over fifty years.

Renaldo Xhanej, Flora Gjoni, Nertila Dilaveri,

Planifikimi dhe promovimi i itinerareve turistike në zonën Shëngjin – Velipojë

Zona Shëngjin-Velipojë është një kompleks turistik i mrekullueshëm që çdo ditë po bëhet më e njohur, si për turizmin bregdetar, atë kulturor, kulinarinë si dhe shërbimin cilësor të hotelerisë. Në zonën Shëngjin - Velipojë plazhet kanë rëndësinë kryesore të turizmit dhe është vënë re se turistët kërkojnë edhe tipe të tjera atraktive për t'u argëtuar në periudhën e tyre të pushimeve. Përveç plazheve evidentohet se ka përdorim më të ulët në tipet e tjera të turizmit. Kjo lidhet me mungesën që ka zona t'i ofrojë atyre mundësi të tjera për zbavitje, mungesën e informacionit që turistët marrin nga agjensitë turistike, zyrat e informacionit turistik në orientimin e tyre drejt itinerareve turistike, apo shërbimeve të tjera turistike që ka zona përveç plazheve. Objekti i punimit është krijimi i itinerareve turistike pranë plazheve në territorin e zonës së Shëngjin-Velipojë si dhe promovimi i tyre si një perspektivë në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës së Shëngjin- Velipojë. Për të arritur qëllimin dhe objektivat nevojitet puna studimore në terren si dhe mbledhje literaturash për të dhëna gjeografike të potencialeve natyrore dhe kulturore për zonat e itinerareve që do të krijohen, përdorimi i metodave të avancuara, aplikimi i GIS në krijimin e itinerareve turistike apo dhe promovimi i itinerareve për të qenë të aksesueshme për turistët pranë plazheve. Rezultati i studimit të zhvilluar do t'i shërbejë si të apasionuarve për këtë fushë turizmi, agjensive turistike që krijojnë paketa turistike, strukturave qendrore dhe vendore që planifikojnë strategji zhvilluese për zonën në funksion të turizmit.

time in academic research.

In conclusion, the article describes a successful project launched in 2022, a collaboration between the European Union and the Shkoder Municipality, aimed at educating local citizens and foreign visitors about the history of the Atheist Museum. The article concludes with the results of this pioneering study on the Atheist Museum in Shkoder, which can be regarded as the clearest representation of the communist utopia in the ideological struggle against religious freedom.

Dorina Arapi, Holta Roçi

Veshja e gruas katolike shkodrane në periudhën osmane (shek. XVIII-XIX)

Veshja tradicionale ka luajtur një rol të rëndësishëm në komunikimin kulturor dhe social, duke dhënë informacione për statusin, përkatësinë dhe identitetin e bartësit. Në aspektin teorik, veshja funksionon si një sistem semiotik, ku çdo element ka shënjesin dhe të shënjuarin e vet, duke komunikuar mesazhe të lidhura me identitetin social, etnik, gjinor dhe fetar të individëve. Ajo përcjell jo vetëm estetikën, por edhe funksionet praktike dhe simbolet e ndërtuara nga normat dhe rregullat shoqërore.

Në qytete si Shkodra, gjatë sundimit osman e veçanërisht në shekujt XVIII-XIX, kodi i veshjes, veçanërisht ai i gruas, rregullohej nëpërmjet një rrjeti të gjerë aktorësh. Veshjet ishin një tregues i statusit shoqëror, që tregonin hierarkinë e strukturën sociale të shoqërisë. Kësisoj, për të ruajtur gjendjen sociale e klasave shoqërore apo edhe shumë aspekte të tjera, dekrete të ndryshme të kohës, ishin një formë rregullatore për konsumin e materialeve për veshje, për të kontrolluar ekonominë dhe tregtinë, si edhe vepra devotshmërie të realizimit të një jete kristiane të përkorë.

E mbështetur në të dhënat arkivore dhe etnografike, kjo kumtesë do të trajtojë veshjen e gruas katolike shkodrane nga shekujt XVIII-XIX, duke hedhur dritë në këtë mënyrë, sesi veshja tradicionale ka qenë subjekt i kontesteve historike dhe veçanërisht i ndikimit që komuniteti katolik shkodran luajti rol në këtë kohë.

Gjithashtu nëpërmjet interpretimit antropologjik, del në pah se veshja tradicionale është pjesë e një sistemi komunikues jo-verbal, e cila shërbente si një mjet për të komunikuar në mënyrë të heshtur, duke reflektuar marrëdhëniet me pushtetin, normat fetare, dhe identitetet kulturore të kohës.

The Attire of Catholic Women in Shkodra During the Ottoman Period (18th-19th Centuries)

Traditional attire has long held a significant role in cultural and social communication, conveying details about the wearer's status, affiliations, and identity. In theory, clothing functions as a semiotic system where each element carries both a symbol and a meaning, signalling messages about social, ethnic, gender, and religious identities. It embodies not just aesthetics but also practical functions and symbols shaped by social norms and values.

In cities like Shkodra, during Ottoman rule in the 18th and 19th centuries, women's dress codes were carefully regulated through a broad network of influences. Attire was a clear indicator of social status, mirroring the societal hierarchy. To preserve social distinctions and manage various aspects of daily life, norms determined the materials used for clothing, impacting both the economy and trade while promoting a restrained Christian lifestyle.

Drawing on archival and ethnographic data, this presentation explores the attire of Catholic women in Shkodra during the 18th and 19th centuries, shedding light on how traditional clothing was shaped by historical forces and examining the influential role of the Catholic community in Shkodra at the time. Through an anthropological perspective, it becomes clear that traditional clothing functioned as a non-verbal communication system, a tool for silent expression that reflected interactions with authority, religious norms, and cultural identities of the era.

The Atheist Museum (1973–1990): The Symbol of Anti-Religious Utopia in Communist Albania

This article explores the history of the Atheist Museum in communist Albania, which opened in 1973 in Shkoder as the only museum in the world dedicated solely to promoting Marxist anti-religious ideology and eliminating faith from Albanian society. The introduction offers a brief overview of the early dictatorial policies of the Albanian communists toward religious communities, rooted in Stalinist ideology. These policies included restrictive statutes imposed on religious communities between 1949 and 1951, as well as the violent persecution of Albanian Catholic and Muslim clergy. This anti-religious campaign reached its climax in 1967 when religion was officially declared illegal.

The main focus of the article is an analysis of the creation and structure of the Atheist Museum, established as part of Albania's cultural revolution, inspired by the Maoist model of China. The revolution aimed to reshape the Albanian population by eradicating religious and cultural traditions, with the goal of indoctrinating people into the core ideological tenets of communism—namely, the abolition of "old customs" and the creation of a new man. The museum's exhibits were diverse in their themes, yet always remained rooted in an anti-religious narrative. The museum was spread across two floors and contained displays filled with heavy ideological content, including the Albanian people's fight against religion, caricatures mocking the clergy and religious practices, and speeches by Enver Hoxha, the communist leader of Albania.

The article also examines how the museum was perceived by both local Albanian visitors and international Marxist-Leninist delegations, drawing from personal memories and the museum's guestbook—a significant historical document that is now being analysed for the first

Në fund parashtrahet një përshkrim i një projekti të suksesshëm mes BE dhe Bashkisë Shkodër të mbajtur më 2022 që synonte evidentimin e historisë së muzeut ateist për qytetarët vendas dhe vizitorët e huaj. Artikulli konkludohet me përfundimet e këtij studimi pioner mbi historikun e muzeut ateist në Shkodër, që mund të quhet pa ekzagjerim mishërimi më i qarshtëm i utopisë së komunizmit në rrafshin e luftës ideologjike kundrejt lirisë së besimit.

Eduart Ndreca

Çështja e Mirditës në Kongresin e Berlinit

Çështja e Mirditës në Kongresin e Berlinit është një temë delikate për t'u trajtuar. Është delikate sepse në një kongres ndërkombëtar, ku shqiptarët përpiqeshin të bashkuar të përfitonin sa më shumë autonomi, del në skenën e bisedimeve krejt me qëllim djallezor çështja e një krahine së vogël të Mirditës. Qëllimi i atyre që e propozuan patjetër lidhej me dëshirën për ta zvogëluar çështjen kombëtare shqiptare në çështjen e një krahine të vogël. Austro-Hungaria dhe Franca kërkonin të ruanin me çdo kusht status-quonë në Ballkan dhe i trembeshin çdo lloj ndryshimi të mundshëm. Sidomos Austro-Hungaria e dinte se ndryshimet brenda Perandorisë Osmane mund të zgjonin të njëjtin dëshirë për ndryshim brenda territoreve që ajo kishte nën zotërim.

Trajtimi vetëm i çështjes së Mirditës dhe shmangia e respektimit të kërkesa normale që patriotët shqiptarë kërkuar në plan kombëtar, dëmtonte rëndë interesin kombëtarë. Krejt i pakuptimtë u duk edhe bashkimi i pjesës më të madhe të elitës mirditore, me në krye Preng Bibë Dodën, me këtë nismë antikombëtare. Por nuk mbeti vetëm këtu. Shumë krahina të Veriut të Shqipërisë me prijësit e tyre, përfshi këtu edhe disa krerë të besimit mysliman, u bënë palë me Preng Bibë Dodën.

Autonomia krahinore e fetare e Mirditës, e kërkuar në kongresin e Berlinit, nuk dukej të ishte as e nxitur fshehtas nga Porta e Lartë. Porta e Lartë pa dyshim ishte kundër çdo ndryshimi, por përtej kësaj Mirdita i gëzonte me kohë thuasë të plotë këto të drejta, të cilat kohët e fundit e kishin shqetësuar edhe qeverinë. Qeveria, edhe nëse do binte dakord, i trembej faktit të bashkimit në këto kërkesa edhe të krahinave të tjera me Mirditën. Gëzimi i një lirie të tillë mund të prodhonte efektin zingjir, çka do i nxirrte shumë punë pastaj qeverisë osmane. Madje përfaqësuesi turk në Berlin i konsideronte këto kërkesa edhe si një pengesë dhe një e re që i binte ndesh aplikimit të reformave që i ishin kërkuar Portës së Lartë.

The Mirdita issue at the Congress of Berlin

The issue of Mirdita at the Congress of Berlin is a delicate topic to deal with. It is delicate because in an international congress, where Albanians unitedly tried to gain as much autonomy as possible, the issue of a small province of Mirdita appears on the stage of talks with a completely evil purpose. The goal of those who proposed it was definitely related to the desire to reduce the Albanian national issue to the issue of a small province. Austria-Hungary and France wanted to preserve the status quo in the Balkans at all costs and were afraid of any possible change. Austria-Hungary in particular knew that changes within the Ottoman Empire could arouse the same desire for change within the territories it owned.

Dealing only with the issue of Mirdita and avoiding respecting the normal demands that the Albanian patriots asked for at the national level, seriously harmed the national interest. The union of most of the Mirdite elite, headed by Preng Bibë Doda, with this anti-national initiative seemed completely meaningless. But it didn't stop here. Many provinces of Northern Albania with their leaders, including some heads of the Muslim faith, became allies with Preng Bibë Dodën.

The provincial and religious autonomy of Mirdita, demanded at the Congress of Berlin, did not even appear to have been secretly urged by the Ottoman Porte or High Porte. The Ottoman Porte or High Porte was undoubtedly against any change, but beyond that, Mirdita enjoyed these rights long ago, which had recently worried the government as well. The government, even if it were to agree, is afraid of the fact that other provinces will join Mirdita in these demands. The enjoyment of such freedom could produce a chain effect, which would then bring a lot of work to the Ottoman government. Even the Turkish representative in Berlin considered these requests as an obstacle and a new one that contradicted the application of the reforms that had been requested of the Ottoman Porte or High Porte.

Pjerin Mirdita, Xherardo Nikjari

Muzeu Ateist (1973–1990): Simboli i Utopisë Anti-fetare në Shqipërinë Komuniste

Ky artikull trajton historinë e Muzeut Ateist në Shqipërinë komuniste, i hapur më 1973 në Shkodër si i vetmi muze në botë i dedikuar ekskluzivisht propagandimit të ideologjisë antifetare markiste dhe asgjësimit të besimit nga shoqëria shqiptare. Në hyrje shpaloset një pasqyrë e përmbledhur e politikave të hershme diktatoriale të komunistëve shqiptarë ndaj komuniteteve fetare që në thelb kishin frymëzim të ideologjisë staliniste, duke përfshirë këtu statutet e veçanta shtrënguese të komuniteteve fetare të miratura ndërmjet viteve 1949-1951, dhe përndjekjen gjakatare të klerit katolik dhe atij mysliman shqiptar. Kjo dinamikë politikash shtypëse antifetare arriti kulmin në vitin 1967, kur feja u shpall e jashtëligjshme.

Fokusi kryesor i artikullit është marrja në analizë e ngritjes dhe organizimit të Muzeut Ateist, i cili themelohet në kontekstin e revolucionit kulturor në Shqipëri duke ndjekur modelin e Kinës maoiste, që synonte riformësimin e popullit shqiptar nëpërmjet çrrënjësjes së traditës dhe trashëgimisë kulturore fetare-kombëtare ndër shqiptarë me qëllim indoktrinimin e popullsisë për të realizuar kësodore objektivin themelort ideologjik të komunizimit, atë të likuidimit të "zakove të vjetra" dhe krijimin e njeriut të ri. Ekspozitat brenda muzeut qenë të larmishme dhe me tematika të veçanta, por pa u shpallur nga korniza e tyre antifetare. I ndarë në dy kate, muzeu përmbante stenda të ngarkuara me përmbajtje të fortë ideologjike si: luftën e popullit shqiptar kundër fesë, karikatura tallëse ndaj klerit e rriteve fetare edhe fjalimet e udhëheqësit komunist shqiptar Enver Hoxha.

Artikulli ndalet më tej në përcëptimin e muzeut në sytë e vizitorëve vendas shqiptarë dhe atij botëror në formën e delegacioneve marksist-leniniste, përmes hulumtimeve nga kujtimet dhe librit të përshtypjeve të vetë këtij muzeu, një dokument i rëndësishëm historik që hulumtohet për herë të parë për qëllime shkencore.

The Castle of Baleci (Balesium)

This castle, designated as a Category I Cultural Monument on January 8, 1977, by the Ministry of Education and Culture, holds not only a deep historical significance, tracing back to the early Iron Age, but also a special place as the birthplace of the Balsha family and as a key military outpost of our National Hero, Gjergj Kastrioti-Skanderbeg.

The ruins of the fortified city of Baleci are situated on a rocky massif at an elevation of 434.5 meters above sea level, at the base of Mount Maranaj (1,576 meters), commonly referred to as Maja e Balcit (the Peak of Baleci). Locally, it is known as Ballexa e Rrjollit (the Ball of Rrjoll or opposite Rrjoll – P.Z.), and the mountain people call it “Forca e Lekëve“ (Lekët: The Highlanders of the North – P.Z.). The site is located 18.5 km directly north of Shkodra and 23 km by road, and 10 km to the east of the town of Koplik, approximately 20 km by road. It lies south of the village of Reç, north of the village of Kurtaj, and near the village of Rrjoll, in the Greater Highlands.

Elindë Dibra, Alva Dani

Kontributi i seminarit “Shkodra në Shekuj”, (1993-2005), në fushën e studimeve letrare.

Letërsia shqiptare në vitet ‘90, nisi lëvizjen e lirë drejt njohjes dhe rinjohjes së plotë të universit përfaqësues brenda dhe jashtë trojeve shqiptare. Shkodra në vazhden e traditave të saj letrare, kulturore, historike organizoi aktivitete që çelën mendimin dhe studimet e lira në Shqipërinë e pasdiktaturës. Seminari “Shkodra në Shekuj”, u mundësoi të gjithë studiuesve të letërsisë brenda dhe jashtë trojeve shqiptare të paraqitnin letërsinë e munguar për një kohë të gjatë për shkaqe joletrare. Takohemi me autorë dhe studime për Fishtën, Koliqin, Pipën, Camajn etj. Studimet, ngjallën interes të menjëhershëm dhe na afruan me letërsinë e ndaluar për gjatë viteve të diktaturës.

The Contribution of the “Shkodra ne Shekuj” Seminar (1993-2005) to Literary Studies

In the 1990s, Albanian literature began to embrace a path of free exploration, leading to the full recognition and reappraisal of its representative body of work, both within Albania and among Albanian communities abroad. Shkodra, staying true to its literary, cultural, and historical traditions, organised events that nurtured independent thought and academic research in post-dictatorship Albania. The “Shkodra ne Shekuj” seminar allowed literary scholars from Albania and the diaspora to present works that had long been overlooked due to non-literary reasons. Through the seminar, we were introduced to authors and research on figures such as Fishta, Koliqi, Pipa, Camaj, and others. These studies quickly captured attention, bringing us closer to the literature that had been silenced during the dictatorship years.

Paulin Zefi

Kështjella e Balcit (Balesium)

Kjo kështjellë, e cila mban statusin si Monument Kulture i kategorisë së I-rë, i shpallur më 08.01.1977 nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, përpos faktit se paraqet një vertikale të thellë historike, që shkon deri në periudhën e parë të hekurit, ajo merr një rëndësi të veçantë si vendi i origjinës së Balshajve dhe si një avantpost i rëndësishëm ushtarak i Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Rrënojat e qytetit të fortifikuar të Balcit, që gjenden mbi një masiv shkëmbor me lartësi mbidetare 434.5 m, në këmbët e malit Maranaj (1576 m), i njohur gjerësisht si Maja e Balcit, nga banorët vendas si Ballexa e Rrjollit (Balli i Rrjollit ose përballë Rrjollit – P.Z.) dhe e mbiquajtur nga malësorët si “Forca e Lekëve (Lekët: Malësorët e Veriut – P.Z.)”, ndodhet 18.5 km në vijë të drejtë ajrore e 23 km në rrugë tokësore, në veri të Shkodrës dhe 10 km në vijë të drejtë ajrore e rreth 20 km në rrugë tokësore, në lindje të qytetit të Koplikut. Ky lokalitet ndodhet në jug të fshatit Reç, në veri të fshatit Kurtaj dhe pranë fshatit Rrjoll, në Malësinë e Madhe.

Archaeological Data from Drisht

Historical sources and archaeological data, as complementary to one another, provide valuable information for reconstructing many aspects of the life of a monument, center, or community. The importance of archaeological data is indisputable. Through the identification, classification, and interpretation of data within their context, archaeologists can verify and support written documentary sources.

This study presents the results of archaeological research (2014–2023) conducted in Drisht, where historical sources and studies regarding the city's history and character have been revisited several times, while archaeological research is still in its early stages. Archaeologically, Drisht represents an "excellent witness" and stands as enduring and significant evidence of urban history over a time span from the archaic era to the modern period. Few centers in our country carry such potential for documenting and interpreting life over such an extended period.

Despite the studies conducted and the efforts for comprehensive archaeological documentation, we still lack a complete urban reconstruction or a detailed historical interpretation of the castle's phases of life. Archaeological investigations undertaken over the years to fill gaps in topographical and chronological data have also brought to light a considerable amount of archaeological material. This material not only correlates with and verifies historical sources but, in some cases, also introduces new data.

Keywords: Drisht, Archaeology, History, Architecture, Archaeological Artifacts.

Emil Lafe

Vepra postume e Justin Rrotës "Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore"(2006) dhe disa vlera të saj për studimet e sotme në fushën e gramatikës

Vepra postume e J. Rrotës është gramatika e vetme e gegërishtes e hartuar gjatë periudhës së pasluftës në Shqipëri, me theks të veçantë në variantin letrar të lëvruar në Shkodër, por me prirje njësimi brenda gegërishtes letrare dhe më tej brenda shqipes së përbashkët letrare. Në këtë kumtesë trajtohen disa çështje gramatikore (morfologjike e sintaksore) që J. Rrota i ka vëzhguar me mprehtësi dhe që nuk kanë gjetur trajtim më të plotë të mëtejshëm në gramatikat e shqipes, si p.sh.: a) përshtatja e mbiemrit me emra vetjakë për femra që kanë paradigmën e lakimit të parë, si: *Beti, Kudret, Beti* etj.; b) disa emra mashkullorë që, "kur përdoren si masë sasiat a madhsiet, edhe në shumës nuk ndrojnë trajtën e njësisit: *Na i çu dy gisht letër*" etj.; c) shumësi normativ i disa emrave mashkullorë si: *mësues, nëpunës; doktorë, profesorë, klientë, studentë etj. dhe mësuesa, klienta, doktora etj.*; ç) luhatja e gjinisë të disa emra si *ligji - ligja, nderi - ndera* etj.; d) gjinia asnjësi në shqipen e sotme; dh) çështja e paradigmes së mbiemrave i zoti, e zoja (*djalë i zoti, vajzë e zoja*); e) përdorime të gabuara të disa trajtave përemërore (*neve, juve* si kryefjalë ose kundrinë e drejtë); ë) vëzhgime për disa trajta foljore dhe kuptime aspektore të tyre; f) vëzhgime për përdorimin e ndajfoljeve fort, shumë, tepër si edhe për disa çështje të tjera të fjalëformimit.

The Posthumous Work of Justin Rrota Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore (2006) and Its Value for Contemporary Studies in Grammar

The posthumous work by J. Rrota is the only grammar of the Gheg dialect developed during the post-war period in Albania, with particular focus on the literary variant cultivated in Shkodër. This work aims to standardise the literary Gheg and, ultimately, contribute to the unified literary Albanian language. This paper examines various grammatical issues (morphological and syntactic) that Rrota observed with keen insight, which have not been extensively explored in later Albanian grammars, including:

- a) The agreement of adjectives with feminine personal names that follow the first declension paradigm, such as *Beti*, *Kudret*, *Beti*, etc.;
- b) Certain masculine gender nouns that, when used to denote quantities or measurements, retain the singular form even in the plural: *Na i ço dy gisht letër* (Bring us two fingers' width of paper), etc.;
- c) The normative plural forms of certain masculine nouns, such as *mësues*, *nëpunës*, *doktorë*, *profesorë*, *klientë*, *studentë* (teachers, officials, doctors, professors, clients, students), and their alternative forms *mësues*, *klienta*, *doktora* (teachers, clients, doctors), etc.;
- ç) Gender fluctuations in certain nouns, such as *ligji* - *ligja* (the law - the law [fem.]), *nderi* - *ndera* (the honor - the honor [fem.]), etc.;
- d) The neuter gender in contemporary Albanian;
- dh) The paradigm issue for adjectives like *i zoti*, *e zoja* (competent boy, competent girl);
- e) Misuses of certain pronominal forms (*neve*, *juve* as subjects or direct objects);
- ë) Observations on verb forms and their aspectual meanings;
- f) Observations on the use of adverbs like *fort*, *shumë*, *tepër* (very, much, extremely), as well as other word-formation issues.

PAULIN PUSHIMAJ

Të dhëna arkeologjike nga Drishti

Burimet historike dhe të dhënat arkeologjike, si plotësuese të njëra-tjetrës, ofrojnë informacione të vlefshme në rindërtimin e shumë aspekteve të jetës së një monumenti, qendre apo komuniteti. Rëndësia e të dhënave arkeologjike është e padiskutueshme. Arkeologu, përmes identifikimit, klasifikimit dhe interpretimit të të dhënave në kontekstin e tyre, arrin të verifikojë e të mbështesë, burimet dokumentare të shkruar.

Studimi në fjalë paraqet rezultatet e kërkimeve arkeologjike (2014-2023) të kryera në Drisht, për të cilin burimet historike dhe studimet në lidhje me historinë dhe fizionominë e qytetit janë rishikuara disa herë ndërkohë që kërkimet arkeologjike janë akoma në hapat e parë. Në aspektin arkeologjik, Drishti përbën një "dëshmitar të shkëlqyer" dhe përfaqëson dëshminë e qëndrueshme dhe domethënëse të historisë urbane përgjatë një periudhe kohore midis epokës arkaike dhe asaj moderne. Janë të paketa, në vendin tonë, qendrat që mbartin një potencial të tillë për dokumentimin dhe interpretimin e jetës përgjatë një harku kaq të gjatë kohor.

Me gjithë studimet e kryera, dhe angazhimin për një dokumentacion arkeologjik shterues, akoma nuk e kemi një rindërtim të plotë urbanistik apo interpretim historik të detajuar të fazave të jetës së kështjellës. Hulumtimet arkeologjike të ndërmarra ndër vite, me qëllim plotësimin e të dhënave, në nivel topografik e kronologjik, kanë nxjerrë në dritë edhe një sasi të konsiderueshme materiali arkeologjik i cili, jo vetëm lidhet dhe vërteton burimet historike por në disa raste sjell të dhëna të reja.

Authorial Dictionary of the Works ‘Rrno vetëm për me tregue’ and ‘Histori kurrë e shkrueme’ by Father Zef Pllumi”

The communicative exchange between author and reader necessitates a deep understanding of the linguistic code. Examining the linguistic characteristics of these works enriches the portrayal of the Albanian nation, presenting not only a historical but also a linguistic snapshot within an epochal framework.

The analysis of the lexicon in Father Zef Pllumi’s works and the creation of an “Authorial Dictionary” was a moral responsibility for me, both as a native of Shkodra, since the language in “Rrno vetëm për me tregue” and “Histori kurrë e shkrueme” represents a valuable part of the Gheg dialect, and as a contemporary of some of the events described, which others remember as past experiences.

By applying both analytical and synthetic methods, I highlight the grammatical characteristics of Father Zef’s words, comparing them with the orthographic and grammatical rules established by the Albanian Orthography and Grammar. This adds unique value to the “Authorial Dictionary.”

Based on the linguistic evidence in Father Zef Pllumi’s works, I assert that dialectal bilingualism is present, linked to the shifts and development of language. These shifts occur between standard language and dialect, depending on Father Zef’s choice of expression. This phenomenon can be examined through a sociolinguistic lens. The Northwestern Gheg spoken by Father Zef is closely related to the Gheg dialect in the works of Camaj.

Through the presentation of the “Authorial Dictionary,” the lexical corpus of Gheg words in literary communication is now made available for linguistic analysis.

Emiljana Bajrami, Brilanda Bushati, Arjeta Troshani

Trashëgimia kulturore nëpërmjet ahengut shkodran

Ahengu shkodran është një pjesë e rëndësishme e kulturës muzikore në qytetin tone. Ky punim synon të analizojë origjinën, karakteristikat muzikore dhe ndikimin kulturor të ahengut shkodran. Përmes një analize të historisë së ahengut shkodran dhe hulumtimeve në fushën e muzikologjisë, do të shqyrtojmë zhvillimin e kësaj forme të muzikës tradicionale, përfshirë instrumentet muzikore të përdorura, strukturën e këngëve dhe rolin e ahengut në jetën sociale dhe kulturore të komunitetit shkodran. Për më tepër, punimi do të analizojë mënyrat në të cilat ahengu shkodran ka ruajtur dhe përhapur trashëgiminë kulturore të zonës së Shkodrës, duke përfshirë ndikimin e tij në muzikën popullore shqiptare në përgjithësi.

Synimi është përfshirja e ahengut shkodran në trashëgiminë kulturore jo materiale ndërkombëtare dhe të përcaktohen mënyrat se si kjo formë e muzikës tradicionale mund të përfitojë mbrojtjen dhe promovimin e saj në skenën ndërkombëtare të kulturës.

Cultural Heritage through the "Shkodran Aheng"

The "Shkodran Aheng" is a vital component of the musical culture of our city. This paper aims to explore its origins, musical features, and cultural influence. Through a historical examination of the "Shkodran Aheng" and musicological research, we will analyse the development of this traditional music form, including the instruments used, the song structure, and the role of the Aheng in the social and cultural life of the Shkodran community. Additionally, the paper will assess how the "Shkodran Aheng" has preserved and propagated the cultural heritage of the region, as well as its impact on Albanian folk music at large. The objective is to include the "Shkodran Aheng" in the international registry of intangible cultural heritage and to determine ways in which this traditional music form can receive protection and promotion on the global cultural stage.

Orjeta Dushi

Fjalori autorial mbi veprat "Rrno vetëm për me tregue" dhe "Histori kurrë e shkrueme" të Át Zef Pllumit.

Komunikimi referencial autor-lexues kërkon një njohje të mirë të kodit gjuhësor. Vrojtimi i gjendjes gjuhësore në këto vepra plotëson portretin e kombit shqiptar në një telajo epokale jo vetëm historike, por edhe gjuhësore.

Studimi i leksikut të veprave të at Zef Pllumit dhe hartimi i një "Fjalori autorial" ishte detyrim moral për mua nga njëra anë si shkodrane, sepse gjuha e veprave "Rrno vetëm për me tregue" dhe "Histori kurrë e shkrueme" është pasuri e fondit të gegërishtes e nga ana tjetër edhe si bashkëkohëse e një pjese të atyre viteve, që të tjerëve u paraqiten si kujtime.

Përdorimi i metodave analitike dhe sintetike për të vënë në dukje veçoritë gramatikore të fjalëve të at Zefit krahasuar me rregullat drejtshkrimore dhe gramatikore të përcaktuara nga Drejtshkrimi dhe Gramatika e gjuhës shqipe, ia shtojnë vlerën origjinale "Fjalorit autorial".

Duke u bazuar në dëshminë gjuhësore të at Zef Pllumit pohoj se kemi bilinguizëm dialektal, i cili lidhet me ndryshimin dhe zhvillimin e gjuhës, me kalimet e ndërsjellta nga gjuha standard në dialekt sipas përzgjedhjes së ligjërit nga pader Zefi. Konceptim ky në rrafshin sociolinguistik. Gegërishtja veriperëndimore e Z. Pllumit është e afërt me gegërishten e veprave të Camajt.

Me sjelljen e "Fjalorit autorial" është realizuar hapja e fondit leksikor të fjalëve geqe në komunikimin letrar sipas këndvështrimit gjuhësor.

The Lexicon of E. Koliqi: A Reflection of Shkodra's Spirit

"The Lexicon of E. Koliqi: A Reflection of Shkodra's Spirit," aims to showcase and analyse the unique and rich vocabulary of Shkodra as captured in the literary works of Ernest Koliqi. Known as a major figure in Albanian literature, Koliqi skilfully weaves distinctive words and expressions into his writing, capturing the culture and soul of the city of Shkodra. This paper explores how Koliqi uses language to recreate the atmosphere and authenticity of daily life in Shkodra, highlighting how local traditions, customs, and sensitivities shape his creative vision.

The analysis centres on Koliqi's use of rare vocabulary in *Mirrors of Narcissus* as part of his effort to preserve Shkodra's cultural identity at a time when modern influences were beginning to impact Albanian language and traditions. Drawing from Shkodra's oral tradition, this lexicon, written in the Gheg dialect, includes both regional expressions and neologisms that capture the Albanian spirit, offering a vivid testimony to the linguistic heritage preserved in Koliqi's work. This vocabulary reveals specific features of word formation in Shkodra and underscores the potential for enriching our national literary language. Examples include terms like *argëtimplotë* (full of joy), *bindim* (conviction), *breshnor* (hail-like), *degërrëfatun* (leaf-scattered), *errsimplotë* (deeply dark), *flakues* (fiery), *gjelbërore* (verdant), *me gjikinue* (to varnish), *gjysmaterr* (half-lit), *heshtimplote* (full of silence), *kangëdhurues* (song-giving), *me kërrutëzue* (to wrinkle), *kumbor* (echo), *me kunorue* (to crown), *mirardhje* (warm welcome), *ngjyrëmarrun* (color-drenched), *me vallue* (to dance), *vjollzore* (violet-hued), *i zbardhukët* (whitish), among others. Through examining these terms, this study deepens our understanding of their meanings and stylistic layers, offering insights into their expressive qualities and the cultural richness they convey.

Eranda Halluni Bilali, Nertila Haxhia Ljarja

Kontributi i Austro-Hungarisë në organizimin dhe zhvillimin e sistemit arsimor shqiptar

Ky artikull synon të shqyrtojë ndikimin dhe kontributin e Austro-Hungarisë në ndërtimin dhe organizimin e sistemit arsimor shqiptar gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Në periudhën e përballjes së shteteve të mëdha për ndikim në Ballkan, Austro-Hungaria luajti një rol të rëndësishëm në avancimin e arsimit në Shqipëri, duke mbështetur hapjen e shkollave dhe promovimin e gjuhës shqipe si pjesë e politikës së saj kulturore dhe strategjike. Artikulli analizon politikën arsimore të zbatuara nga autoritetet austro-hungareze dhe përpjekjet e tyre për të ndihmuar në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm arsimor në zonat e banuara nga shqiptarët. Duke u bazuar në burime arkivore, dokumente diplomatike dhe materiale nga shtypi bashkëkohor, studimi shqyrton mënyrat në të cilat Austro-Hungaria ndihmoi në ngritjen e infrastrukturës arsimore, përgatitjen e mësuesve dhe sigurimin e materialeve mësimore. Artikulli nxjerr në pah rëndësinë e ndihmës austro-hungareze për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar shqiptar përmes arsimit, si dhe ndikimin afatgjatë të këtyre përpjekjeve në formimin e sistemit arsimor modern në Shqipëri.

The Contribution of Austro-Hungary to the Development and Organisation of the Albanian Educational System

This article examines the influence and contribution of Austro-Hungary in the establishment and organisation of the Albanian educational system during World War I. At a time when great powers competed for influence in the Balkans, Austro-Hungary played a significant role in advancing education in Albania by supporting the establishment of schools and promoting the Albanian language as part of its cultural and strategic policies. The article analyses the educational policies implemented by the Austro-Hungarian authorities and their efforts to help create a sustainable educational system in areas inhabited by Albanians. Drawing on archival sources, diplomatic documents, and materials from contemporary press, the study explores how Austro-Hungary contributed to building educational infrastructure, training teachers, and providing teaching materials. The article highlights the importance of Austro-Hungarian support in preserving and developing the Albanian national identity through education, as well as the long-term impact of these efforts on the formation of Albania's modern educational system.

Orjeta Baja

Leksiku i E. Koliqit - pasqyrë e shpirtit shkodran

Tema "Leksiku i E. Koliqit - pasqyrë e shpirtit shkodran" synon të evidentojë dhe analizojë leksikun e pasur dhe autentik të Shkodrës përmes veprës letrare të Ernest Koliqit. Si një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë shqiptare, Koliqi është i njohur për aftësinë për të përfshirë në shkrimet e tij fjalë e shprehje me stil të veçantë, që reflektojnë kulturën dhe shpirtin e qytetit të Shkodrës. Kjo kumtesë do të shqyrtojë sesi Koliqi e përdor leksikun për të rikrijuar atmosferën dhe autenticitetin e jetës së përditshme shkodrane, duke nxjerrë në pah ndikimin e traditës, të zakoneve dhe të ndjeshmërisë së kësaj zone në krijimtarinë e tij.

Analiza do të fokusohet në përdorimin e fjalëve të rralla në veprën "Pasqyrat e Narçizit", si një përpjekje për të ruajtur identitetin kulturor të qytetit të Shkodrës, në një periudhë kur elemente të modernitetit po ndikinin në gjuhën dhe traditat shqiptare.

Kjo lëndë leksikore, gegërishte, nga gurra popullore e Shkodrës, me fjalë të ligjërit shkodran, por edhe me neologjizma, që shprehin ndjesi të shpirtit shqiptar, vjen si një nga dëshmitë e gjalla të visarit gjuhësor që shpaloset aty. Ato hedhin dritë mbi disa veçori të leksikut e të fjalëformimit në zonën e Shkodrës. Nga ana tjetër, ato tregojnë edhe mundësitë e pasurimit të mëtejshëm të gjuhës sonë letrare kombëtare, me fjalë të tilla, si: argëtimplotë, bindim, breshnor, degërrëfatun, errsimplotë, flakues, gjelbërrore, me gjikinue, gjysmaterr, heshtimplotë, kangëdhurues, me kërrutëzue, kumbor, me kunorue, mirardhje, ngjyrëmarrun, me vallue, vjollzore, i zbardhukët etj. Duke bërë një hulumtim mbi to, do të depërtohet më thellë në përmbajtjen e tyre, si dhe do të nxirren edhe një varg përfundimesh si për kuptimet, ashtu edhe për ngarkesat stilistikore.

Analysis of the Relationship Between Coordination and Jumping Skill Tests (Impact on Defensive Play Improvement)

Advances in volleyball training have significantly transformed women's teams, with defence becoming a critical component in today's training strategies. This study explores the relationship between coordination and jumping skill tests, examining how these factors influence the quality of defensive play. The study presents findings from a group of 24 national-level volleyball players in Albania, aged 19–21, who underwent a 12-month experimental training program. This research demonstrates how physical testing can reduce subjectivity in physical assessments, enabling coaches to identify a player's strengths and weaknesses at different stages of the season. With the game's increasing speed and the adoption of new offensive and defensive tactics, the connection between an athlete's physical profile and optimal athletic preparation has never been more crucial.

Dr. Ermira ALIJA, Klodjanë MARTICANAJ

Tracki për Shqiptarët dhe shqiptarët për Trackin

Punimi synon të sjellë në vëmendje një personalitet të njohur pak, siç është misionari gjerman Dom Alfons Tracki që ka kontribuar shumë për Shkodrën, për popullin tonë, jo vetëm në aspektin shpirtëror, por edhe në atë kulturor e social. Theksojmë këtu se ai ishte njohës shumë i mirë i gjuhës shqipe, i folklorit tonë dhe i mentalitetit të shqiptarëve. Ky fakt do ta ndihmonte në krijimin e rrethit kulturor, edukativ dhe sportiv "Viribus Unitis", në Shkodër, ku do të mblidhte rininë, pa asnjë dallim e do ta formonte në vlera të larta njerëzore. Metodat e Trackit u përdorën pastaj edhe prej Don Mikel Koliqit, Don Zef Pukës, At Pjetër Mëshkallës etj.

Figurën e Trackit do ta shohim përmes syve të nxënësve të tij, si Pader Zef Pllumi O.F.M. e Pader Konrrad Gjollaj O.F.M apo edhe të personaliteve që e kanë njohur më nga afër. Nga ana tjetër, punimi sjell vlerësimin e personaliteteve shqiptare për jetën dhe veprën e misionarit gjerman që e konsideronte veten më shumë shqiptar se sa gjerman dhe që nuk pranoi të largohet nga Shqipëria në periudhën e komunizmit, që mos t'i braktiste shqiptarët, edhe pse e dinte se e ardhmja ishte shumë e errët.

TRACKI FOR THE ALBANIANS AND THE ALBANIANS FOR TRACKI

This paper aims to bring attention to a little-known personality, the German missionary Dom Alfons Tracki, who greatly contributed to Shkodra and to our people, not only spiritually but also culturally and socially. It is noteworthy that he was a profound connoisseur of the Albanian language, our folklore, and the mindset of the Albanian people. This fact helped him establish the cultural, educational, and sports circle "Viribus Unitis" in Shkodra, where he gathered the youth, without distinction, and nurtured them in high human values. Tracki's methods were later used by Don Mikel Koliqi, Don Zef Puka, At Pjetër Mëshkalla, among others.

The figure of Tracki will be explored through the eyes of his students, such as Pader Zef Pllumi O.F.M. and Pader Konrrad Gjolaj O.F.M., as well as through the perspectives of personalities who knew him closely. On the other hand, the paper also highlights the appreciation of Albanian personalities for the life and work of the German missionary who considered himself more Albanian than German and refused to leave Albania during the communist period to avoid abandoning the Albanians, even though he was aware that the future looked very bleak.

Nora Deda

Studimi i marrëdhënieve midis testeve për Skoordinim dhe aftësi kërcimi (ndaj impaktit që këto teste kanë në përmirësimin e cilësisë së lojës në mbrojtje)

Procesi i stërvitjes në volejboll ka shkaktuar ndryshime radikale në ekipet e femrave. Një nga elementet kryesore të procesit të sotëm të stërvitjes është mbrojtja. Tema që kam zgjedhur për të qenë pjesë e kërkimit tim trajton marrëdhënien midis testeve për koordinim dhe aftësi kërcimi, analizën e plotë të ndikimit që ka kjo marrëdhënie në përmirësimin e cilësisë së lojës në mbrojtje. Në këtë studim, kemi paraqitur rezultatet e një grupi prej 24 volejbollistesh, të moshës 19-21 vjeç, të cilat luajnë në nivel kombëtar në Shqipëri. Këto volejbolliste ishin subjekt i një eksperimenti 12-mujor. Ky punim synon të na bindë se përdorimi i testeve fizike e bën të mundur eliminimin e subjektivitetit në vlerësimin e gjendjes fizike, zbulimin e pikave të dobëta dhe të forta të një lojtari në periudha të ndryshme të sezonit sportiv. Shpejtësia e vazhdueshme e lojës dhe adoptimi i teknikave të reja, si dhe skemat e lojës sulmuese dhe mbrojtëse e bëjnë të padiskutueshme lidhjen e strukturës së lojtarit dhe përgatitjen e tij të mirë fiziko-atletike.

Professor Danish Jukni: “A Legacy Beyond Creation”

This study explores the context and subjectivity of the works created by Professor Danish Jukni. Constructing a body of artistic work is no easy feat, especially for an artist whose influence spans across generations. Danish Jukni had a unique connection to the Albanian artistic landscape, which he expressed with elegance and professionalism, through both context and words. He had the ability to observe the world in a subtle, almost hidden way, far from the watchful eye. He often stated that to follow the right path, one must sometimes sacrifice oneself for something greater. A person does not come into this world merely to be honest, but to offer to humanity something greater, to defend goodness, and to resist the kind of banality, within which many people get trapped. Critics have defined him as an artist of colours and a person who conveyed life through words.

Ervis Krymbi, Ornela Hasrama, Leona Qokthi

Vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në hapësirën e lumit Buna

Lumi Buna rrjedh në veriperëndim të territorit të Shqipërisë, përgjatë kufirit shqiptaro-malazez. Në kompleksin e ujërave përgjatë Lumit Buna, nga liqeni i Shkodrës dhe deri në detin Adriatik, përshkrohen disa sipërfaqe të rëndësishme natyrore. Gjatësia e Lumit Buna është 44 km, nga të cilat rreth 20 km i përkasin Shqipërisë, dhe pjesa tjetër 24 km Malit të Zi. Buna është lumë tërësisht fushor, që lidh Liqenin e Shkodrës me Detin Adriatik. Është kufi ndarës mes krahinës së Anamalit, në të djathtë, dhe fushave të Trushit e të Velipojës, në anën e majtë. Buna është lumi i vetëm në Shqipëri që ka deltë natyrore; ishulli Ada e ndanë Bunën në dy degë para se të derdhet në det. Itineraret ekoturistike kanë mundësi të madhe zhvillimi në hapësirën ku kalon Lumi Buna. Bregu një plazh ranor, rrëzë lumit Buna është krijuar nga depozitimet e këtij lumi në pjesët anësore të tij. Kjo pikë ka vlera për zhvillimin e ekoturizmit. Nga Bregu në kodër Belaj kemi një pamje të mahnitshme të Lumit Buna dhe fushave të Nënshkodrës, kodrës së Fraskanjelit nga ana malazese, pyjeve me shkurre mesdhetare. Në kodër Belaj në lartësinë 118 m ruhen sot gjurmët e mureve të një fortifikimi mesjetar. Delta e lumit Buna ofron një përzierje harmonike të bukurisë së peizazheve natyrore dhe rëndësisë ekologjike dhe mjedisore. Dinamizmi ekologjik i Lumit Buna, që në periudha të ndryshme të vitit vendos kufirin midis tokës dhe ujit, është elementi që shërben për të dhënë jetë një imazhi të ri me mjaft ndikime pozitive në këtë territor. Interesi për këtë zonë është i madh, pasi ka fusha të mëdha shfrytëzimi, si në aspektin e ekoturizmit, peshkimit, bujqësisë, agroturizmit.

Natural and Cultural Heritage of the Buna River Region

Buna River flows through northwestern Albania, tracing the Albanian-Montenegrin border and encompassing a unique water network from Shkodra Lake to the Adriatic Sea, featuring notable natural landscapes. Spanning across 44 kilometres—20 in Albania and 24 in Montenegro—Buna is a lowland river that links the Lake of Shkodra with the Adriatic, forming a natural boundary between the Anamali region, to the right, and the Trushi and Velipoja plains, to the left. It is Albania’s only river with a natural delta, wherein the Ada Island divides it into two branches as it approaches the sea.

The Buna River area holds great potential for ecotourism. One highlight is Bregica, a sandy beach formed by the river’s deposits along its banks, ideal for the development of eco-friendly tourism. Moving from Bregica to Belaj Hill reveals stunning views of the Buna River, the Shkodra lowlands, Fraskanjel Hill across the Montenegrin border, and Mediterranean shrub forests. The remnants of medieval fortification walls can still be seen on the Belaj Hill, at an elevation of 118 meters.

The Buna River delta offers a harmonious blend of natural beauty and ecological importance. Its dynamic ecosystem, where the boundary between land and water shifts seasonally, creates a landscape that continues to evolve with positive ecological impact. This area holds significant interest for its potential in ecotourism, fishing, agriculture, and agro-tourism.

Keywords: Buna River, Ecotourism, Itineraries,
Natural Potentials, Natural Heritage

Nirvana Baja

Profesor Danish Jukni, “Një trashëgimi më e gjërë se krijimi”.

Në kontekstin e subjektives do të jetë ky studim, i veprave breza të ndërtuara nga profesori Danish Jukni. Nuk është e lehtë të ndërtosh një vepër arti, aq më tepër një artist të ardhshëm, duke lënë gjurmë të gjalla nëpërmjet veprave të artit ndër breza. Danish Jukni gëzonte një lloj kulture ndryshe për realitetin artistik shqiptar, të cilën e përçoi me finesën e fjalës, me kontekstin enigmatik dhe me profesionalizëm. Ai dinte të shihte botën fshehurazi ndaj syrit vigjilent të mjedisit; ai thoshte gjithmonë se, për të ndjekur udhën e drejtë, duhet ta flijosh veten gjer në fund. Njeriu vjen në këtë botë jo vetëm që të jetë i ndershëm, por për të zbuluar për njerëzimin diçka më të madhe, për t’i dalë zot mirësisë dhe për të luftuar banalitetin, mes të cilit shumica e njerëzve zvarrisin jetën e vet. Nga kritika, u cilësua si artisti i ngjyrave dhe si njeri e përçoi atë nëpërmjet fjalës.

innovation ecosystem that connects scientific research with market demands. Through collaboration with industry, local government, and the community, the University could contribute to sustainable economic development in the region by promoting data-driven policies, entrepreneurship, and the creation of start-ups, ultimately becoming a catalyst for social and economic progress in the Shkodra region.

Evalda Paci

Figura e një bibliofili model në shkrime e studime tematike (W.Kamsit in memoriam)

Si një figurë e bibliofilisë shqiptare, Willy Kamsi mbart tipare të dijetarit e studiuesit të përkushtuar, duke i reflektuar ato në çdo punë të kryer e në çdo ndërmarrje me objekt librin e kulturën e lëvrimin e të ruajtjes së tij. Kontributet e tij për historinë e shkrimit shqip dhe për njohjen e ekzemplarëve të librit mw të hershëm shqip tashmë janë pjesë e një trashëgimie të çmuar, që lidhet me letërsinë e vjetër shqipe dhe shkrimin shqip. Kujdesimi i tij për veprën e Frang Bardhit e të filologut frëng Mario Roques (1875-1961), por dhe për historikun e librit të Gjon Buzukut mbetet një prej orientimeve kryesore në perkursin jetësor e profesional, duke e dalluar dhe si studiues të teksteve të vjetra shqipe. Një dëshmi e qartë e këtyre kontributeve janë dhe artikujt tematikë të gjurmueshëm në revistat shkencore me objekt studimet albanologjike në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Me hartimin e vëllimeve bibliografike mbi të përkohshmet e gjysmës së parë të shekullit të kaluar (Albania, Leka, Hylli i Dritës, Shkëndija, Shëjzat), Kamsi ka dhënë një kontribut fort të çmuar në pikëpamje të burimeve referenciale në lidhje me një sërë disiplinash e veprash.

The Figure of a Model Bibliophile in Writings and Thematic Studies (W. Kamsi In Memoriam)

Willy Kamsi stands as a significant figure in Albanian bibliophilia, embodying the qualities of a devoted scholar and researcher. He reflected these traits in every project he undertook, particularly those focused on books and the culture of their creation and preservation. His contributions to the history of the Albanian language and the study of early Albanian book specimens have become an essential part of the heritage linked to old Albanian literature and the Albanian script. Kamsi's dedication to the works of Frang Bardhi and the French philologist Mario Roques (1875-1961), along with his research into the history of Gjon Buzuku's book, represents a key area of his academic and professional life, positioning him as a distinguished scholar of ancient Albanian texts. The impact of his work is evident in the thematic articles he published in scholarly journals focused on Albanian studies, both in Albanian and other languages. Through his bibliographic compilations of periodicals from the first half of the 20th century (such as *Albania*, *Leka*, *Hylli i Dritës*, *Shkëndija*, and *Shêjzat*), Kamsi made an invaluable contribution to reference sources across various disciplines.

The Role of Universities in Regional Development Strategies:

The Case of the University of Shkodra as a Local Actor and Its Participation in Policymaking

The growing focus on collaborative approaches in innovation and regional governance has heightened expectations for universities to play a pivotal role in developing strategies and taking on more extensive, impactful responsibilities. However, the complexities of policy processes, regional contexts, and universities' institutional capacities are often underestimated or inadequately addressed when defining their role.

Research Question

What role do universities play in local policy collaborations and in fostering a culture of entrepreneurship and innovation within the region? How can the University of Shkodra contribute to regional development by positioning itself as a key player in regional innovation and governance strategies?

This study adopts both theoretical and empirical approaches to examine the role of the University of Shkodra within the framework of the regional innovation strategy. The research methods include a review of literature on universities' involvement in regional development and innovation policies, contrasted with the specific case of the University of Shkodra within the context of the Third Mission of universities. Additionally, interviews with various regional stakeholders and an analysis of existing partnerships between the university, local businesses, and government are utilised to assess the impacts and potential of strategic collaborations.

The study seeks to provide a deeper understanding of the roles universities can assume in shaping regional strategies for innovation and governance. The University of Shkodra has the potential to establish itself as a leading entrepreneurial institution by creating a vibrant

Universiteti do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të rajonit përmes politikave të bazuara në të dhëna, sipërmarrjes dhe krijimit të start-up-ëve, duke u bërë kështu një katalizator për zhvillimin social dhe ekonomik në rajonin e Shkodrës.

Faton KRASNIQI

Profesor Jup Kastrati bibliografist dhe historian i albanologjisë

Profesor Jup Kastrati me përkushtimin e tij në fushë të bibliografisë dhe të historisë së gramatologjisë shqiptare ka arritur në një nivel të lartë të studiuësit të mirëfilltë shqiptar. Ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në këto dy fushëveprimtari shkencore, pasi që nxori në dritë disa monografi të rëndësishme të albanologjisë, si: I. Studime gjuhësore, fond mjaft i gjerë, që do të mund të ndahej në: fonetikë, drejtshkrim, morfologji – sintaksë, albanistikë e histori e gjuhësisë shqiptare. II. Studime letrare, fond mjaft i gjerë, që do të mund të ndahej në: histori e Letërsisë së Vjetër, histori e letërsisë së Periudhës së Rilindjes Kombëtare, Periudha e Pavarësisë, letërsi shqiptare e realizmit socialist. III. Bibliografi shqiptare. Profesor Jup Kastrati, ka bërë një punë të rëndësishme shkencore, të kujdesshme duke aplikuar një metodologji mjaft moderne dhe shkencore në kërkimet dhe hulumtimet tij dhe ka arritur të jetë mjaft prodhimtar në këto dy fushëveprimtari. Në këtë mënyrë, punimet e sipërpërmendura janë një kontribut i çmuar shkencor për bibliografinë dhe për historinë e gramatologjisë shqiptare.

Professor Jup Kastrati: Bibliographer and Historian of Albanian Studies

Professor Jup Kastrati, through his dedication to the fields of bibliography and the history of Albanian grammar, has become a leading figure in Albanian scholarship. His contributions to these two areas are substantial, having produced several key monographs in Albanian studies, including: I. Linguistic studies, a wide-ranging collection that can be categorised into: phonetics, orthography, morphology, syntax, Albanian studies, and the history of Albanian linguistics. II. Literary studies, a comprehensive body of work that includes: the history of Old Literature, the history of literature during the National Renaissance, the period of Independence, and Albanian literature in socialist realism. III. Albanian bibliography. Professor Kastrati's research is marked by rigour and a modern scientific methodology, making him highly productive in these fields. His work offers a significant scientific contribution to both bibliography and the history of Albanian grammar.

Nevila Xhindi, Holta Heba

Roli i Universiteteve në strategjitë e zhvillimit Rajonal - rasti i Universitetit të Shkodrës ndër aktorët lokalë dhe përfshirja në politikëbërje

Rritja e qasjeve bashkëpunuese në politikat e inovacionit dhe qeverisjes rajonale ka shtuar pritshmëritë për angazhimin e universiteteve në krijimin e strategjive dhe marrjen e roleve më të gjera dhe më të rëndësishme. Megjithatë, kompleksitetet e procesit të politikave, konteksti rajonal dhe kapacitetet institucionale të universiteteve shpesh janë të nënvlerësuara apo të paanalizuara plotësisht kur përcaktohet roli i tyre.

Pyetja Kërkimore

Çfarë roli luajnë universitetet si në bashkëpunimet për politika locale dhe në nxitjen e kulturës së sipërmarrjes dhe inovacionit në rajon? Si mund të kontribuojë Universiteti i Shkodrës në zhvillimin rajonal duke u pozicionuar si një aktor kyç në strategjitë e inovacionit dhe qeverisjes rajonale?

Ky studim përdor një qasje teorike dhe empirike për të analizuar rolin e Universitetit të Shkodrës si pjesë e strategjisë së inovacionit rajonal. Metodatat përfshijnë analizën e literaturës mbi qasjet e Universiteteve drejt politikave të zhvillimit rajonal dhe inovacionit, krahasuar me rastin e Universitetit të Shkodrës në kuadrin e Misionit të Tretë të universiteteve. Përdoren gjithashtu intervista me aktorë të ndryshëm në rajon dhe analizë e bashkëpunimeve ekzistuese ndërmjet universitetit, biznesit dhe pushtetit vendor për të kuptuar ndikimet dhe potencialet e partneriteteve strategjike.

Studimi pritet të kontribuojë në kuptimin më të thellë të roleve që universitetet mund të marrin në zhvillimin e strategjive rajonale për inovacion dhe qeverisje. Universiteti i Shkodrës mund të pozicionohet si një universitet sipërmarrës lider duke krijuar një ekosistem dinamik inovacioni, që lidh kërkimin shkencor dhe nevojat e tregut. Përmes bashkëpunimit me industrinë, pushtetin vendor dhe komunitetin,

Contributions of the French "Architect" Augustin Briot to Shkodër

This article examines the work of French architect Augustin Briot and the influence of French architecture in the city of Shkodër during the 19th century and the early 20th century. During this period, Western influences, particularly French ones, emerged as a result of the political, economic, and cultural developments that connected Shkodër to major European centers. Through an analysis of Briot's projects, the article sheds light on how French styles and techniques were integrated into the city's public, private, and religious buildings. It also explores the impact of this heritage on the urban identity and transformation of the city. This study aims to highlight the role of architect Augustin Briot as a key figure in the development of modern architecture in Shkodër and the consolidation of cultural ties between Shkodër and France.

Fitim Veliu

Skënder Drini dhe kënga epike e historike

Në romanet e Skënder Drinit, para dhe pas periudhës së monizmit, synojmë të trajtojmë trashëgiminë epike e historike në disa nga romanet e tij, me vlera të veçanta letrare e estetike.

Romanet e Drinit shquhen për lidhjen e diskursit personal me diskursin oral, si trashëgimi e shprehje estetike, ndaj gjetjet tona në këtë rrafsh janë mbresëlënëse, meqë Drinin tashmë e kam të studiuar edhe në nivel doktrate.

Romanet si referencë e kësaj natyre të analizës janë: Shembja e idhujve, Midis dy kohëve, Vraje Tradhtinë, Tanush Martini etj. Në të gjitha këto romane e kemi të pranishëm këngën epike legjendare, si farë, historike si radhë dhe folklorike si fushë e nivelit estetik.

Skënder Drini and the Epic and Historical Song

This paper examines the epic and historical heritage present in Skënder Drini's novels, both from before and after the monist period, focusing on their distinct literary and aesthetic qualities. Drini's works stand out for their fusion of personal narrative with oral discourse, a legacy and aesthetic form of expression. Our findings in this regard are compelling, especially considering that Drini's works have already been studied at the doctoral level.

The novels referenced for this analysis include Shembja e Idhujve (The Fall of Idols), Midis Dy Kohëve (Between Two Eras), Vraje Tradhtinë (Betray the Betrayal), Tanush Martini, and others. In these works, the legendary epic song appears as a seed, the historical song as a sequence, and the folkloric as a realm of aesthetic value.

Nertila Haxhia Ljarja, Gjovalin Çuni

Kontribute të "arkitektit" francez Augustin Briot për Shkodrën

Artikulli trajton veprimtarinë e arkitektit francez Augustin Briot dhe ndikimin e arkitekturës franceze në qytetin e Shkodrës gjatë shekullit të XIX dhe fillimit të shekullit XX. Në këtë periudhë, ndikimet perëndimore, veçanërisht ato franceze, u shfaqën si rezultat i zhvillimeve politike, ekonomike dhe kulturore që lidhën Shkodrën me qendrat kryesore të Evropës. Përmes një analize të projekteve të Briot, artikulli hedh dritë mbi mënyrën se si stilet dhe teknikat franceze u integruan në ndërtesat publike, private dhe fetare të qytetit. Gjithashtu, shqyrtohet ndikimi i kësaj trashëgimie në identitetin urban dhe transformimin e qytetit. Ky studim synon të theksojë rolin e arkitektit Augustin Briot si një figurë kyçe në zhvillimin e arkitekturës moderne në Shkodër dhe në konsolidimin e lidhjeve kulturore midis Shkodrës dhe Francës.

The Role of Dialectal Lexicon in Enriching the Albanian Language

Words and expressions that remain in popular speech are an endless source for enriching the Albanian language. This paper aims to highlight some of the potential values of this linguistic wealth. Specifically, it will explore words that have entered or could enter standard Albanian as new terms or as synonyms, enriching the language with additional meanings, emotional nuances, and other subtle variations. Some examples of terms with negative figurative meanings (pejoratives) include: barkaçok, bishtjegun, bethuk, bub, buzoq, cofëtinë, cub, dallavesh, among others.

The objective of this paper is to demonstrate the value of dialectal lexicon in enriching the Albanian language, particularly at a time when work is underway on the Great Dictionary of the Albanian Language. Thousands of dialectal lexical units have already been gathered and provided as material for this project.

The focus will be on the dialectal lexicon of the Kosovo dialect, which is rich in both semantic and stylistic values. This lexical wealth has the potential to extend beyond local dialects, contributing to the broader Albanian language. Examples include: detelinë/tërfonjë/tërfojë-jonxhë, baltushme(e)-e pakripë(pa shije), buzán-buzëtrashë, bythec-frikacak, dorëkëputun/dorëhollë - i varfër, gjamatóre-vajtore, kapërthurtë - i/e ngatërruar, pusán-qyqar, qyqóhem-bëhem për keqardhje, syúntë-i pangopur, and others.

Flamur Shala

Kategoria e kohës e trajtave analitike të foljeve të gjuhës shqipe sipas Kolec Topallit

Gramatika e gjuhës shqipe (2002) përshkruan format e kohëve analitike të sistemit foljor të shqipes standarde. Secila nga këto forma ka historinë e prejardhjes dhe të gramatikalizimit, për të cilat kanë dhënë mendimin e vet studiues të kësaj fushe dhe jo vetëm. Kolec Topalli një pjesë të studimeve të veta ia kushtoi trajtimin të sistemit foljor në përgjithësi dhe trajtave analitike të foljeve të gjuhës shqipe në veçanti. Ai ka sjellë një informacion të gjerë lidhur me historinë, prejardhjen dhe zhvillimin e këtyre trajtave, dhe ka ndërtuar mendimin e vet për formimin e tyre.

Trajtimi mbi zhvillimin historik të trajtave analitike kohore të foljes, që ka bërë Kolec Topalli, brenda librit "Sistemi foljor i gjuhës shqipe" (2010), përfshin kohët e kryera, kohët e ardhme dhe format analitike të pashtjelluara të foljeve të gjuhës shqipe. Forma të kohëve të kryera analitike dhe të së ardhmes ka krijuar edhe gjuha shqipe. Shqipja ka krijuar forma analitike të kohëve të kryera, në të gjitha mënyrat pos urdhërores, me pikë referimi të tashmen. Përveç trajtave të kohëve të kryera, shqipja ka krijuar edhe kohë të mbipërbëra (kish pasë ardhë, m'ka pasë thanë etj.). Këto trajta foljore tregojnë një veprim që ka ndodhur larg nga e tashmja, si pikë referimi.

Në këtë punim do të flasim për këto forma të kohëve foljore të trajtuara nga studiues të gjuhës shqipe dhe trajtimin sintetizues që u bën Prof. Kolec Topalli, duke shtuar aty këtu mendimin tim.

The Category of Tenses in the Analytical Forms of Albanian Verbs According to Kolec Topalli

The Grammar of the Albanian Language (2002) outlines the analytical tense forms in the verb system of standard Albanian. Each of these forms has its own history of origin and grammaticalisation, which has been examined by scholars. Among others, Kolec Topalli devoted part of his research to the study of the verb system in general and the analytical forms of Albanian verbs in particular. He provided extensive information on the history, origin, and development of these forms and offered his own perspective on their formation.

Topalli's examination of the historical development of analytical verb tenses, presented in his book *The Albanian Verb System* (2010), addresses the past tenses, future tenses, and uninflected analytical forms of Albanian verbs. Albanian has developed analytical forms for both past and future tenses. The linguistic system has created analytical forms for past tenses in all moods, except the imperative, with the present as the reference point. In addition to these past tense forms, Albanian also has compound tenses (e.g., "kish pasë ardhë," "m'ka pasë thanë," etc.), which indicate actions that occurred far from the present reference point.

In this paper, we will explore these verb tense forms as discussed by scholars of the Albanian language, as well as the comprehensive analysis provided by Professor Kolec Topalli, while also incorporating my own reflections throughout.

Naim Berisha

Vlerat e leksikut dialektor në pasurimin e shqipes

Fjalët e shprehjet që rrojnë në ligjërimin popullor janë gurrë e pashtershme për pasurimin e gjuhës shqipe, prandaj duke qenë kështu, përmes këtij punimi mëtohet të vihen në pah disa vlera potenciale të kësaj pasurie gjuhësore. Së këndejmi, do të trajtohen fjalë që kanë hyrë ose mund të hyjnë në gjuhën letrare si të reja apo si sinonime leksikore të fjalëve, të cilat e pasurojnë gjuhën me nuanca kuptimore, ngjyresa emocionuese etj. Po veçojmë vetëm disa nga emërtimet e shprehjet që përdoren me kuptime figurative negative (pazhorativë) veçojmë: barkaçok, bishtjegun, bethuk, bub, buzoq, cofëtinë, cub, dallavesh etj.

Në këtë punim synohet të vihen në pah vlera potenciale të leksikut dialektor për pasurimin e gjuhës, pikërisht në kohën kur po vazhdon puna në hartimin e Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe (pra, tashmë janë vjelë mijëra njësi leksikore dialektore dhe janë ofruar si material për këtë projekt).

Përqendrimi i këtij punimi do të jetë te leksiku dialektor i të folmeve të Kosovës, që karakterizohet me shumë vlera semantike e stilistike. Kjo pasuri leksikore lehtë mund t'i kalojë kufijtë e ngushtë të të folmeve dhe të bëhet pasuri e mbarë shqipes, si: detelinë/tërfojnë/tërfojë-jonxhë, baltushme(e)-e pakripë(pa shije), buzán-buzëtrashë, bythec-frikacak, dorëkëpútun/dorëhollë - i varfër, gjamatóre-vajtore, kapërthúrtë – i/e ngatërruar, pusán-qyqar, qyqóhem-bëhem për keqardhje, syúntë-i pangopur etj.

The Linguistic Landscape of the City of Shkodra: A Few Observations

Based on the premise of the Linguistic Landscape approach that public space is socially, politically and constructed and organised, my contribution deals with the (re)naming of streets and the use of historical memory in the Catholic cemetery of the city of Shkodra.

The focus is on the interaction between semiotic resources and social and cultural aspects in public space. Public inscriptions are part of everyday urban life, but they are also arenas in which struggles over nationalism, identity and memory shape the social production of urban space. The city's street names, for example, are closely linked to local identity, political goals, religious and value orientations.

Flora Gjoni, Zamira Kasemi, Adi Garuci

Rrugët tematike, forma të turizmit të qëndrueshëm rural. Itinerari Edith Durham

Rrugët, ose shtigjet tematike janë shndërruar sot, në rrejtin kryesor të promovimit të pasurive natyrore, duke u tregtuar si forma bashkëkohore të turizmit të qëndrueshëm, sidomos në zonat rurale. Tematika specifike e këtyre shtigjeve, krijon mundësinë e eksplorimit të gjeografisë së zonës në përgjithësi, veçanërisht të atyre me status mbrojtjeje. Atraksionet me karakter tematik mund të jenë parqet tematike, ngjarjet tematike dhe objekte tematike, etj. Në këtë punim ne duam që nëpërmjet këtyre formave të reja të të bërit turizëm, të mundësojmë tërheqjen e sa më shumë vizitorëve jo vetëm sezonalë, por gjithëvjetorë. Rrugët tematike ofrojnë një itinerar të strukturuar, që lidh atraksione natyrore, kulturore dhe historike, duke nxitur vizitorët të eksplorojnë dhe të angazhohen me kulturën dhe natyrën lokale, nëpërmjet diversifikimit të ofertës turistike. Hulumtimi ynë është fokusuar në një studim rasti, Parkun Kombëtar të Thethit, me natyrë mjaft specifike e diverse në të njëjtën kohë. Nëpërmjet këtij punimi, duam të sjellim një përvojë të re, duke personalizuar shtigjet tematike me emrin e një shkrintareje të huaj që erdhi në këtë zonë, duke sjellë informacione të vlefshme nga fusha të ndryshme. Narrativat e përdorura në veprat e saj nga kjo artiste dhe studiuese në të njëjtën kohë, do të jenë referencë në udhërrëfimin e këtij itinerari tematik. Personalizimi i itinerareve me emra studiuesish të huaj, mendojmë se janë një mënyrë efektive për të promovuar turizmin në zonat rurale dhe për të theksuar veçoritë kulturore dhe natyrore të tyre.

Thematic routes and forms of sustainable rural tourism: the Edith Durham itinerary

Thematic routes or trails have today become the primary network for promoting natural assets, marketed as contemporary forms of sustainable tourism, particularly in rural areas. The specific themes of these trails create opportunities to explore the geography of the area in general, especially those with protected status. Thematic attractions may include theme parks, thematic events, thematic landmarks, and more. In this paper, we aim to leverage these new forms of tourism to attract as many visitors as possible, not just seasonally but throughout the year. Thematic routes offer a structured itinerary that connects natural, cultural, and historical attractions, encouraging visitors to explore and engage with local culture and nature through the diversification of the tourism offer. Our research focuses on a case study of the Theth National Park, an area of specific and diverse natural beauty. Through this study, we aim to introduce a new experience by personalizing the thematic trail with the name of a foreign author who visited this area and provided valuable insights from various fields. The narratives used in her works, written by this artist and researcher, will serve as a reference in guiding this thematic itinerary. Personalizing itineraries with the names of foreign researchers is seen as an effective way to promote tourism in rural areas and highlight their cultural and natural features.

Monica Genesin

Peizazhi gjuhësor i qytetit të Shkodrës: disa vëzhgime

Bazuar në parimin e qasjes së peizazhit gjuhësor që hapësira publike është e ndërtuar dhe organizuar në mënyrë sociale dhe politike, kontributi im trajton (ri)emërtimin e rrugëve dhe përdorimin e kujtesës historike në varrezat katolike të qytetit të Shkodrës.

Fokusi është në ndërveprimin midis burimeve semiotike dhe aspekteve sociale dhe kulturore në hapësirën publike. Mbetjet publike janë pjesë e jetës së përditshme urbane, por ato janë gjithashtu arena ku luftërat mbi nacionalizmin, identitetin dhe kujtesën formësojnë prodhimin shoqëror të hapësirës urbane. Emrat e rrugëve të qytetit, për shembull, janë të lidhur ngushtë me identitetin lokal, qëllimet politike, orientimet fetare dhe vlerore.

The Institution of Besa in the “Code of Lekë Dukagjini”

The “Code of Lekë Dukagjini,” or the “Code” practiced “among the Leke (Highlanders of Upper Shkodra) and Dukagjin” (Fishta, 1933), represents the most structured form of Albanian customary law. The twelve chapters (“Books”) of the “Code,” with a total of 1263 paragraphs, outline the social organisation of the tribe in the absence of a state as a territorial unit with institutional governance.

The institution of the Besa, within the broader framework of blood feuds, is primarily defined in the tenth chapter, titled “The Book Against Wrongdoers” (The Book Against Evil Deeds). This article seeks to clarify paragraphs 898, 899, and 900 of article 125 (“Blood is for the Finger”) by placing them within their correct context, namely article 122, titled “Besa.” By doing so, we aim to resolve any uncertainties that may arise from an imprecise interpretation of paragraph 900 of article 125. Furthermore, organising these three paragraphs within their proper context illuminates the deeper meanings of the institution of the oath, while also demonstrating that the institution of blood feud in the “Code of Lekë Dukagjini” serves to eliminate blood feuds.

Florinka Gjevori, Dorina Daiu

Normalja e Elbasanit dhe roli i Luigj Gurakuqit në veprimtarinë e saj

Shkolla Normale e Elbasanit u hap në 1 Dhjetor 1909 dhe është e para shkollë e mesme kombëtare shqip në trevat shqiptare. Kjo shkollë eci dhe u zhvillua në kushte të veçanta të realitetit shqiptar dhe përjetoj fatet e kombit të saj gjatë periudhave të ndryshme të historisë. Normalja e Elbasanit kishte karakter mbarëkombëtar, jo vetëm pse pranonte nxënës nga të gjitha trojet shqiptare, të të tri besimeve fetare, por edhe për nga përmbajtja e lëndëve mësimore për formimin patriotik të mësuesve të ardhshëm. Arsimitarët e parë të saj qenë njerëzit më të shquar të kulturës shqiptare, si Aleksandër Xhuvani, Sotir Peci, Petër Dodbiba, Simon Shuteriqi, etj, ndërsa drejtori i parë i Normales ishte Luigj Gurakuqi, i cili është një nga personalitetet më të spikatur të lëvizjes sonë kombëtare, arsimore e kulturore në çerekun e parë të shekullit XX. Si drejtor i parë i kësaj shkolle ka meritën se përcaktoi drejt e qartë, më shumë se çdo paraardhës, konceptin mbi shkollën kombëtare shqiptare, përmbajtjen, karakterin dhe parimet e ndërtimit të saj. Ai kërkonte që gjithë fryma dhe përmbajtja e shkollës të ishte në funksion të qëllimeve dhe idealeve kombëtare.

Ky punim synon të sjellë një aspekt të historikut të shkollës Normale në fillesat e veprimtarisë së saj, që padyshim do të jetë themelvënës edhe në etapat në vazhdim. Për hartimin e këtij punimi jemi mbështetur në një seri të pasur materialelesh burimore dokumentare dhe besojmë që është një kontribut i shtuar në historikun e shkollës Normale, por edhe në historikun e arsimit shqiptar në tërësi.

Elbasan Normal School and the Role of Luigj Gurakuqi in its Activity

The Elbasan Normal School was established on December 1, 1909, and is the first national Albanian secondary school in the Albanian territories. This school progressed and developed under the unique conditions of the Albanian reality, experiencing the fate of the nation throughout various periods of history. The Elbasan Normal School had a pan-Albanian character, not only because it accepted students from all Albanian lands and from all three religious faiths, but also due to the content of its curriculum, which focused on the patriotic formation of future teachers. Its first educators were some of the most prominent figures of Albanian culture, such as Aleksandër Xhuvani, Sotir Peci, Petër Dodbiba, Simon Shuteriqi, among others. The first director of the school was Luigj Gurakuqi, one of the most distinguished figures of our national, educational, and cultural movement in the first quarter of the 20th century. As the first director of this school, he is credited with clearly defining, more than any predecessor, the concept of the Albanian national school, its content, character, and foundational principles. He sought to ensure that the spirit and content of the school served the goals and national ideals.

This paper aims to present an aspect of the history of the Elbasan Normal School during its early stages of operation, which undoubtedly laid the foundation for its subsequent phases. The development of this paper is based on a rich collection of documentary sources, and it is believed to contribute significantly to the historical record of the Normal School, as well as to the broader history of Albanian education.

Mirushe Hoxha, Valbona Toska

Institucioni i besës sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit

Kanuni i Lekë Dukagjinit, apo Kanuni i cili gjeti zbatim "ndër Lekë (Malësorë të Mbishkodrës) dhe Dukagjin" (Fishta, 1933), është forma më e sistemuar e së drejtës zakonore shqiptare. Dymbëdhjetë kapitujt („Librat”) e KLD-së me gjithsej 1263 paragrafë shprehin organizimin shoqëror nga ana e fisit, në mungesë të shtetit si njësi territoriale me organizim qeveritar institucional. Institucioni i besës brenda institucionit të gjakmarrjes merr trajtë përmes përkufizimit të saj, kryesisht në kapitullin e dhjetë të titulluar „Libri Kundra Mbrapshitëvet” (Libri kundër veprave të këqija). Ky artikull ka për qëllim të sistemojë paragrafët 898, 899 dhe 900 të nenit 125 („Gjaku shkon për gisht”) në suaza të kontekstit të tyre kryesor, e që është neni 122 i titulluar „Besa”. Në këtë mënyrë, tentojmë të sqarojmë paqartësitë, të cilat mund të lindin nga interpretimi i pavëmendshëm i paragrafit 900 të nenit 125. Njëkohësisht, sistemimi i tre paragrafëve të nenit 125 në suaza të kontekstit të cilit i takojnë, sqaron dhe domethëniet më të thella të institucionit të besës dhe, në anën tjetër, dëshmon se institucioni i gjakmarrjes sipas KLD-së ka për qëllim çrrënjësien e gjakmarrjes.

The Development of Albanian Grammarology with a Focus on Shkodër

From its early stages, the study of Albanian grammar often relied on the Gheg dialect as a key model for linguistic description. Shkodër, as a prominent centre, played a crucial role in the writing and publication of many grammars of the Albanian language. This paper aims to trace the journey of Albanian grammarology in several directions, considering Shkodër as an important site in the evolution of this field. The discussion will focus on the following points:

- Shkodër as a hub where a variety of Albanian grammars were developed and where many influential grammarians emerged.
- The Gheg dialect as a primary source for many Albanian grammars.
- Shkodër as a city where several successful attempts to shape the history of Albanian grammarology were made.
- Shkodër as a repository of unpublished linguistic relics.

The paper will also explore perspectives on how to uncover and highlight the wealth of unpublished materials in this area.

Gëzim Puka

Lëvizja teatrore studentore një nxitje e mirë për bashkëpunime ndërinstitucionale

Organizimi i shfaqjeve teatrale në universitet nuk është vetëm kënaqësi estetike, por është një punë që zhvillon cilësi shumë të mira për mësimdhënësit e ardhshëm, e pse jo edhe për profesionet e tjera. Kjo kumtesë synon të përshkruajë dhe analizojë disa prej përvojave të studentëve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me këtë art skenik.

Shfaqjet “Bretkosat” e Aristofanit, “Rinoceronti” i Joneskos dhe “Emira” e Santorit të realizuara përkatësisht në vitet 2015, 2017 dhe 2019, nxorën në pah vlerat e lojës teatrore për zhvillimin e aftësive dhe talenteve të studentëve. Në të njëjtën kohë këto shfaqje ishin bashkëpunime shumë të mira me Bashkinë e Shkodrës dhe Teatrin “Migjeni”. Krijimi i kushteve për veprimtari të tilla artistike rrit profilin kulturor të të rinjve, si dhe zhvillon një sërë shprehish të tjera. Gjatë këtij rrugëtimi artistik studentët zhvilluan edhe disa shprehi të punës në grup, vëmendjen dhe disiplinën artistike, që janë shumë të vlefshme për ardhmërinë e tyre profesionale.

Në tjetër qëllimshmëri e këtij artikulli është edhe paraqitja e një projekti konkret për t’i vijuar këto bashkëpunime mes institucioneve kulturore të Shkodrës.

Veprimtari të tilla janë të dobishme jo vetëm për të rinjtë, por edhe për vetë Universitetin e Bashkinë, pasi ndikojnë për imazhin e tyre si promovues të lëvizjes artistike amatore.

Student Theatrical Movement: A Valuable Opportunity for Inter-Institutional Collaboration

Organising theatrical performances at universities is not only an aesthetic endeavour but also a productive activity that helps develop essential skills for future educators and professionals in other fields. This paper aims to explore and analyse the experiences of students from the University of Shkodra „Luigj Gurakuqi“ in relation to the theatrical arts.

The productions of *The Frogs* by Aristophanes, *Rhinoceros* by Ionesco, and *Emira* by Santori, presented in 2015, 2017, and 2019 respectively, demonstrated the significant impact of theatre in honing students' abilities and talents. These performances were also strong examples of successful collaboration with the Municipality of Shkodra and the „Migjeni“ Theatre. By creating opportunities for such artistic endeavours, we not only enhance the cultural engagement of young people but also foster the development of various other skills. Throughout this artistic process, students cultivated teamwork, artistic discipline, and focus—attributes that are crucial for their future careers.

In addition, this article presents a proposal for continuing these valuable collaborations among the cultural institutions of Shkodra. Such initiatives are beneficial not only for the students but also for the University and the Municipality, as they strengthen their reputations as promoters of amateur artistic movements.

Mimoza Priu

Për një rrugëtim të gramatologjisë shqipe drejt Shkodrës

Gramatologjia e gjuhës shqipe që në hapat e para të zhvillimit të saj pati si shkëndijë jo rrallë gegërishten si model përshkrimi gjuhësor, po edhe Shkodra u bë një qendër ku u hartuan e u botuan jo pak gramatika për shqipen. Punimi ynë synon ta ndjekë sadopak rrugëtimin e gramatologjisë shqipe në disa drejtime, duke e konsideruar Shkodrën si një vatër të rëndësishme të zhvillimit të këtij kahu gjuhësor. Diskutimin do ta fokusojmë në këto pika:

1. Shkodra si qendër ku zunë fill një sërë gramatikash të gjuhës shqipe dhe ku u formësuan mjaft gramatologë.
2. Gegërishtja si kod mbështetës i mjaft gramatikave të shqipes.
3. Shkodra si qytet ku pati disa sprova të suksesshme për një histori të gramatologjisë shqipe.
4. Shkodra si konservuese e relikeve të pabotuara.

Pjesë e punimit do të jenë trajtime që prekin edhe perspektivën, sidomos për nxjerrjen në dritë të gjithë pasurisë së pabotuar edhe në këtë lëmi.

Ida Melgushi: The Contours of a Biographical Portrait

What drives us to write a biography? How does the act of writing relate to research and exploration? What type of biography can we write? Certain individuals naturally lead us to approach them in specific ways, guiding our research. This presentation introduces an ongoing research project centred on Ida Melgushi, a key figure in the cultural and artistic life of Shkodra during the 20th century. I believe her presence also highlights a distinctive relationship between women and the city of Shkodra, a connection that remains under-explored. Those who knew her personally still recall her vividly, and their stories offer crucial insights. In this presentation, I will share some of the early results of my research, which is gradually revealing the shape of a unique biographical portrait.

Gjon BERISHA

Roli i portit të Shën Shirgjit në tregtinë e Kosovës me vendet e Adriatikut (Shek. XIII-XV)

Rajoni rreth Bunës dhe grykës së Drinit gjatë periudhës mesjetare konsiderohet si një qendër e rëndësishme tregtare e doganore jo vetë për shkak të pikave tregtare dhe doganore që shërbenin për tregtinë me kripën dhe me mallra tjera, por edhe si qendër ndërmjetësuese tregtare në mes vendeve të Adriatikut dhe qyteteve të Kosovës. Nga këto pika një rëndësi të veçantë për Kosovën dhe më gjerë, kishte porti lumor dhe tregu mesjetar i Shën Shirgjit, i vendosur rreth manastirit benediktin me të njëjtin emër, që ndodhej në bregun e majtë të Bunës, jo shumë larg Shkodrës. Rreth manastirit të fortifikuar u krijua një vendbanim tregtar, në të cilin, përveç tregut dhe skelës, kishte magazina, shtëpi tregtare dhe një zyrë doganore, ku mbahej një panair i madh në ditën e shenjtoreve (a panaiuro Sancti Sergii). Skela ishte porti i fundit ku anijet e vogla mund të arrinin në brendësi të vendit. Skela e Shën Shirgjit gëzonte privilegje të konsiderueshme. Atij i përkisnin të ardhurat nga lundrimi në Bunë (rreth 2 dukate në vit), pastaj 4 solide nga çdo anije e Raguzës që anorohej në Shën Shirgj.

Përmes këtij tregu, eksportohehin dru, kripë, drithëra, vaj, verë, hekur, pëlhura e produkte tjera. Përveç qyteteve të bregdetit shqiptarë, një nga vendet e Adriatikut që e përdorte skelën e Shën Shirgjit si pikë tranzitore në drejtim të Kosovës dhe anasjelltas ishte Raguzë, e cila tregtonte me produktet e Kosovës, nga të cilat dominonin metalet e çmueshme të minierave të Novobërdës, Janjevës dhe Trepçës. Një pjesë të konsiderueshme të produkteve të Kosovës, raguzanët i shitnin në tregje të ndryshme evropiane, sidomos në qytete italiane. Nga ana tjetër, përmes këtij tregu, raguzanët eksportonin në Kosovë produkte të ndryshme, si: kripë, pëlhura e tekstile të ndryshme evropiane etj. Importi dhe eksporti, përveç detit, kryhej edhe përmes karvanëve të cilat kalonin përmes rrugës "via de Zenta", e cila nisej nga Raguzë dhe kalonte përmes Herceg Novit, Kotorrit, Budës, Tivarit e Ulqinit, arrinte

në Shkodër dhe në grykëderdhjet e Drinit dhe Bunës, përkatësisht në skelën e Shën Shirgjit - për të vazhduar përmes trasesë rrugore në drejtim Vau i Dejës-Pukë-Prizren dhe qendra të tjera të Kosovës. I gjithë udhëtimi i rrugës Shkodër-Prizren zgjatej më shumë se tridhjetë orë në këmbë.

Rasti i Shirgjit në grykën e Bunës që u dallua si një nga tregjet më të fuqishme shqiptare gjatë mesjetës është një dëshmi e mirë për këto lidhje, të cilat, ndikuan në rritjen e kontakteve masive të njerëzve dhe mallrave nga krahina të ndryshme shqiptare

Tregtia në Shën Shirgj vazhdoi për një kohë pas pushtimit osman, por pas disa dekadash ajo mori fund përfundimisht.

Mikaela Minga

Ida Melgushi: Konturet e një portreti biografik

Cila është arsyeja që na shtyn për të shkruar një biografi? Si lidhet shkrimi i saj me kërkimin dhe hulumtimin? Çfarë lloj biografie mund të shkruajmë? Figura të caktuara të diktojnë t'u qasesh e të hulumtosh në mënyra të caktuara. Në këtë kumtesë dëshiroj të paraqes një punë kërkimore në zhvillim e sipër. Ajo i kushtohet Ida Melgushit, një protagoniste e përveçme e jetës kulturore e artistike të qytetit të Shkodrës gjatë shekullit XX. Prania e saj shënon, në mendimin tim, edhe një marrëdhënie të veçantë të gruas me qytetin, Shkodrën, marrëdhënie e cila është shumë pak e hulumtuar. Ndërkaq, njerëzit që e kanë njohur personalisht, e ruajnë ende të fortë në kujtesë dhe rrëfimet e tyre përbëjnë një të dhënë mjaft të rëndësishme. Në këtë prezantim do të paraqes disa nga rezultatet paraprake të kërkimit tim, i cili gradualisht po përvijon konturet e një portretit biografik të veçantë.

Linguistic and Social Identity in the Public Discourse of Shkodra (1920s-1940s)

The historical and social context of the Albanian nation at the turn of the 19th and 20th centuries is marked by significant events that shaped its identity. In addition to the struggle for national identity, the unity of the nation was seen as inseparable from the unification of the Albanian language and culture. These critical issues, which emerged as key principles during the National Renaissance, continued to influence the period of Independence.

Against this backdrop of social and cultural turbulence, the first glimmers of Enlightenment thought began to break through the long-standing darkness that had enveloped the Albanian people. Alongside valuable publications from the Renaissance period, the challenge of establishing a local press also emerged, which played an important role in the development of critical thought in Albania. Shkodra became a key centre for cultural development, with journalism serving as a significant medium for reflecting the societal changes taking place.

This paper will examine the cultural and sociolinguistic reflections in the public discourse of Shkodra, published between the 1920s and 1940s. These writings cover a variety of themes, including political and social debates, cultural and educational issues, social integration, the stigmatisation of negative phenomena affecting the nation, and sociolinguistic approaches, among others.

The identification of discursive paradigms in the formation of linguistic and cultural identities can be viewed as part of social interaction, both in communication between individuals and in their social group configurations. Analysing language as a mode of action often leads us to highlight the elements that constitute the domains of sociolinguistic interaction.

The Role of the Port of Shën Shirgj in the Trade Between Kosovo and the Adriatic (13th-15th Century)

The region surrounding the Buna River and the mouth of the Drin during the medieval period was a crucial commercial and customs hub, not only because of the trading and customs points that facilitated the salt trade and other goods but also as an intermediary centre for trade between the Adriatic coast and the cities of Kosovo. Among these trade points, the river port and medieval market of Shën Shirgj, situated near the Benedictine monastery with the same name on the left bank of the Buna River, not far from Shkodra, held particular importance for Kosovo and the surrounding areas. A trading settlement developed around the fortified monastery, which, alongside the market and dock, featured warehouses, commercial houses, and a customs office, where a large fair was held on the feast day of the saint (the “panaiuro Sancti Sergii”). The dock was the farthest point inland that small ships could reach. The port of Shën Shirgj enjoyed significant privileges, including income from shipping on the Buna (around 2 ducats per year) and 4 solidi from each ship from Ragusa that docked at Shën Shirgj.

Through this market, goods such as timber, salt, grain, oil, wine, iron, cloth, and others were exported. In addition to the Albanian coastal cities, Ragusa was one of the Adriatic regions that used the Shën Shirgj dock as a transit point to and from Kosovo, trading in products from Kosovo, including precious metals from the mines of Novobërdë, Janjeva, and Trepça. A considerable portion of Kosovo’s products was sold by the Raguzans in various European markets, particularly in Italian cities. On the other hand, through this market, the Raguzans also exported goods to Kosovo, such as salt, cloth, and other European textiles. Beyond sea routes, trade was also conducted via caravans traveling along the “via de Zenta” road, which began in Ragusa and passed through Herceg Novi, Kotor, Budva, Tivar, and Ulqin, reaching

Shkodra and the river mouths of the Drin and Buna, specifically the dock of Shën Shirgj. From there, the trade route continued through Vau i Dejës, Pukë, Prizren, and other centres of Kosovo. The entire journey from Shkodra to Prizren took over thirty hours on foot.

The example of Shën Shirgj at the mouth of the Buna, which emerged as one of the most powerful Albanian markets during the medieval period, provides strong evidence of these connections, which helped foster the exchange of people and goods from different Albanian regions. Trade at Shën Shirgj continued for some time after the Ottoman conquest, but eventually, it ceased after several decades.

Merita Hysa, Erzen Koperaj

Identiteti gjuhësor dhe social në diskursin publik të Shkodrës në vitet '20-'40

Konteksti historik dhe social i kombit shqiptar në kapërcyell të shekujve XIX dhe XX na shfaqet plot ngjarje që lanë gjurmë në ekzistencën e tij. Krahas përpjekjeve për identitet, njësia e kombit, shihte si parakusht njësimin e gjuhës dhe të kulturës shqiptare. Këto çështje thelbësore që u shpalosën si parime të Rilindjes Kombëtare, vijuan edhe përgjatë periudhës historike të Pavarësisë.

Në këtë sfond të trazuar social dhe kulturor, shkëndija të një vetëdijeje iluministe filluan të hidhnin dritë mbi terrin që kish kapluar kombin tonë ndër shekuj. Krahas botimeve me vlerë gjatë periudhës së Rilindjes, ne shohim edhe sfidën e krijimit të një shtypi vendas, i cili do të shenjonte një kapitull të rëndësishëm në historinë e zhvillimit të mendimit kritik në Shqipëri. Shkodra do të bëhëj një qendër e rëndësishme e zhvillimit kulturor dhe publicistika një tribunë e rëndësishme e pasqyrimin të këtij evolucioni që po i nënshtrohej shoqëria shqiptare.

Objekt i punimit tonë do të jenë pikërisht refleksionet publicistike me karakter kulturor, dhe sociolinguistik, të botuara në qytetin e Shkodrës në vitet 1920-1940, të cilat ngërthejnë në vetvete tematika të larmishme, si tematika e debatit me karakter politik dhe shoqëror, tematika e edukimit kulturor, arsimor dhe integritetit social, tematika stigmatizuese e dukurive negative që ndikonin mbi kombin, tematika e qasjeve me natyrë socio-gjuhësore etj.

Identifikimi i paradigmave ligjërimore në përcaktimin e identiteteve gjuhësore dhe kulturore, mund të shihet si pjesë e ndërveprimit shoqëror, qoftë në komunikimin mes individëve, qoftë edhe në konfigurimet sociale të tyre brenda peer-grupeve të caktuara. Të kundruarit e gjuhës si një mënyrë të vepruari, shpesh na çon në konturimin e elementeve që përbëjnë domenet e ndërveprimit sociolinguistik.

Natural and Cultural Tourism in the Municipality of Vau-Dejës

Vau-Dejës is one of the most picturesque regions in northern Albania, rich in historical, cultural, ethnographic, archaeological, and natural resources, offering extraordinary potential for tourism development. Vau i Dejës (Danja) was a significant medieval Albanian town. The area is abundant in cultural heritage, featuring lakeside vistas, stunning landscapes inspired by Albanian legends, captivating culture and history, places of worship, and local cuisine. It presents a unique opportunity for tourism development that could drive much-needed economic growth for the local population.

This study aims to highlight and promote the region's natural, historical, cultural, and artisanal attractions, while collaborating with the Vau-Dejës municipality to improve infrastructure and hospitality capacities. It also seeks to assist tourism operators in incorporating the region into their itineraries, as the area has exceptional potential, which holds great promise for the socio-economic development of the region. The research methodology is based on secondary data and interviews with various local stakeholders, both public and private, to explore the impact of tourism on the area and the challenges it faces, such as infrastructure issues.

In conclusion, we propose the following recommendations: improving infrastructure and signage, increasing investment, preserving the region's natural resources, promoting the area, collaborating with institutions and tourism agencies, providing continuous training for hospitality and accommodation services, and offering competitive prices alongside high-quality service.

Hajrullah Hajdari

Ligji, drejtësia dhe çështja e pronave të Shqiptarëve gjatë kufirit Shqipëri –Mali i Zi

Deri në vitin 1945 banorët shqiptarë të Krajës dhe Anës së Malit, jetën e tyre e kishin të lidhur ngusht me Shkodrën. Pothuajse nuk kishte familje kranjane e anamalse që nuk kishte prona në rrethin e Shkodrës. Po ashtu edhe shumë pronarë nga Shkodra kishin krijuar pronat e tyre në Ulqin e në vende tjera në Mal të Zi. Tërheqja e vijës kufizore, sipas vullnetit të Fuqive të Mëdha, shkaktoi probleme me mënyrën dhe nivelin e posedimit dhe shfrytëzimit të pronave.

Mbretëria e Shqipërisë dhe ajo e Jugosllavisë, për çështjet e tokave të mbetura në anën tjetër të kufirit, nënshkruan shumë konventa, marrëveshje apo protokole për rregullimin e jetës në zonat kufitare dhe zbatimin e tyre. Gjatë viteve 1945-1948, Shqipëria dhe Jugosllavia arriten shumë akorde e nënshkruan shumë marrëveshje, por pronarët e pasurisë së paluajtshme nuk arritën të fitojnë statusin e pronarit të vërtetë. Kjo u vështirësua më shumë me Reformën Agrare të Shqipërisë (1945) dhe kolektivizimit të pronave në Shqipëri.

Ndërkaq, pas vitit 1990 e këndeje Shqipëria dhe Mali i Zi nuk kanë ndërmarrë asnjë hap konkret politiko-juridik për çështjen e pronave në të dy anët e kufirit, edhe pse sipas definicionit të akteve ndërkombëtare mbi pronën shtetet janë të detyruar të pranojnë statusin e pronarit të vërtetë. Ky mosveprim është padrejtësi dhe mohim i të drejtave themelore civile dhe mund të cilësohet si gjenocid social ndaj këtyre pronarëve.

Rregullimi juridik i kësaj çështje është i mundur, sepse vetëm kështu drejtësia mund të veprojë dhe pronarët të gëzojnë të drejtën e mohuar.

The Law, Justice, and the Property Dispute of Albanians along the Albania-Montenegro Border

Until 1945, the Albanian inhabitants of Kraja and the Malësia region had their lives deeply intertwined with Shkodra. Nearly every family from Kraja and Malësia owned property in the Shkodra district. Similarly, many Shkodra landowners had established properties in Ulcinj and other areas of Montenegro. The establishment of the border, dictated by the Great Powers, created complications regarding the possession and use of land.

The Kingdoms of Albania and Yugoslavia signed numerous treaties, agreements, and protocols to regulate life in the border areas and to implement them, especially concerning the lands left on the opposite side of the border. Between 1945 and 1948, Albania and Yugoslavia reached several accords, but property owners were unable to gain full legal recognition of their ownership. This situation was exacerbated by Albania's Agrarian Reform (1945) and the collectivisation of land in Albania.

Since 1990, however, Albania and Montenegro have taken no significant political or legal actions to address the property issues on both sides of the border, despite the fact that international property rights conventions mandate the recognition of true ownership. This inaction represents a grave injustice and a violation of basic civil rights, which could be considered a form of social genocide against these property owners. A legal resolution to this matter is possible, and only through such a resolution can justice be served and property owners restored to the rights they have been denied.

Keywords: Albania, Yugoslavia, Montenegro, Albanians, property.

Majlinda Laçaj

Turizmi natyror dhe kulturor në Bashkinë Vau-Dejës

Vau-Dejës, është një ndër zonat më të bukura në veriun e Shqipërisë, me pasuri historike, kulturore, etnografike, arkeologjike, natyrore, me potenciale të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit. Vau i Dejës, (Danja) ishte qytet mesjetar shqiptar shumë i rëndësishëm. Zona është shumë e pasur me elementetë trashëgimisë kulturore, me panorama liqenore, peisazhe të mahnitshme që të kujtojnë legjendat shqiptare, kulturë magjepsëse, histori, vende adhurimi si dhe ushqime autoktone, duke ofruar mundësinë e një zhvillimi turistik i cili do të shënonte me një rritje ekonomike aq të nevojshme për banorët e zonës.

Qëllimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah, të promovojë vendet dhe kapacitetet natyrore, historike, kulturore, artizanale, që zona përmban dhe të bashkëpunojë e të iu vijë në ndihmë bashkisë Vau-Dejës, për përmirësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve pritëse, gjithashtu edhe operatorëve turistikë, ta përfshijnë në itineraret e guidave turistike, zona ka kapacitete turistike të jashtëzakonshme, fakt i cili është shumë premtues për zhvillimin socio-ekonomik të kësaj zone.

Metodologjia e kërkimit konsiston në të dhëna sekondare, intervista të realizuara me subjekte të ndryshme të zonës, qoftë shtetërore apo private, për mënyrën si ka ndikuar qasja e turizmit në zonë dhe vështirësitë e hasura si pasojë e problematikave të ndryshme, si p.sh, infrastruktura etj.

Në mbyllje të punimit propozojmë këto rekomandime: përmirësim i infrastrukturës dhe sinjalistikës, rritje të investimeve, kujdes në ruajtjen e burimeve natyrore të zonës, promovim i zones, bashkëpunimi me institucione dhe agjenci turistike, trajnim i vazhdueshëm i strukturave pritëse dhe akomoduese, çmime konkurruese me shërbim cilësor.

Anton Harapi – A Deep Understanding of Albanian Psychology and Philosophy

Anton Harapi is one of the prominent figures of the early 20th century, distinguished particularly for his analytical thinking. He is known for his in-depth exploration of the Albanian personality and way of life, as well as for his analysis of Albanian ethical and aesthetic codes.

His analyses are both psychological and philosophical, often presented through typical individual characters. Through his well-known lectures and his novel *Waves Upon Waves*, Harapi provides us with detailed analyses and arguments. His goal is to reveal the philosophy of life among Albanians. His concerns also extend to the Albanian intellectuals of the 20th century, whose task was to understand those values that connected them to civilisation and culture in general.

In addition to the triptych of goodness, beauty, and truth in the perception of aesthetic beauty, rooted in classical philosophy and Platonic approaches, as well as the Horatian principle *dulce et utile*, Harapi sought to convince Albanian society of the positive effects that come from a relationship based on harmony and balance. He was well-versed in the philosophies of the time, such as Kantian and Pragmatist thought. These he examined within their chronological context. Harapi analyses, explains, and presents an approach to philosophy that aligns with the essence, nature, and character of the Albanian people.

Hysen Nimani

Palokë Kurti një trashëgimi e gjallë dhe fuqi krijuese në historinë e muzikës kombëtare shqiptare

Emri i Palokë Kurtit lidhet pandashmërisht me Shkodrën dhe me muzikën, pasi Kurti ishte kompozitori dhe muzikanti i parë që finalizoi lindjen e artit të ri të kultivuar. Ai ka lindur në Shkodër në vitin 1860. Ai u dallua si dirigjent i orkestrave frymore, ishte një përpunues i këngëve popullore, shquhet edhe si kompozitor.

Ai u frymëzua nga mjedisi dhe muzika e ahengut shkodran. Këtu fillojnë edhe ngacimet e para të tij, por edhe fillesat e rrugës së tij për të bërë një emër të pavdekshëm në kulturën dhe trashëgiminë e muzikës sonë kombëtare shqiptare.

Ai mori tharmin e këngës popullore shkodrane dhe me fijet e kësaj kënge arriti të sjellë krijimet e tij të cilat gjallojnë ndër ne edhe sot e kësaj dite, ku mund të përmendim : marshin: “Bashkimi i Shqipërisë”, më 1881 kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, “Marhallah bukurisë sate”, “Ta dish, ta dish”, “Për mue paska kenë kismet”, “Karajfil të zgiodha”, “Kur fillon dita me dalë”, “Të due, moj të due” etj. Puna e tij krijuese, profesionale dhe artistike, mund të cilësohet si një trashëgimi e gjallë dhe fuqi krijuese në zhvillimin e historisë së muzikës sonë kombëtare.

Palokë Kurti: A Living Legacy and Creative Force in the History of Albanian Contemporary Music

The name of Palokë Kurti is inextricably linked to Shkodra and music, as Kurti was the first composer and musician to help establish a new, cultivated art form. Born in Shkodra in 1860, he was renowned as a conductor of wind orchestras, an arranger of folk songs, and a composer. He drew inspiration from the local environment and the music of Shkodra's traditional celebrations, where his early influences began and where the path to creating an immortal legacy in the culture and heritage of Albanian national music took root.

Kurti preserved the essence of Shkodran folk music, and through this foundation, he brought forth compositions that continue to resonate today. Notable examples include the march "Bashkimi i Shqipërisë" (The Unity of Albania) from 1881, dedicated to the League of Prizren, "Marhallah bukurisë sate" (Praise to Your Beauty), "Ta dish, ta dish" (You Should Know, You Should Know), "Për mue paska kenë kismet" (It Was My Fate), "Karajfil të zgiodha" (I Chose the Carnation), "Kur fillon dita me dalë" (When the Day Begins to Rise), "Të due, moj të due" (I Love You, Oh I Love You), and more. His creative, professional, and artistic contributions represent a living legacy and a powerful creative force in the development of our national music history.

Ledri Kurti

Anton Harapi – si njohës në thellësi i Psikologjisë dhe filozofisë së shqiptarit

At Anton Harapi është një nga figurat e fillimit të shekullit XX, i cili u shqua veçanërisht për mendimet e tij analitike. Është i njohur për depërtimin në mënyrë të imtësishme, në njohjen e personalitetit dhe stilit të jetesës së shqiptarit si dhe në kodet etike dhe estetike të tyre.

Analizat e tij janë sa analiza psikologjike, po aq edhe filozofike, madje vijnë të ofruara edhe përmes karakteresh tipike individuale. Si përmes ligjëratave të njohura, por edhe përmes llojit të romanit të tij "Valë mbi valë", Harapi na trashëgon analiza të detajuara përmes argumentesh dhe qëllimit të tij, për të shpërfaqur të kuptuarit e filozofisë së jetës tek shqiptari.

Shqetësimi i mendimit të tij, shfaqet edhe për intelektualët shqiptarë të fillimit të shekullit XX, të cilëve u takonte të njihnin ato vlera, që i afronin me qytetërimin dhe kulturën.

Përveç trinitetit të së mirës, së bukurës dhe së vërtetës në perceptimin e së bukurës estetike, ardhur nga filozofia klasike dhe qasjet platoniane, si dhe parimit horacian "dulce at utile", Harapi u përpoq të bindte mendjen e shoqërisë shqiptare, në frytin pozitiv, që sjell marrëdhënia harmoni - ekuilibër, pasi i kishte të njohura mirë dhe i analizon në kronologjinë e vet filozofitë e kohës, si ajo kantiane, pragmatiste, e me rradhë.

Harapi analizon, shpjegon dhe ofron njohje me qasjen e filozofisë më të përputhshme, në raport me thelbin, natyrën dhe karakterin shqiptar.

DR. HYSNI SHABANI – A LIFE AT THE SERVICE OF SHKODRA’S PEOPLE

Doctor Hysni Shabani was born on 30.05.1939 in the city of Shkodra to two simple worker parents. During the years 1956-1957 he attends the 2-year School of Nursing and graduates with excellent results. Then he started working at Shkodra Hospital “Jorgji Karamitri” as a nurse, where he works in the department of pediatrics and pathology. During the years 1958-1961, he graduated with excellent results from the Medical Technical High School in Shkodra where he graduated as a “Medical Assistant” on 28.06.1961. During the years 1962-1967, he studied at the Faculty of Medicine at the University of Tirana. He graduated as a “General Practitioner” on 29.05.1967. Then he returns to his hometown to serve his people with dedication and starts working as a doctor at the Institute of Social Insurance, Shkodra Branch. During this time, he has participated in several scientific conferences where he has referred his scientific work related to disability and accidents at work. All his life he worked devotedly with the neediest people without neglecting the exercise of his profession as a family doctor. He passed away on 06.08.2022.

Irda Dervishi Nesimi

Përqasje leksikografike midis “FIALUER I RII I SHQYTES” të Shoqërisë ‘Bashkimi’ DHE “An historical albanian-english dictionary” TË S.E.Mann-it

Botimet e veprave leksikografike shënojnë ngjarje të rëndësishme shkencore e kulturore në hapësirën shqipfolëse dhe në gjuhësinë shqiptare. Ashtu si kontributi i Shoqërisë “Bashkimi” për gjuhën dhe kulturën shqiptare edhe botimi i “Fialuer i Rii i Shqyptes” nga kjo shoqëri, ishte mjaft i dobishëm për shkrimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe.

Objekti i punimit është dhënia e një pasqyre të qartë të vendit që zë korpusi i fjalëve i Fjalorit të ‘Bashkimit’ (1908) në “An Historical Albanian-English Dictionary” (1948). Ky korpus fjalësh është shqyrtuar nga këndvështrimi i veçorive leksiko-gramatikore dhe studimi i fushave semantike duke dhënë kësaj një pasqyrë të qartë të fushave të tyre të përdorimit. Ndërkaq marrja në shqyrtim e tij shërben edhe në klasifikimin e fjalëve sipas burimit, duke qartësuar nëse ato janë shfaqje e trysnisë së fjalëve të huaja të asaj kohe apo të burimit autokton.

Ky punim synon gjithashtu që të përqsë fjalësin e marrë në studim me Fjalorin e gjuhës shqipe (1954), duke veçuar kësaj fjalët që nuk gjenden në të, por që janë në Fjalorin e “Bashkimit”. Në këtë mënyrë vërehet edhe qasja që Fjalori (1954) ka pasur ndaj fjalësit të Fjalorit të “Bashkimit” duke dhënë interpretime për rrethanat që kanë ndikuar në praninë apo mungesën e tyre në të.

Një pjesë e grumbullit të fjalësit, i cili është pjesë e këtij punimi, mund të jetë pjesë e fjalorëve të sotëm normativë, fjalorëve historikë etj.

Lexicographical Approaches to “Fialuer i Rii Li Shqypes” of the “Bashkimi” Society and “An Historical Albanian-English Dictionary” by S.E.MANN

The publication of lexicographical works marks significant scientific and cultural milestones in Albanian-speaking regions and in Albanian linguistics. Much like the contributions of the “Bashkimi” Society to the Albanian language and culture, the publication of “Fialuer i Rii i Shqypes” by this society greatly advanced the writing and dissemination of Albanian.

The purpose of this paper is to provide a clear overview of the role played by the word corpus of the Bashkimi Dictionary (1908) in An Historical Albanian-English Dictionary (1948). This corpus is analysed through the lens of lexical and grammatical characteristics, as well as semantic field studies, offering a comprehensive view of the contexts in which these words were used. Additionally, this examination aids in categorising words by origin, clarifying whether they reflect foreign influence from that period or are native to Albanian.

This study also aims to compare the examined vocabulary with that of the Albanian Language Dictionary (1954), highlighting words that are absent from the latter but present in the Bashkimi Dictionary. In doing so, it notes the approach taken by the 1954 dictionary regarding the Bashkimi vocabulary, providing insights into the factors that influenced the inclusion or exclusion of specific terms.

Some of the vocabulary explored in this paper may also appear in current normative dictionaries, historical dictionaries, and other lexicographical references.

Lindita Dibra, Zamira Shabani

Dr. Hysni Shabani - Një jetë në shërbim të popullit të Shkodrës

Doktor Hysni Shabani lindi me datë 30.05.1939 në qytetin e Shkodrës nga dy prindër punëtor të thjeshtë në profesion. Gjatë viteve 1956-1957 ai ndjek shkollën 2 vjeçare të Infermierëve dhe diplomohet me rezultate të shkëlqyera. Më pas fillon punë në Spitalin e Shkodrës “Jorgji Karamitri” si infermier, ku punon në repartin e pediatriisë dhe patologjisë. Gjatë viteve 1958-1961 ka kryer me rezultate të shkëlqyera Shkollën e Mesme Profesionale Teknikumi Mjekësor i Mbrëmjes, Shkodër ku diplomohet si “Ndihmësmjek” me datë 28.06.1961. Gjatë viteve 1962-1967 ka ndjekur studimet në Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit të Tiranës. Ai diplomohet si “Mjek i Përgjithshëm” me datë 29.05.1967. Më pas ai kthehet në qytetin e lindjes për të shërbyer me përkushtim popullit të tij dhe fillon punë si mjek pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore Dega Shkodër. Gjatë kësaj kohe ai ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore ku dhe ka referuar punën e tij shkencore lidhur me invaliditetin, paafësinë dhe aksidentet në punë. Gjithë jetën e tij ai punoi me përkushtim me shtresën më në nevojë pa lënë pas dore dhe ushtimin e profesionit të tij si mjek familje. Ai ndahet nga jeta me datë 06.08.2022

Shkodra as the Centre of Austro-Hungarian-Albanian Relations

On the eve of the Ottoman Empire's collapse, Austria-Hungary needed Albania as an independent state—its only ally in the Balkans, both against Pan-Slavism on one side and Italian imperialism on the other. Shkodra emerged as the centre of Austro-Hungarian-Albanian relations, which spanned the realms of science, politics, economics, the military, and culture. The city served as the headquarters for the Austro-Hungarian military administration, hosting the command of the 19th Corps and the Austro-Hungarian Civil Administrative Council from 1916 to 1918. Furthermore, Shkodra was the home of the Albanian Literary Commission, founded through the initiative of Austro-Hungarian civil commissioner August Kral and officially established by the military corps command on June 30, 1916.

My monograph *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918* (English: *Science in the Intersection of Politics and the Military: Austro-Hungarian Albanology 1867-1918*) offers a reconstruction of the domains of "science/albanology," "politics," "military," and "austrophiles" using Pierre Bourdieu's field theory. This study explores the interconnections between science, politics, and the military within these bilateral relations, applying Johan Galtung's theory of cultural imperialism. It identifies the key individual and collective actors in these fields, highlights their perspectives, and provides typologies for the actors in the "science/albanology" and "austrophile" fields. Additionally, the work analyses the interactions between these fields and reconstructs what is referred to as the "field of power."

This paper distills the core themes of the monograph by addressing essential questions: What is meant by the "field of power"? What are the defining characteristics of Austro-Hungarian scientists/albanologists? And what are the traits of Albanian Austrophiles? In conclusion, I will examine the crucial factors that led to the failure of Austria-Hungary to achieve its objectives with Albanian Austrophiles.

Rrezarta Draçini, Alketa Kraja

Epistular, prof. Jup Kastrati - At Justin Rrota OFM 1951-1964, Opera OMNIA - dritare për të njohur dy personalitete, një botë.

Botimi Epistular, prof. Jup Kastrati-At Justin Rrota O.F.1951-1964, Opera OMNIA, Vëllimi I, vjen si një dëshmi e një realiteti të njohur pak, ndërsa ndriçon dy figura të ndritura të kulturës dhe shkencës, dy intelektualë të formuar në kohë të ndryshme dhe me diferencë në moshë, por që kishin koherencë mendimi, që i bashkoi pasioni për gjuhësinë dhe shkencën, fisnikëria dhe qytetaria.

Ky libër është i parë i serisë së botimeve të disa vëllimeve të tilla, që do të jenë pjesë përbërëse e një kolane të veçantë, që parashikohet të botohet nga familja, duke respektuar testamentin e vetë prof. Kastratit.

Korrespondenca mes Kastratit dhe Rrotës nisi kur mjeshtri i madh Rrota ishte 62 vjeç dhe kishte krijuar autoritetin e tij absolut shkencor, ndërsa Kastrati 27 vjeç edhe pse i ri ishte bërë pjesë aktive e studimeve mbi gjuhën shqipe, duke krijuar autoritetin e tij shkencorë mes studuesve të njohur.

Në këtë punim, do të bëjmë një analizë të Epistularit, i cili është shumë më tepër se një letërkëmbim: është informacion gjuhësor, intelektual, etik, social, psikologjik dhe psikolinguistik. Ky botim është një fragment i shkëputur i jetës intelektuale mes Shkodrës dhe Tiranës 70 vite përpara.

Me anë të këtij botimi do të njihemi më mirë me dy personalitete që plotësonin njëri tjetrit: njëri me të sotmen e tjetri me të shkuarën. Është shumë interesant fakti që madhështia e njërit nuk zvogëlon tjetrin, përkundrazi kodi i komunikimit me tyre bën që ata vetëm ia rrisin vlerat njëri tjetrit. Dy figura intelektuale vijnë me përmasat e tyre reale.

Epistular, prof. Jup Kastrati-At Justin Rrota O.F. 1951-1964, Opera OMNIA-an opportunity to know two personalities, one world.

Epistular edition, prof. Jup Kastrati-At Justin Rrota O.F.1951-1964, Opera OMNIA, Volume I, comes as a testimony of a little-known reality, while illuminating two bright figures of culture and science, two intellectuals formed at different times and with a difference in age, but who had coherence of thought, united by passion for linguistics and science, nobility and citizenship.

This book is the first of the series of publications that will be an integral part of a special collection that is expected to be published by the family, respecting the will of Prof. Kastrati.

The correspondence between Kastrati and Rrota started when the great master Rrota was 62 years old and had established his absolute scientific authority, while Kastrati, 27 years old, although young, had become an active part of studies on the Albanian language, creating his scientific authority among the names of well-known researchers.

In this paper, we will analyze the Epistular, which is much more than an exchange of letters: it is linguistic, intellectual, ethical, social, psychological and psycholinguistic information. This publication is a detached fragment of the intellectual life between Shkodra and Tirana 70 years ago.

Through this publication we will get to know better two personalities who complemented each other: one with the present and the other with the past. It is very interesting the fact that the greatness of the one does not reduce the other, on the contrary, the code of communication between them only increases the values of one another. Two intellectual figures come in their life size.

Kurt Gostentschnigg

Shkodra si qendra e marrëdhënieve austro-hungaro-shqiptare

Në prag të rënies së Perandorisë Osmane Austro-Hungarisë i duhej Shqipëria si shtet i pavarur, si aleate e vetme në Ballkan kundër pansllavizmit nga njëra anë dhe kundër imperializmit italian në anën tjetër. Shkodra ka qenë qendra e marrëdhënieve austro-hungaro-shqiptare, të cilat shtriheshin në fushat shkencë, politikë, ekonomi, ushtri dhe kulturë. Shkodra ka qenë selia e administrimit ushtarak austro-hungarez, d.m.th. e komandës së korpusit të 19-të dhe e këshillit civil administrativ austro-hungarez në vitet 1916 deri 1918. Shkodra ka qenë gjithashtu selia e Komisionit Letrar Shqipe, e cila është themeluar me nismën e komisarit civil austro-hungarez August Kral dhe është miratuar me urdhrin e komandës së korpusit ushtarak austro-hungarez më 30 qershor 1916.

Monografia ime "Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918" (shqip: „Shkenca në fushën tensionuese të politikës dhe ushtrisë. Albanologjia austro-hungareze 1867-1918“) ofron një rikonstrukcion të fushave „shkencë/albanologji“, „politikë“, „ushtri“ dhe „austrofilë“ sipas teorisë së fushës të Pierre Bourdieu-s. Ky studim i përgjigjet pyetjes së lidhjes së shkencës, politikës dhe ushtrisë në këto marrëdhënie bilaterale duke zbatuar teorinë e imperializmit kulturor të Johan Galtung-ut, emërton aktorët individualë dhe kolektivë të fushave të lartpërmendura, tematizon perspektivat e tyre, tipizon aktorët individualë të fushave "shkencë/albanologji" dhe "austrofilë" si dhe përmban një tematizim të ndërveprimit të fushave dhe një rikonstrukcion të ashtuquajturës „fushë të pushtetit“.

Kjo kumtesë e nxjerr esencën e monografisë duke përqendruar në përgjigjen e pyetjeve se çfarë nënkuptohet me fushën e pushtetit, me tipat e shkencëtarëve/albanologëve austro-hungarezë dhe me tipat e austrofilëve shqiptarë. Si përfundim do të përpiqem të emërtoj shkaqet vendimtare për mosrealizimin e interesave të Austro-Hungarisë ndaj shqiptarëve austrofilë.

The Impact of Shkodra's Architecture on the Aesthetic Formation of Houses in Kraja

Cultural influences spread both directly and indirectly, enriching and evolving local traditions with new elements and tastes. In architecture, such influences are unavoidable, particularly when considering the impact of architectural features. The cultural landscape of a region like Kraja reflects cultural values, making it a rich area in terms of construction styles.

The Kraja region boasts a diverse natural and cultural heritage. Particularly noteworthy is the variety of buildings that constitute a valuable architectural legacy. Traditional houses in Kraja, built in simple styles, form a key part of the region's identity. The design and functionality of these houses are closely aligned with the local lifestyle and mentality. Various factors, especially geographic and historical conditions, shape the architecture of these homes. One significant factor is the historical link between Kraja and Shkodra. As an important urban, historical, and cultural centre, Shkodra's influence has undeniably left its mark on daily life, clothing, and folk architecture in the surrounding areas.

The formation of a unique architectural style in Kraja, seen in its houses, is shaped by both environmental factors and urban models, particularly those transmitted from Shkodra. The relationship between these two regions has led to the incorporation of specific elements from Shkodra's urban houses into the rural homes of Kraja.

Keywords: folk architecture, architectural heritage, cultural values, cultural landscape

Ismet Kallaba, Isida Hoxha

Prof. Dr. Hamit Boriçi, figurë emblematike e gazetarisë shqiptare

Profesor Hamit Boriçi ka një karrierë të gjatë dhe të pasur në fushën e gazetarisë. Me të drejtë, profesor Boriçi është quajtur "emblema e gjallë e kësaj fushe", pasi roli dhe kontributi i tij shpërfaqet në një sërë dimensionesh. Ai u lind në qytetin e Shkodrës në një ndër familjet e njohura dhe me zë, atë të Boriçëve. Dashuria për librin e shtypin e shkruar, nga biblioteka e pasur e familjes u zhvillua më tej në auditoret e universiteteve brenda dhe jashtë vendit. Është i njohur fakti që profesor Boriçi është një ndër themeluesit e parë të Katedrës së Gazetarisë në Universitetin e Tiranës. Në këtë universitet do të ishte pedagog, titullar i lëndëve të ndryshme të gazetarisë në një shtrirje kohore të gjatë, që vijoi edhe pas daljes së tij në pension, në vitin 1990. Gjithashtu ai ka mbajtur dhe pozicione drejtuese të rëndësishme si shef i Katedrës së Gazetarisë dhe ka qenë anëtar i disa këshillave shkencore. Përvoja e tij gazetareske përfshin punën si korrespondent, gazetar, redaktor, shef redaksie dhe kryeredaktor. Ai u bë modeli i gazetarit profesionist të kohës, pedagogut dhe studiuesit, i cili frymëzoi dhe formoi breza të tërë gazetarësh dhe pedagogësh, sot emra të njohur të gazetarisë shqiptare. Aspekti njerëzor është po aq i rëndësishëm. Një dimension tjetër me vlerë është firma e tij në një sërë librash, monografish dhe studimesh. Boriçi ka vendosur bazat e studimit të historisë së shtypit shqiptar dhe librat e tij janë sot pikë reference për studiuesit e tjerë të shtypit. Ndërsa librat e tij nga fusha e teorisë së gazetarisë shërbyen si orientim për formimin e studentëve dhe gazetarëve të rinj, sidomos në kohën e mungesës së literaturës në gjuhën shqipe për gazetarinë dhe median.

Prof. Dr. Hamit Boriçi: An Iconic Figure in Albanian Journalism

Professor Hamit Boriçi has had a long and distinguished career in the field of journalism. Rightfully described as “the living emblem of this field,” his role and contributions are reflected in numerous aspects. Born in the city of Shkodra to a well-known and influential family, the Boriçi family, his love for books and printed media, cultivated through the family’s extensive library, further developed during his studies at universities both in Albania and abroad. It is well known that Professor Boriçi was one of the founding members of the Department of Journalism at the University of Tirana. He served as a professor of various journalism courses at this university for many years, continuing even after his retirement in 1990. Additionally, he held important leadership positions, such as head of the Department of Journalism, and was a member of several academic councils.

His journalistic career spanned various roles, including correspondent, journalist, editor, editor-in-chief, and head of the editorial office. He became the model of the professional journalist of his time, as well as a professor and researcher who inspired and mentored entire generations of journalists and educators, many of whom are today prominent figures in Albanian journalism.

Equally important is his human side. Another valuable contribution is his extensive body of written work, including books, monographs, and studies. Boriçi laid the groundwork for the study of the history of the Albanian press, and his books are now considered essential references for other researchers in the field. His works on journalism theory have also been invaluable, serving as a guide for the education of students and young journalists, especially during a time when literature in the Albanian language on journalism and the media was scarce.

Keywords: Albanian journalism, history of the Albanian press, journalism textbooks, journalism education.

Korab Kraja

Ndikimi i arkitekturore i Shkodrës në formësimin estetik të shtëpisë në Krajë

Ndikimet kulturore përhapen në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi. Ato bëhen plotësuese dhe përditësuese me të dhëna, me elemente dhe me shije të reja. Edhe në arkitekturë, ndikimet janë të pashmangshme, sidomos kur bëhet fjalë për ndikimet e elementeve arkitektonike. Peizazhi kulturor i një treve të tillë shfaq vlera kulturore, që përbëjnë një rajon të pasur për nga llojet e ndërtimit.

Treva e Krajës përbëhet nga një trashëgimi e larmishme natyrore dhe kulturore. Sidomos, duhet të theksohet larmia e ndërtimeve, të cilat përbëjnë një trashëgimi të pasur ndërtimore. Të ndërtuara me stile të thjeshta, shtëpitë tradicionale në Krajë, përbëjnë një element të rëndësishëm identifikues. Mënyra e funksionalitetit të shtëpisë është e përshtatur ngushtë me mënyrën e jetesës dhe me mendësinë e zonës. Faktorët ndikues për të formësuar një shtëpi të tillë janë të shumtë, sidomos ata faktorë të cilët lidhen me kushtet dhe rrethanat gjeografike dhe historike. Një rrethanë e tillë, e cila i është përshtatur kohës, padyshim është konteksti ndërlidhës i Krajës me Shkodrën. Ndikimi i kësaj të fundit, si qendër e madhe dhe e rëndësishme urbane, historike dhe kulturore, padyshim që ka lënë gjurmë në të jetuar, në veshje, por edhe në arkitekturën popullore të rrethinës së saj.

Ndikimet në formimin e një stili të veçantë arkitekturore, që shtëpia ndërthen sipas kushteve rrethanore, por edhe sipas modeleve urbane, kanë transmetuar nga Shkodra në Krajë. Marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy vendeve kanë bërë që elemente të caktuara të shtëpisë qytetare të Shkodrës të pasqyrohen në shtëpinë fshatare në Krajë.

Kolë Luka and his selected Scientific Works: “Medieval Albania in toponomastics and onomastics”

This paper aims to illuminate the contributions of one of the most prominent figures in Albanian studies, particularly in the fields of toponomastics and onomastics. He did that mainly through his French translations (without authorship) of most of the scientific articles published in *Studia Albanica*, as well as the summaries of nearly all the scholarly works in *Studime Historike*, *Studime Filologjike*, *Çështje të Folklorit Shqiptar*, *Kultura Popullore*, and *Iliria*, which were published in socialist Albania.

The publication of Kolë Luka’s selected works: *Medieval Albania in Toponomastics and Onomastics* by the Center for Encyclopedic Publications (Academy of Albanian Studies - now ASHSH), on the occasion of the 550th anniversary of the death of our National Hero, Gjergj Kastrioti-Scanderbeg, was an act of acknowledgment and honour for his contributions. The volume brings together 11 articles on toponomastics and 12 on onomastics, cementing Luka’s role as a key figure in Albanian studies. It also includes five reviews of works by foreign Albanologists, many of which present valuable insights.

This publication offers a new perspective on the significance of Luka’s work, through his research not only into the toponomastics and onomastics of medieval Albanian lands but also into early medieval institutions in Albania—many of which remained unknown until the research of Kolë Luka (1917–1994), and even extending beyond the Medieval period.

Juljana KUME

Ndihmesa e Ferdinand Lekës në terminologjinë e gjuhës shqipe

F. Leka është një ndër gjuhëtarët e spitaktur të Veriut me specialitet të ngushtë terminologjinë. Ndhma e tij në këtë drejtim është e çmuar si për volumin e punimeve terminografike në këtë fushë ndërdisiplinare po aq edhe për kontributin e tij të vyer në udhëzimet teoriko-praktike me synimin e thellimit të konceptit bashkëkohor për njohjen dhe interpretimin shkencor të terminologjive të gjuhëve profesionale, me ndihmesë të veçantë në fusha të ngushta të dijës si bashkautor dhe redaktor shkencor i një vargu fjalorësh terminologjikë i fushave të tilla, si: gjeologji, arkitekturë, miniera, hidraulikë, ekonomi, gjeografi, mekanikë, drejtësi, të drejtën ndërkombëtare, letërsi, gjuhësi, mjekësi me degët e saj).

Ky punim rreth kontributit të këtij dijetari në terminologjinë e gjuhës shqipe do të ndalet veçanërisht në interpretimin sa teorik dhe praktik që ky dijetar i ka bërë termit, në politikat udhëzuese për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore me synimin e standardizimit dhe njësimin të termit në ligjërimet e specializuara sa tekniko-shkencore dhe humane-shkencore; si dhe në vijimësi atë ç’ka duhet të bëhet me terminologjinë shqipe sipas modeleve më të mira hulumtuese, hartuese ndërkombëtare në përshtatje me nevojat (problemet e detyrat) e terminologjisë së sotme shqipe në këtë kohë të zhvillimeve të vrullshme të shkencës dhe inteligjencës artificiale.

Ferdinand Leka's Contribution to Albanian Language Terminology

F. Leka is one of the prominent linguists of Northern Albania, specializing narrowly in terminology. His contribution in this regard is valuable both for the volume of terminographic works in this interdisciplinary field and for his significant input in theoretical and practical guidance aimed at deepening the contemporary concept of understanding and scientifically interpreting the terminologies of professional languages. He has made a particularly notable contribution in narrow fields of knowledge as a co-author and scientific editor of several terminological dictionaries in areas such as geology, architecture, mining, hydraulics, economics, geography, mechanics, law, international law, literature, linguistics, and medicine (with its branches).

This study on the contribution of this scholar to the terminology of the Albanian language will focus particularly on the theoretical and practical interpretations he has provided on terms, on the guiding policies for the development of technical-scientific terminology aimed at standardizing and unifying terms in specialized technical-scientific and humanistic-scientific discourse. It will also address the ongoing efforts required for Albanian terminology, following the best international research and drafting models, adapted to the needs (problems and tasks) of contemporary Albanian terminology in this era of rapid scientific developments and artificial intelligence.

Vilma Proko

Kolë Luka dhe vepra e përzgjedhur shkencore: "Shqipëria mesjetare në toponomastikë dhe onomastikë"

Kumtesa synon të ndriçojë modelin e një ndër kontribuesve të dalluar në studimet albanologjike dhe në fushat e toponomastikës dhe onomastikës, si edhe përmes përkthimeve në frëngjisht (pa autor) të të shumtës së artikujve shkencorë në Studia albanica, por edhe të rezumeve të pothuaj gjithë punimeve shkencore të Studime Historike, Studime Filologjike, Çështje të Folklorit Shqiptar, Kultura Popullore, Iliria që botoheshin në Shqipërinë socialiste.

Botimi i veprës së përzgjedhur shkencore të Kolë Lukës: Shqipëria Mesjetare në Toponomastikë dhe Onomastikë nga Qendra e Botimeve Enciklopedike (Akademia e Studimeve Albanologjike - sot ASHSH), në kuadër të 550-vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, shërbeu si një akt vlerësimi e nderimi për të. Në veprë përmbledhen artikuj të këtij autori, përkatësisht 11 në fushën e toponomastikës dhe 12 artikuj në fushën e onomastikës, duke qenë njëherazi kontribues i rëndësishëm në studimet albanologjike, si edhe 5 recensime të një numri veprash albanologjesh të huaj, ku ndeshim dendur njoftime të vyer.

Ky botim na shërben si një qasje e re për ta gjykuar e vlerësuar peshën e kësaj vepre nëpërmjet një numri punimesh sikurse janë gjurmimet jo vetëm për toponomastikën dhe onomastikën e Mesjetës arbërore, por edhe për institucione të hershme mesjetare në vendin tonë, shpesh të panjohura deri para gjurmimeve të Kolë Lukës (1917–1994), e gjithashtu edhe përtej Mesjetës sonë.